

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Drejtimin Mësimor

VETERINARI

Niveli IV i KSHK

(Bllok 4 vjeçar)

Kodi: N-IV-22

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2022

Përmbajtja

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin mësimor “Veterinari” niveli IV i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me punimet dhe shërbimet në sektorin e veterinarisë”*. Zhvillimi te nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Veterinari” niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MFE përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të ketë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënësve dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

Në përfundimin me sukses të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në proceset e punëve në fushën e veterinarisë.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të përdorë mjete dhe burime dixhitale në funksion të veprimtarisë profesionale.
- Të organizojë vendin e punës.
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- Të zbatojë standardet e profesionit.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes në punë
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të përdorë teknologjinë dixhitale në funksion të veprimtarisë profesionale.
- Të ushqejë kafshët bujqësore.
- Të kujdeset për higjienën e kafshëve.
- Të kryejë dezinfektimin e stallave dhe të territoreve.
- Të kryejë procese të higjienizimit të prodhimeve blegtorale.
- Të përcaktojë organet e brendshme të kafshëve.
- Të kryejë fiksimin e kafshëve të kategorive të ndryshme.
- Të përdorë vegla të thjeshta kirurgjikale.
- Të kryejë injeksione të ndryshme të kafshët.
- Të diagnostikojë sëmundjet më të zakonshme të kafshët, me metoda të ndryshme.
- Të mjekojë plagë të ndryshme të kafshët.

- Të marrë mostra për analiza laboratorike.
- Të përgatisë strishe të thjeshta.
- Të kujdeset për kafshët gjatë dhe pas pjelljes.
- Të diagnostikojë helmintozat në kafshët e gjalla dhe të therura.
- Të kryejë ndërhyrje kirurgjikale profilaktike.
- Të përgatisë forma të thjeshta farmaceutike të ngurta, të lëngta dhe të buta.
- Të vaksinojë kafshët dhe shpendët për sëmundjet infektive.
- Të mjekojë mastitet në kafshë.
- Të mjekojë sëmundjet e aparatit tretës.
- Të kryejë kontrollin e cilësisë së produkteve ushqimore me prejardhje shtazore.
- Të kryejë dehelmitizimin e kafshëve me sëmundje parazitare.
- Të vlerësojë materialin biologjik të kafshës.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e Teknikut të veterinarisë. Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si teknik veteriner në ndërmarrje/ferma të ndryshme blegtorale, në farmaci veterinare ose veprimtari të tjera që veprojnë në fushën e veterinarisë. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën veterinare. Me mbarimin e arsimit profesional në drejtimin “Veterinari” në nivelin IV i KSHK, nxënësi fiton “Maturën shtetërore profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për drejtimin mësimor “Veterinari” niveli IV i KSHK (4 vjeçar)						
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/16 (540/ 576)	10/11 (360/ 396)	10/11 (360/ 396)	13/14 (416/ 448)
1		Gjuhë shqipe	1	1	1	1
2		Letërsi	1	1	1	1
3		Gjuhë e huaj 1	2	2	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)	(1)	(1)
5		Matematikë	2	2	2	2
6		Fizikë	2	-	-	1
7		Kimi	1	-	1	-
8		Biologji	-	-	1	1
9		Shkenca sociale	2	-	-	1
10		Histori	-	2	-	1
11		Gjeografi	1	-	1	-

12		Teknologji informimi e komunikimi	1	1	-	1
13		Edukim fizik, sporte, shëndet	2	1	1	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	9 (324)	11 (396)	8 (288)	9 (288)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	-	-	2	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	-	-	-	1
3	L-14-077-21	Bujqësi e përgjithshme	2	-	-	-
4	L-19-590-21	Higjiena e mjedisit dhe e kafshëve	2	-	-	-
5	L-19-079-11	Anatomi dhe fiziologji	3	2	-	-
6	L-19-397-21	Mbarështimi i kafshëve bujqësore	2	1	-	-
7	L-07-081-21	Mikrobiologji veterinarë	-	2	2	-
8	L-19-082-09	Patologji	-	1	-	-
9	L-19-083-21	Kirurgji veterinarë	-	2	-	-
10	L-19-084-16	Propiodeutikë	-	1	-	2
11	L-19-085-16	Riprodhimi i kafshëve	-	2	2	1
12	L-19-221-11	Farmakologji	-	-	1	-
13	L-19-222-16	Parazitologji	-	-	1	2
14	L-19-223-16	Kontroll blegtoral	-	-	-	1
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)	5 (180)	7 (252)	9 (324)	6 (192)
1	M-19-228-20	Të ushqyerit e kafshëve bujqësore	36	-	-	-
2	M-19-229-20	Kujdesi për higjienën e kafshëve	36	-	-	-
3	M-19-230-20	Dezinfektimi i stallave dhe i territoreve jashtë saj	36	-	-	-
4	M-19-1800-21	Higjiena e prodhimeve blegtorale	36	-	-	-
5	M-19-232-20	Përcaktimi i organeve të brendshme të kafshët	36	-	-	-
6	M-19-233-20	Fiksimi i kafshëve të kategorive të ndryshme	-	36	-	-
7	M-19-234-21	Përdorimi i veglave të thjeshta kirurgjikale	-	36	-	-
8	M-19-235-20	Kryerja e injeksioneve të kafshët	-	36	-	-
9	M-19-236-20	Diagnostikimi i sëmundjeve me metoda të ndryshme	-	36	-	-
10	M-19-237-21	Mjekimi i plagëve të ndryshme të kafshët	-	36	-	-
11	M-19-1801-21	Marrja e mostrave dhe përgatitja e strisheve	-	36	-	-
12	M-19-239-20	Kujdesi për kafshët gjatë dhe pas pjelljes	-	36	-	-
13	M-19-1233-20	Diagnostikimi i helmintozave në kafshët e gjalla dhe të therura	-	-	90	-
14	M-19-1802-21	Ndërhyrjet kirurgjikale profilaktike	-	-	36	-
15	M-19-618-21	Përgatitja e formave të ndryshme farmaceutike	-	-	36	-
16	M-19-619-20	Vaksinimi i kafshëve dhe shpendëve për sëmundjet infektive	-	-	90	-
17	M-19-620-20	Mjekimi i mastiteve në kafshë	-	-	72	-
18	M-19-621-20	Mjekimi i sëmundjeve të aparatit tretës	-	-	-	48
19	M-19-622-20	Kontrolli i cilësisë së produkteve ushqimore me prejardhje shtazore	-	-	-	48
20	M-19-623-20	Dehelmentizimi i kafshëve me sëmundje parazitare	-	-	-	48
21	M-19-624-20	Vlerësimi i materialit biologjik të kafshës	-	-	-	48

D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	1 (36)	2 (72)	2 (72)	2 (64)
1	M-19-240-20	Përgatitja me krahë e barit të thatë	36	-	-	-
2	M-19-241-20	Dezinsektimi dhe deratizimi i mjediseve	36	-	-	-
3	M-19-242-20	Asgjesimi i kafshëve të ngordhura.	-	72	-	-
4	M-19-243-20	Përcaktimi i shenjave të afshit te kafshët	-	72	-	-
5	M-19-625-20	Zbatimi i profilaksië kundër sëmundjeve infektive	-	-	72	-
6	M-19-626-20	Mjekimi i organeve gjinore te lopët	-	-	72	-
7	M-19-627-20	Mjekimi i kafshëve dhe shpendëve me ektoparazitë	-	-	-	64
8	M-19-628-20	Inseminimi artificial i lopëve me metodën rektocervikale	-	-	-	64
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 1080/ 1116	30/31 1080/ 1116	29/30 (1044/ 1080)	30/31 960/ 992

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, 11 dhe 12 viti shkollor ka gjithësej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithësej 36 javë (32 javë mësimore + 1 javë për provimin e praktikës profesionale + 3 javë për provimet e Maturës shtetërore profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Veterinari”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me **nota** (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës 13, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “Veterinari”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve përfundimtare të mëposhtme:

- a) Provimet e maturës shtetërore profesionale;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të njohurive të përgjithshme, njohurive të profesionistit dhe të kompetencave profesionale të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që kryhen në fushën e veterinarisë. Nxënësve u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e provimeve përfundimtare të nivelit IV i KSHK.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës shtetërore profesionale, si dhe me Çertifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
 - rezultatet e provimeve përfundimtare të nivelit IV i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 72 orë dhe kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 72 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë

Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	4 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë
Tema 20	Vizitë studimore në një sipërmarrje të suksesshme	4 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxhetimi në biznes	4 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë
Tema 13	Siguracionet personale	3 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”.
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor.
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
Tema 5	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë

Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	2 orë
Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
Tema 10	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit local	6 orë

3. Lënda “Bujqësi e përgjithshme” (L-14-077-21) Kl. 10 - 72 orë

- Synimet e lëndës “Bujqësi e përgjithshme”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bujqësi e përgjithshme” klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin, rëndësinë dhe rolin që ka bujqësia në ekonominë e vendit në përgjithësi, si dhe për sektorin e blegtorisë në veçanti.
- Të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe klasifikimin drithrave.
- Të identifikojnë karakteristikat botanike e veçoritë biologjike të të lashtave e të të vonave.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të të lashtave dhe të të vonave.
- Të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen, klasifikimin dhe veçoritë e prodhimit foragjer.
- Të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe kultivarët e graminoreve foragjere.
- Të përshkruajnë hallkat kryesore të teknologjisë së kultivimit të graminoreve një dhe shumëvjeçare.
- Të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe kultivarët e bishtajoreve foragjere një dhe shumë vjeçare.
- Të identifikojnë karakteristikat botanike dhe veçoritë biologjike të bishtajoreve foragjere një dhe shumë vjeçare.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e bishtajoreve foragjere një e shumë vjeçare.
- Të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen, karakteristikat botanike dhe veçoritë biologjike të kulturave të tjera foragjere: kryqore, rrënjore e kungullore.
- Të përkufizojnë konceptin “hasëll” e të përshkruajnë rëndësinë, rolin e hasëlleve në të ushqyerit e blegtorisë.
- Të përshkruajnë bimësinë e grupit të hasëlleve sipas famijleve: tërfilet aleksandrin, lakrën foragjere, perkon, kolzën etj.
- Të përshkruajnë bashkëshoqërimin dhe bashkërendimin e hasëlleve.
- Të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe rolin e tagjirave në të ushqyerit e blegtorisë.
- Të përshkruajnë bimësinë e grupit të livadheve sipas famijleve: jonxha, sulla, esparseta, tërfilet e ndyshme dhe bimësitë e famijjes gramore: egjrat shumëvjeçare etj;
- Të kasifikojnë lidhabet sipas llojit të bimësisë dhe jetëgjatësisë së tyre;
- Të përshkruajnë ligjësitë e bashkëshoqërimit të bimësisë në livadhe;
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të jonxhes;
- Të përshkruajnë rëndësinë, bimësinë dhe klasifikimin e kullotave;
- Të përshkruajnë përmirësimin dhe agroteknikën e kultivimit të kullotave;
- Të tregojnë mënyrat e shfrytëzimit të kullotës;
- Të përshkruajnë rëndësinë e përdorimit të nënprodukteve të bujqësisë e blegtorisë në blegtori;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bujqësi e përgjithshme”, kl. 10 – 72 orë**

Tema 1	Hyrje në bujqësi	2 orë
Tema 2	Të lashtat	8 orë
Tema 3	Të vonat	8 orë
Tema 4	Graminoret foragjere	8 orë
Tema 5	Bishtajoret foragjere	8 orë
Tema 6	Kulturat e tjera foragjere	8 orë
Tema 7	Hasëllët	8 orë
Tema 8	Tagjirat	4 orë
Tema 9	Livadhet	8 orë
Tema 10	Kullotat	8 orë
Tema 11	Nënproduktet e bujqësisë dhe të industrisë që përdoren blegtori	2 orë

4. Lënda “Higjiena e mjedisit dhe e kafshëve” (L-19-590-21) Kl. 10 - 72 orë

• **Synimet e lëndës “Higjiena e mjedisit dhe e kafshëve”, kl. 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Higjiena e mjedisit dhe e kafshëve”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë parimet bazë për mjedisin dhe ndikimin e tij në kafshë.
- Të shpjegojnë rolin e oksigjenit në qëniet e gjalla dhe ndikimin e gazeve të dëmshme në organizëm.
- Të përshkruajnë rolin e rrezatimit diellor në shëndetin dhe prodhimtarinë e kafshëve.
- Të shpjegojnë ndikimin e aklimatizimit në zhvillimin e kafshëve.
- Të përshkruajnë rolin e ujit në organizmin e kafshëve dhe treguesit fiziko-kimik të tij.
- Të hartojnë bilancin e nevojave për ujë të kafshëve në një fermë blegtorale.
- Të përshkruajnë kushtet higjienike që duhet të plotësojnë ushqimet me prejardhje bimore dhe shtazore gjatë ruajtjes, përpunimit dhe përdorimit të tyre.
- Të hartojnë planin e masave organizative për shtegëtimin e kafshëve në kullota.
- Të përshkruajnë shërbimet që kryhen për mbajtjen pastër të trupit të kafshës (lëkurës, thundrave, gjirit, etj.).
- Të përshkruajnë kushtet higjienike që duhen plotësuar për kafshët para, gjatë dhe pas pjelljes.
- Të rendisin masat higjienike gjatë mjeljes, ruajtjes, transportit dhe përpunimit të qumështit.
- Të rendisin kushtet që duhen zbatuar për ndërtimin e komplekseve blegtorale për kategori të ndryshme të kafshëve bujqësore.
- Të dallojnë dezinfektimin mekanik nga ai fizik.
- Të përshkruajnë llojet e dezinfektimit mekanik, fizik, kimik në trupin e kafshëve dhe objekte të ndryshme.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Higjiena e mjedisit dhe e kafshëve”, kl. 10 – 72 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi mjedisin	3 orë
Tema 2	Higjiena e ajrit	9 orë

Tema 3	Njohuri mbi motin, klimën dhe mikroklimën	3 orë
Tema 4	Mjedisi termik	3 orë
Tema 5	Mjedisi valor	3 orë
Tema 6	Higjiena e ujit dhe e impianteve	9 orë
Tema 7	Higjiena e ushqimeve dhe e të ushqyerit	4 orë
Tema 8	Higjiena e kullotave dhe e kullotjes	4 orë
Tema 9	Higjiena e trupit të kafshëve	5 orë
Tema 10	Higjiena e kafshëve të riprodhimit	3 orë
Tema 11	Higjiena e pjelljes dhe kafshëve të porsalindura	5 orë
Tema 12	Higjiena e gjirit, e mjeljes dhe e majmërisë	5 orë
Tema 13	Strehimi i kafshëve	6 orë
Tema 14	Ventilimi	2 orë
Tema 15	Parandalimi i ndotjes së mjedisit	3 orë
Tema 16	Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi	5 orë

5. Lënda “Anatomi dhe fiziologji ” (L-19-079-11) Kl. 10 – 108 orë, Kl. 11 – 72 orë

- **Synimet e lëndës “Anatomi dhe fiziologji”, kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Anatomi dhe fiziologji”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë dhe tregojnë ndërtimin e mikroskopit.
- Të përdorin mikroskopin.
- Të përshkruajnë objektin, rëndësinë e anatomisë dhe lidhjen e saj me shkencat e tjera.
- Të tregojnë ç’është qeliza dhe të përshkruajnë pjesët e saj.
- Të rendisin indet dhe të përshkruajnë ndërtimin e tyre.
- Të përcaktojnë rajonet e trupit të kafshës.
- Të rendisin llojet e kockave dhe mënyrat e bashkimit të tyre
- Të emërtojnë dhe të përshkruajnë kockat e skeletit, të kokës, të shtyllës kurrizore dhe të gjymtyrëve
- Të rendisin lidhëset e trupit dhe të tregojnë vendndodhjen e tyre.
- Të tregojnë funksionin dhe ndërtimin e muskulit si organ.
- Të emërtojnë dhe të përcaktojnë vendndodhjen e muskujve të kokës, të shtyllës kurrizore, të gjymtyrëve, të kraharorit dhe të barkut.
- Të rendisin dhe të emërtojnë organet e brendshme sipas aparateve ku ndodhen.
- Të tregojnë vendndodhjen e organeve të tretjes, të frymëmarrjes, të qarkullimit të gjakut, të organeve të shqisave, të sistemit nervor dhe uro-gjinar.
- Të përshkruajnë ndërtimin e organeve të tretjes, të frymëmarrjes, të qarkullimit të gjakut, të organeve të shqisave, të sistemit nervor dhe uro-gjinar.
- Të përcaktojnë dallimet midis organeve të tretjes, të frymëmarrjes, të qarkullimit të gjakut, të organeve tëshqisave, të sistemit nervor dhe uro-gjinar në kafshë të ndryshme.
- Të përcaktojnë shtresat e lëkurës dhe të përshkruajnë ndërtimin e tyre.
- Të përcaktojnë pjesët e gjirit dhe të përshkruajnë ndërtimin e tij.
- Të rendisin gjendrat me sekrecion të brendshëm.
- Të përcaktojnë vendin dhe të përshkruajnë ndërtimin e gjendrave me sekrecion të brendshëm.
- Të përshkruajnë skeletin, muskulaturen dhe organet e brendshme të shpendeve.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Anatomi dhe fiziologji”, kl. 10 – 108 orë**

Tema 1	Rëndësia, ndërtimi dhe përdorimi i mikroskopit	3 orë
Tema 2	Qeliza dhe indet	7 orë
Tema 3	<u>Punë laboratorike</u> për ndërtimin e qelizës dhe të indeve të kafshës	3 orë
Tema 4	Skeleti i trupit të kafshëve dhe lidhëset	8 orë
Tema 5	<u>Punë laboratorike</u> për skeletin e trupit të kafshëve	5 orë
Tema 6	Muskulatura e trupit	6 orë
Tema 7	<u>Punë laboratorike</u> për muskulaturën e trupit	4 orë
Tema 8	Organet e aparatit tretës	6 orë
Tema 9	<u>Punë laboratorike</u> për organet e aparatit tretës	4 orë
Tema 10	Organet e aparatit të frymëmarrjes	4 orë
Tema 11	<u>Punë laboratorike</u> për aparatit e frymëmarrjes	3 orë
Tema 12	Organet e aparatit urinar	3 orë
Tema 13	<u>Punë laboratorike</u> për aparatit urinar	2 orë
Tema 14	Organet e aparatit gjinor	5 orë
Tema 15	<u>Punë laboratorike</u> për aparatit gjinor	4 orë
Tema 16	Zemra dhe enët e gjakut	7 orë
Tema 17	Sistemi nervor	7 orë
Tema 18	<u>Punë laboratorike</u> për sistemin nervor	4 orë
Tema 19	Organet e shqisave	4 orë
Tema 20	<u>Punë laboratorike</u> për organet e shqisave	2 orë
Tema 21	Lëkura dhe gjiri	4 orë
Tema 22	<u>Punë laboratorike</u> për lëkurën dhe gjirin	3 orë
Tema 23	Gjëndrat me sekrecion të brendshëm	4 orë
Tema 24	<u>Punë laboratorike</u> për gjëndrat dhe sekrecionin	2 orë
Tema 25	Anatonia e shpendëve	4 orë

• **Synimet e lëndës “Anatomi dhe fiziologji”, kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Anatomi dhe fiziologji”, klasa 11, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë thelbin e teorisë qelizore dhe funksionet e organeleve qelizore dhe të membranës.
- Të rendisin vetitë e muskujve të skeletit dhe atyre të lëmuar.
- Të përshkruajnë mekanizmin e tkurrjes muskulare dhe të përcjelljes së nxitjes në nerva.
- Të përshkruajnë si ndodhin e si ndahen refleksat si dhe të përshkruajnë funksionet e pjesëve të veçanta të sistemit nervor qendror, palcës së zgjatur dhe asaj shpinore.
- Të rendisin dhe shpjegojnë funksionet e tretjes.
- Të përshkruajnë tretjen në gojë, stomak e zorrë.
- Të përshkruajnë funksionet e parastomaqeve.
- Të shpjegojnë procesin e përthithjes.
- Të rendisin dhe të shpjegojnë funksionet e gjakut.
- Të krahasojnë qarkullimin e madh me qarkullimin e vogël të gjakut.
- Të përshkruajnë fazat e frymëmarrjes.
- Të shpjegojnë se si i marrin kafshët proteinat, yndyrnat, sheqernat, lëndët minerale dhe rugën që përshkojnë ato deri në tretjen e tyre.
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe rolin e veshkave.
- Të tregojnë funksionet e lëkurës.

- Të përshkruajnë funksionet e hormoneve që prodhojnë gjëndrat me sekrecion të brendshëm.
- Të krahasojnë pjekurinë trupore me atë seksuale.
- Të përshkruajnë si formohen cipat e frytit, mënyrën e të ushqyerit e tij, periudhën e mbarsmërisë, si edhe pjelljen.
- Të përshkruajnë fiziologjinë e laktacionit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Anatomi dhe fiziologji”, kl. 11 – 72 orë**

Tema 1	Funksionet e qelizës	3 orë
Tema 2	Fiziologjia e muskujve dhe e nervave	5 orë
Tema 3	Fiziologjia e sistemit nervor qendror	10 orë
Tema 4	Fiziologjia e analizatorëve	5 orë
Tema 5	Fiziologjia e tretjes	10 orë
Tema 6	Fiziologjia e sistemit të gjakut dhe e limfës	10 orë
Tema 7	Fiziologjia e frymëmarrjes	4 orë
Tema 8	Shkëmbimi i lëndëve dhe i energjisë	9 orë
Tema 9	Fiziologjia e veshkave	4 orë
Tema 10	Fiziologjia e lëkurës	2 orë
Tema 11	Fiziologjia e gjendrave me seksrecion të brendshëm	4 orë
Tema 12	Fiziologjia e riprodhimit	8 orë

6. Lënda “Mbarështimi i kafshëve bujqësore” (L-19-397-21) Kl. 10-72 orë, Kl. 11–36 orë

• **Synimet e lëndës “Mbarështimi i kafshëve bujqësore” kl. 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mbarështimi i kafshëve bujqësore”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë rëndësinë ekonomike të derrit, gjedhit, dhenve, shpendëve.
- Të shpjegojnë përbërjen kimike të ushqimeve dhe koeficientin tretshmërisë.
- Të përshkruajnë teknologjinë e përgatitjes së silazhit dhe senazhit.
- Të përshkruajnë teknologjinë e përgatitjes së ushqimeve të koncentruara.
- Të shpjegojnë përgatitjen e qumështit nga soja e tërshëra.
- Të përshkruajnë etapat e përpilimit dhe strukturën e një racioni ushqimor.
- Të shpjegojnë normat ushqimore që nevojiten për mirëmbajtje, prodhim dhe riprodhim në kafshë dhe shpendë.
- Të shpjegojnë teknikat e përpilimit të një racioni ushqimor për kafshët dhe shpendët.
- Të përshkruajnë të ushqyerit e deleve barse dhe qengjave
- Të hartojnë racione të thjeshta ushqimore për gjedhin, të imtat, derrat dhe shpendët.
- Të hartojnë nevojat për energji, proteina, lëndë minerale dhe vitamina në kafshët për mish si: gjedh, derra, dhen, etj
- Të shpjegojnë teknologjinë e të ushqyerit të gjedhit sipas fazave fiziologjike.
- Të përshkruajnë të ushqyerit e lopëve barse, në tharje dhe në laktacion.
- Të përshkruajnë të ushqyerit e viçave, gicave dhe qengjave sipas grupmoshave.
- Të shpjegojnë përllëgaritjen e lopëve foragjere, të prodhimit të qumështit dhe përqindjes së yndyrës.
- Të përshkruajnë teknologjinë e rritjes, regjimin, kujdesin dhe pajisjet te shpendët.

– Të përshkruajnë nevojat për lëndë minerale dhe vitamina në shpendët për mish dhe vezë.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Mbarështimi i kafshëve bujqësore" kl. 10-72 orë**

Tema 1	Përbërja e ushqimeve.	4 orë
Tema 2	Teknologjia e përpunimit të ushqimeve.	10 orë
Tema 3	Normat e ushqimeve për kafshët bujqësore.	6 orë
Tema 4	Teknika e hartimit të racioneve ushqimore në kafshë e shpendë.	10 orë
Tema 5	Nevojat e kafshëve bujqësore për energji dhe mikroelementë.	10 orë
Tema 6	Të ushqyerit e të imtave.	8 orë
Tema 7	Të ushqyerit e derrave.	7 orë
Tema 8	Të ushqyerit e gjedhit.	10 orë
Tema 9	Të ushqyerit e shpendëve.	7 orë

• **Synimet e lëndës "Mbarështimi i kafshëve bujqësore", kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Mbarështimi i kafshëve bujqësore" klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë veçoritë biologjike të derrave, dhenve, gjedhit, shpendëve, bletës, etj
- Të përshkruajnë eksteriorin dhe konstitucionin në derra, gjedhë, dhen dhe shpendë.
- Të përshkruajnë punën racore që bëhet në derra, gjedh dhe dhen.
- Të tregojnë në mënyrë skematike përmirësimin racor dhe kryqëzimet në kafshë.
- Të rendisin racat e kafshëve dhe shpendëve sipas drejtimit ekonomik.
- Të shpjegojnë bonitimin e racave dhe metiseve.
- Të përshkruajnë riprodhimin në kafshë, afshin dhe ciklin seksual.
- Të shpjegojnë përlllogaritjen e pjellorisë në lopë.
- Të listojnë matjet trupore dhe peshimet sipas grupmoshave në kafshë.
- Të shpjegojnë formimin, rritjen dhe ndërtimin e qimes.
- Të përshkruajnë procesin e qethjes në dhen.
- Të shpjegojnë procesin e matrikullimit në kafshë.
- Të dallojnë racat e drejtimit për mish, mish-qumësht dhe qumësht-mish në gjedh.
- Të përshkruajnë mënyrat e shumëzimit në shpend dhe çeljen e zogjve në inkubator.
- Të përshkruajnë rritjen dhe shumimin e krimbit të mendafshit, peshkut dhe bletës.
- Të shpjegojnë rritjen artificiale të peshkut dhe të ushqyerit e tij

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Mbarështimi i kafshëve bujqësore" kl. 11 – 36 orë**

Tema 1	Njohuri mbi mbarështimin e derrit.	2 orë
Tema 2	Racat e derrave dhe puna racore.	3 orë
Tema 3	Riprodhimi në derra.	2 orë
Tema 4	Racat e dhenve, konstitucioni dhe eksteriori.	2 orë
Tema 5	Teknikat e qethjes së dhenve dhe të ruajtjes së leshit.	3 orë
Tema 6	Puna racore dhe riprodhimi në dhen.	3 orë
Tema 7	Njohuri mbi mbarështimin e dhive.	2 orë
Tema 8	Njohuri mbi mbarështimin e gjedhit.	3 orë
Tema 9	Klasifikimi i gjedhit.	2 orë

Tema 10	Riprodhimi në gjedhë.	2 orë
Tema 11	Rritja e shpendëve.	3 orë
Tema 12	Rritja e bletës.	3 orë
Tema 13	Rritja e peshkut.	2 orë
Tema 14	Rritja e krimbit të mëndafshit.	2 orë
Tema 15	Mbareshtimi i njethundrakeve	2 orë

7. Lënda “Mikrobiologji veterinare” (L-07-081-21) Kl. 11 – 72 orë, Kl.12 - 72 orë

• Synimet e lëndës ”Mikrobiologji veterinare”, kl. 11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mikrobiologji veterinare” në klasën 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e shkencës së Mikrobiologjisë veterinare, rëndësinë e studimit të kësaj shkence.
- Të klasifikojnë grupet kryesore të mikrobeve sipas formës, madhësisë dhe ndërtimit.
- Të përshkruajnë jetën e mikroorganizmave.
- Të përkufizojnë çfarë është infeksioni.
- Të përshkruajnë sëmundjen infektive.
- Të përcaktojnë rrugët e hyrjes së mikrobeve në organizëm.
- Të tregojnë prejardhjen dhe llojet e infeksionit.
- Të përshkruajnë zhvillimin e sëmundjes infektive.
- Të përshkruajnë mjetet e laboratorit.
- Të përshkruajnë proceset e kryerjes së analizave laboratorike.
- Të përshkruajnë mënyrat e marrjes, paketimit e dërgimit të materialeve patologjike në laborator.
- Të shpjegojnë arsyet e kampionimit të materialeve të ndryshme biologjike për analiza.
- Të përshkruajnë teknikën e marrjes së gjakut në gjedhë, derra, dele, shpendë etj..
- Të përshkruajnë mënyrën e marrjes së kampionëve nga organet e brendshme për në laborator në raste të therjeve të forcuara.
- Të përshkruajnë procedurat standard të marrjes së mostrave për sëmundje infektive.
- Të përshkruajnë burimet parësore dhe dytësore të përhapjes së infeksionit.
- Të përshkruajnë rrugët e daljes së mikrobeve nga organizmi.
- Të theksojnë mënyrat e vetëmbrojtjes së organizmit ndaj infeksionit.
- Të përshkruajnë imunitetin dhe llojet e tij.
- Të përshkruajnë alergjinë dhe anafilaksinë.
- Të përcaktojnë antigjenet dhe antitruapat.
- Të shpjegojnë përdorimin e alergjenëve dhe të biopreparateve për diagnostikimin e sëmundjeve infektive.
- Të shpjegojnë konceptin e profilaksisë për sëmundjet infektive.
- Të përshkruajnë profilaksinë e përgjithshme dhe të veçantë për parandalimin e sëmundjeve infektive.
- Të listojë masat e profilaksisë së përgjithshme.
- Të argumentojë zbatimin e profilaksisë së veçantë.
- Të përshkruajnë konceptin e karantinës veterinare dhe rregullat bazë të saj në përputhje me ligjin veterinar.
- Të përshkruajnë konceptin e izolimit të kafshëve me sëmundje infektive dhe izolatorit, parimet themelore të funksionimit.

- Të përshkruajë mënyrat e asgjësimit të kafshëve të ngordhura, materialeve dhe mbeturinave me djegie.
- Të shpjegojë rëndësinë e personelit përkatës, masave parandaluese dhe kushtet për kafshët e sëmura.
- Të përshkruajë elementët e biosigurisë në fermë dhe rëndësinë e tyre për kontrollin e sëmundjeve infektive.
- Të përshkruajë llojet dhe format e dezinfektimit.
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e dezinfektimit dhe deratizimit.
- Të listojë llojet e dezinfektanteve dhe përdorimet e tyre në veterinarin.
- Të argumentojë faktorët përcaktues të shkallës së veprimtimit të dezinfektantëve.
- Të përshkruajë sëmundjet infektive të përgjithshme të kafshëve dhe planin profilaktik.
- Të përshkruajnë profilaksinë e përgjithshme dhe të veçantë.
- Të përcaktojnë masat e profilaksisë së përgjithshme dhe të veçantë.
- Të përshkruajë si bëhet asgjësimi i kafshëve të ngordhura.
- Të përshkruajë llojet dhe format e dezinfektimit.
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e deratizimit.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mikrobiologji veterinar”, kl. 11 - 72 orë**

Tema 1	Rëndësia dhe objekti i Mikrobiologjisë veterinar	2 orë
Tema 2	Njohuri të përgjithshme për mikrobet	5 orë
Tema 2	Shfaqja e sëmundjeve infektive	8 orë
Tema 3	Mjetet e laboratorit	5 orë
Tema 4	Kampionimi dhe analizat laboratorike	6 orë
Tema 5	Burimet e përhapjes së infeksionit	5 orë
Tema 6	Qëndresa e organizmit ndaj infeksionit	10 orë
Tema 7	Profilaksia dhe masat antiepidemike	8 orë
Tema 8	Biosiguria për sëmundjet infektive	5 orë
Tema 9	Llojet, format dhe mënyrat e dezinfektimit e deratizimit	8 orë
Tema 10	Sëmundjet infektive të përgjithshme	10 orë

• **Synimet e lëndës “Mikrobiologji veterinar” kl.12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mikrobiologji veterinar” kl.12, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë sëmundjet infektive, të njëthundrakëve, të gjedhit, të dhenve dhe dhive, derrave, shpendëve, kafshëve të reja, bletëve dhe kafshëve të shoqërit.
- Të përshkruajë veçoritë e shkaktarëve të sëmundjeve infektive.
- Të rendisin burimet e infeksionit si dhe faktorët predispozues për secilën sëmundje infektive.
- Të përshkruajnë zhvillimin e sëmundjeve infektive.
- Të përshkruajnë dhe të dallojnë shenjat klinike të sëmundjeve infektive.
- Të përshkruajnë ndryshimet anatomo-patologjike për sëmundjet e veçanta.
- Të përcaktojnë saktë diagnozën e sëmundjes.
- Të përcaktojnë planin e mjekimit dhe të hartojë planin profilaktik për sëmundjet infektive në kafshë.
- Të tregojnë si përpilohet dokumentacioni veterinar për sëmundjet infektive në kafshë të ndryshme

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mikrobiologji veterinare” kl.12-72 orë**

Tema 1	Sëmundjet infektive të përgjithshme virale.	8 orë
Tema 3	Sëmundjet infektive të përgjithshme zoonoza.	8 orë
Tema 4	Sëmundjet infektive të njëthundrakëve.	4 orë
Tema 5	Sëmundjet infektive të gjedhit.	8 orë
Tema 6	Sëmundjet infektive të dhenve e dhive.	8 orë
Tema 7	Sëmundjet infektive të derrave.	4 orë
Tema 8	Sëmundjet infektive të shpendëve.	12 orë
Tema 9	Sëmundjet infektive të kafshëve të reja.	6 orë
Tema 10	Sëmundjet infektive të bletëve.	2 orë
Tema 11	Sëmundjet infektive të kafshëve të shoqërimin.	10 orë
Tema 12	Dokumentacioni veterinar i sëmundjeve infektive.	2 orë

8. Lënda “Patologji” (L-19-082-09) Kl. 11 – 36 orë

• **Synimet e lëndës ”Patologji”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Patologji” klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë sëmundjen si dukuri patollogjike.
- Të grupojnë shkaqet e sëmundjeve patollogjike.
- Të përshkruajnë proceset regresive dhe progresive.
- Të theksojnë shkaqet dhe shenjat e proceseve regresive dhe progresive.
- Të përshkruajnë shkaqet e tumoreve.
- Të klasifikojnë tumoret.
- Të përshkruajnë pezmatimin, shenjat, llojet e tij.
- Të përcaktojnë përfundimin e vatrës pezmatuese.
- Të përshkruajnë patollogjitë e zemrës dhe shkaqet e tyre.
- Të përshkruajnë patollogjitë e organeve të tretjes.
- Të përshkruajnë patollogjitë e aparatit urinar e gjinor.
- Të përshkruajnë mënyrën, vendin dhe rregullat që zbatohen për kryerjen e autopsisë.
- Të shpjegojnë si plotësohet protokollin e autopsisë.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Patologji” kl. 11 - 36 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sëmundjen	4 orë
Tema 2	Proceset patollogjike regresive	3 orë
Tema 3	Proceset progresive në organizëm	4 orë
Tema 4	Çrregullimet lokale të qarkullimit të gjakut dhe të limfës	5 orë
Tema 5	Pezmatimi	3 orë
Tema 6	Çrregullimet termike në organizëm	1 orë
Tema 7	Patologjia e qarkullimit të gjakut	3 orë
Tema 8	Patologjia e organeve të frymëmarrjes	3 orë
Tema 9	Patologjia e aparatit të tretjes	5 orë
Tema 10	Patologjia e organeve urogjinore	2 orë
Tema 11	Autopsia	3 orë

9. Lënda “Kirurgji veterinare” (L-19-083-21), Kl. 11 - 72 orë

• Synimet e lëndës “Kirurgji veterinare” kl.11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kirurgji veterinare” kl.11, nxënësit duhet:

- Të tregojë objektin e kësaj lënde dhe lidhjen e saj me shkencat e tjera.
- Të përshkruajë metodat e fiksimit të kafshëve të ndryshme.
- Të rendisin e përshkruajnë llojet e injektiveve të barnave.
- Të përshkruajë veglat kirurgjikale.
- Të përshkruajë antiseptikën dhe aseptikën.
- Të përshkruajë anestezinë.
- Të përshkruajë përgatitjen e ekipit kirurgjikale dhe sallës së operacionit.
- Të përshkruajë përgatitjen e kafshës dhe e fushes së operacionit.
- Të përshkruajë elementet e operacionit kirurgjikal.
- Të klasifikojë gjakderdhjet.
- Të tregojë metodat e ndalimit të gjakderdhjeve.
- Të përshkruajë principet dhe rregullat e përgjithshme të qepjeve.
- Të klasifikojë plagët.
- Të përshkruajë mënyrat e e mjekimit të plagëve.
- Të përshkruajë sëmundjet e muskujve, të rajonit të zverkut, vitheve e barkut, të organeve gjinore e urinare, të syrit e gjymtyrëve, që hasen më shumë në praktikën veterinare.
- Të rendisë shkaqet e sëmundjeve.
- Të përcaktojë shenjat klinike të sëmundjeve të ndryshme.
- Të përshkruajë si përcaktohet diagnoza e sëmundjeve.
- Të theksojë rregullat për mjekim e profilaksinë e tyre.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kirurgji veterinare” Kl.11-72 orë

Tema 1	Objekti i kirurgjisë dhe lidhja me shkencat e tjera.	2 orë
Tema 2	Fiksimi i kafshëve.	4 orë
Tema 3	Injektimet dhe veglat kirurgjikale.	6 orë
Tema 4	Antiseptika, aseptika.	5 orë
Tema 5	Anestezia.	4 orë
Tema 6	Njohuri mbi përgatitjen e ekipit kirurgjikale dhe sallës së operacionit.	2 orë
Tema 7	Njohuri mbi përgatitjen e kafshës dhe e fushes së operacionit .	2 orë
Tema 8	Elementet e operacionit kirurgjikal.	8 orë
Tema 9	Gjakëderdhja, transfuzioni dhe infuzion.	3 orë
Tema 10	Bandazhimet dhe teknikat e fashimit.	3 orë
Tema 11	Kirurgjikale profilaktike.	6 orë
Tema 12	Dëmtimet e indeve të buta.	9 orë
Tema 13	Pezmatimi dhe vdekja e indeve.	6 orë
Tema 14	Patologjitë e muskujve dhe të tendinave.	3 orë
Tema 15	Patologjitë e rajonit të zverkut, vitheve dhe barkut.	3 orë
Tema 16	Patologjitë e organeve urinare dhe gjinore.	2 orë
Tema 17	Patologjitë e rajonit të kokës, të xhidavisë dhe të gjymtyrëve.	4 orë

10. Lënda “Propiodeutikë” (L-19-084-16) Kl. 11 - 36 orë, Kl.13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Propiodeutikë”, kl. 11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Propiodeutikë” klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë metodat e vlerësimit të kafshës së sëmurë.
- Të tregojnë si merret anamneza.
- Të përshkruajnë si përcaktohet habitusi i kafshëve.
- Të përshkruajnë kontrollin e aparatit tretës .
- Të përshkruajnë kontrollin e aparatit të frymëmarrjes.
- Të përshkruajnë kontrollin e aparatit kardiovaskular, SNQ.
- Të përshkruajnë tipet e frymëmarrjes.
- Të krahasojnë frymëmarrjen patollogjike me atë fiziologjike.
- Të përshkruajnë metodat e kontrollit të aparatit urinar.
- Të theksojnë rëndësinë e kontrollit të urinës në percaktimin e gjendjes së organizmit.
- Të dallojnë çrregullimet në sjelljet e kafshëve.

▪ Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Propiodeutikë”, Kl. 11 – 36 orë

Tema 1	Mënyrat e përgjithshme të diagnostikimit	4 orë
Tema 2	Kontrolli i përgjithshëm i kafshës	6 orë
Tema 3	Kontrolli i veçantë i kafshës së sëmurë	8 orë
Tema 4	Kontrolli i aparatit të frymëmarrjes	8 orë
Tema 5	Kontrolli i aparatit kardiovaskular	4 orë
Tema 6	Kontrolli i aparatit urinar	3 orë
Tema 7	Kontrolli i sistemit nervor	3 orë

• Synimet e lëndës “Propiodeutikë”, kl. 13

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ Propiodeutikë” klasa 13, nxënësit duhet:

- Të rikujtojnë organet e tretjes sipas radhës së kalimit të ushqimit.
- Të përcaktojnë vendndodhjen e organeve të tretjes dhe të emërtojnë sëmundjet përkatëse.
- Të përshkruajnë shenjat e përgjithshme dhe të veçanta për çdo sëmundje, si stomatit, faringit, timpani, retikulit, tejmbushje, kolika, etj.
- Të përcaktojnë mjekimin e përgjithshëm dhe të veçantë për çdo sëmundje të aparatit tretës.
- Të rendisin masat profilaktike për sëmundjet e aparatit tretës.
- Të përcaktojnë diagnozën në kafshët e sëmura nga timpani, retikulit, gastroenteriti, etj.
- Të përcaktojnë diagnozën në bazë të shenjave klinike të sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes në kafshë të ndryshme, bronkit, bronkopneumoni, pleurit, etj.
- Të përshkruajnë shkaqet që çojnë në sëmundjet e mësipërme të aparatit të frymëmarrjes në kafshë të ndryshme, si dhe masat profilaktike për parandalimin e sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes.
- Të përcaktojnë mjekimin e përgjithshëm e të veçantë për çdo sëmundje të aparatit të frymëmarrjes.
- Të përshkruajnë sëmundjet e aparatit kardiovaskular, shkaqet që çojnë në shfaqjen e sëmundjeve të zemrës dhe të gjakut, si perikardit, miokardit, anemi, etj.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në kafshë për sëmundjet e aparatit kardiovaskular.

- Të përcaktojnë diagnozën në bazë të shenjave klinike për sëmundjet e zembrës dhe mjekimin e kafshës me sëmundje të zembrës.
- Të përcaktojnë e përshkruajnë shkaqet që çojnë në shfaqjen e sëmundjeve të veshkave dhe aparatit urinar, shenjat klinike në kafshë për sëmundjet e aparatit urinar, si nefrite, cistite, etj.
- Të përcaktojnë diagnozën në bazë të shenjave klinike për sëmundjet e veshkave dhe mjekimin në kafshë me sëmundje të veshkave.
- Të përshkruajnë shkaqet që çojnë në shfaqjen e sëmundjeve metabolike dhe hipovitaminozave në kafshë dhe diagnozën diferenciale në bazë të shenjave klinike midis sëmundjeve metabolike dhe hipovitaminozave në kafshë.
- Të përshkruajnë mjekimin në kafshë për sëmundjet metabolike dhe hipovitaminozave dhe masat profilaktike për parandalimin e këtyre sëmundjeve.
- Të theksojnë sëmundjet që prekin sistemin nervor dhe shkaqet që çojnë në shfaqjen e këtyre sëmundjeve.
- Të përshkruajnë shenjat klinike për sëmundjet si: anemia e trurit, pika e diellit, etj. që prekin sistemin nervor
- Të përcaktojnë diagnozën në bazë të shenjave klinike për sëmundjet e sistemit nervor, mjekimin dhe masat profilaktike për parandalimin e sëmundjeve që prekin sistemin nervor në kafshë.
- Të përshkruajnë shkaqet që çojnë në shfaqjen e sëmundjeve të lëkurës, shenjat klinike në kafshë për sëmundjet e lëkurës, si dermatite, ekzema, urtikarie, etj., si dhe mjekimin e duhur.
- Të përshkruajnë shenjat e përgjithshme dhe mjekimin e kafshëve të helmuara nga lëndë kimike.
- Të theksojnë bimët helmuese të egra dhe të kultivuara, shenjat klinike në kafshë të helmuara nga duhani, sorgumi, patatja, panxhari, etj., mjekimin e kafshëve për çdo helmim bimorë, si dhe masat profilaktike për parandalimin e helmimeve bimore në kafshë.
- Të përshkruajnë sëmundjet e kafshëve të reja, si viça, mëza, qengja, etj., shenjat klinike për sëmundjet e të vegjëlve, si dispepsi, bronkopneumoni, avitaminoza, rakit, etj. mjekimin dhe masat profilaktike për parandalimin e sëmundjeve në kafshët e reja.
- Të përshkruajnë sëmundjet që prekin kafshët e shoqërimit, si qentë dhe macet, shkaqet, shenjat klinike në kafshët e shoqërimit për sëmundjet si rakiti i qenve, bronkiti i qenve, diarea në qen dhe mace, etj., mjekimin dhe masat profilaktike për parandalimin e sëmundjeve që prekin kafshët e shoqërimit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Propiodeutikë”, kl. 13 – 64 orë**

Tema 1	Sëmundjet e gojës, faringut dhe ezofagut	6 orë
Tema 2	Sëmundjet e traktit stomak-zorrë	10 orë
Tema 3	Sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes	9 orë
Tema 4	Sëmundjet e aparatit kardiovaskular	4 orë
Tema 5	Sëmundjet e aparatit urinar	5 orë
Tema 6	Sëmundjet e metabolizmit dhe hipovitaminozat	6 orë
Tema 7	Sëmundjet e sistemit nervor	5 orë
Tema 8	Sëmundjet e lëkurës	4 orë
Tema 9	Helmimet minerale dhe bimore	6 orë
Tema 10	Sëmundjet e kafshëve të reja	4 orë
Tema 11	Sëmundjet e kafshëve të shoqërimit	5 orë

11. Lënda “Riprodhimi i kafshëve” (L-19-085-16) Kl. 11 - 72 orë, kl.12 – 72 orë, kl 13-32 orë

• **Synimet e lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 11 – 72 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Riprodhimi i kafshëve” klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e studimit të riprodhimit të kafshëve dhe ndërtimin anatomik të organeve gjinorë femërorë.
- Të përshkruajnë funksionin e ndërtimin e organeve gjinorë femërorë në kafshë të ndryshme.
- Të përshkruajnë ndërtimin anatomik dhe fiziologjinë e gjirit te lopët dhe veçoritë anatomike të gjirit te kafshët e tjera bujqësorë.
- Të përshkruajnë ndërtimin anatomik dhe fiziologjinë e të organeve gjinorë mashkullorë te kafshët e ndryshme.
- Të tregojnë e diferencojnë kuptimin e pjekurisë seksuale dhe asaj truporë.
- Të përshkruajnë periudhat e zhvillimit dhe pjekjes së qelizës seksuale femërorë dhe mashkullorë.
- Të përshkruajnë ciklin seksual dhe periudhat e tij.
- Të dallojnë trupin e verdhë të ciklit seksual (periodik) nga ai i mbarsmërisë.
- Të theksojnë karakteristikat e ciklit seksual te kafshët bujqësorë.
- Të përshkruajnë hormonet që marrin pjesë në rregullimin e ciklit seksual dhe ndryshimet e organeve gjinorë tek kafshët në afsh.
- Të përkufizojnë sinkronizimin e afshit.
- Të tregojnë si realizohet sinkronizimi i afshit tek kafshët.
- Të përshkruajnë ndërzimin dhe rëndësinë praktike të njohjes së reflekseve seksuale.
- Të përshkruajnë mënyrat e ndërzimit dhe periudhat e procesit të pllenimit.
- Të përshkruajnë periudhat e zhvillimit embrional, funksionet e cipave të frytit dhe placentës, ndryshimet anatomike dhe fiziologjike te kafshët barse, si dhe zgjatjen e mbarsmërisë në kafshë të ndryshme.
- Të përcaktojnë pozicionin e mitrës te lopët në muajt e ndryshëm të mbarsmërisë.
- Të tregojnë kujdesin për kafshën barse.
- Të përshkruajnë fazat e procesit të pjelljes, shkaqet, shenjat paralajmëruese të saj.
- Të tregojnë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, kujdesin dhe ndihmën për kafshën gjatë pjelljes.
- Të përshkruajnë trajtimin e kafshëve pas pjelljes dhe trajtimin e të porsalindurve.

■ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 11 – 72 orë**

Tema 1	Rëndësia dhe objekti i riprodhimit të kafshëve	2 orë
Tema 2	Fiziologjia e organeve femërorë gjinorë	6 orë
Tema 3	Fiziologjia e gjirit	6 orë
Tema 4	Fiziologjia e organeve gjinorë mashkullorë	6 orë
Tema 5	Pjekuria seksuale dhe truporë	6 orë
Tema 6	Cikli seksual	10 orë
Tema 7	Ndërzimi dhe pllenimi i kafshëve	10 orë
Tema 8	Mbarsmëria	10 orë
Tema 9	Pjelljet te kafshët bujqësorë	10 orë
Tema 10	Kujdesi dhe trajtimi i kafshëve pas pjelljes	6 orë

• **Synimet e lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, Kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Riprodhimi i kafshëve” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të rendisin shkaqet e dhembjeve të parakoshme dhe të dështimeve në kafshë.
- Të përcaktojnë llojet e dështimeve në kafshët femra.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në pjelljet e vështira në kafshë.
- Të ndërhyjnë në rregullimin e pozicionit të frytit në pjelljet e vështira.
- Të përcaktojnë metodat gjatë ndërhyrjeve pa gjak në pjelljet e vështira.
- Të rendisin mjetet dhe instrumentet që përdoren në pjelljet e vështira.
- Të përcaktojnë shkaqet që çojnë në mbetjet e shtratit dhe prolapsin e vaginës dhe mitrës në kafshë të ndryshme.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në lopët me mbetje shtratit dhe prolaps të vaginës dhe mitrës në kafshë të ndryshme.
- Të përcaktojnë mjekimin për kafshët me mbetje shtrati dhe prolaps të vaginës dhe të mitrës.
- Të rendisin shkaqet që çojnë në pezmatimin e organeve gjinore.
- Të përshkruajnë shenjat klinike të lopëve me pezmatime të organeve gjinore, si të mitrës, të ovidukteve dhe të vezoreve.
- Të përcaktojnë masat parandaluese dhe mjekimin në pezmatimet e organeve gjinore si metrite, patologji të vezoreve, etj.
- Të rendisin shkaqet që çojnë kafshët femra në shterpësi të përkohshme dhe të përhershme.
- Të përkufizojnë shfaqjen e mastiteve në kafshë.
- Të rendisin shkaqet që çojnë në shfaqjen e mastiteve në lopë dhe në kafshë të tjera.
- Të klasifikojnë llojet e mastiteve sipas kohëzgjatjes dhe karakterit të pezmatimit.
- Të përshkruajnë shenjat klinike të lopëve me mastite.
- Të dallojnë mastitet klinike nga mastitet subklinike (të fshehta) në lopë.
- Të përcaktojnë masat parandaluese dhe mjekimin në lopët me mastite.
- Të përcaktojnë shkaqet që çojnë në shfaqjen e plagëve të gjirit dhe të thithave.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në kafshët me plagë të gjirit dhe të thithave.
- Të dallojnë mastitet nga plagët e gjirit dhe të thithave në kafshë.
- Të përcaktojnë shkaqet që çojnë në shfaqjen e asfiksionit, ftohjes trupore dhe hipoglicemisë në kafshët e porsalindura.
- Të përshkruajnë shenjat e asfiksionit, ftohjes trupore dhe hipoglicemisë në kafshët e porsalindura.
- Të përcaktojnë masat për parandalimin e asfiksionit, ftohjes trupore dhe hipoglicemisë në kafshët e porsalindura.
- Të përcaktojnë mjekimin për kafshët e porsalindura me asfiksion, ftohje trupore dhe hipoglicemi.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, Kl. 12 – 72 orë**

Tema 1	Patologjitë e barrës	8 orë
Tema 2	Patologjitë e kafshës në pjelljet e vështira	10 orë
Tema 3	Patologjitë e kafshës pas pjelljes	9 orë
Tema 4	Sëmundjet e organeve gjinore	8 orë

Tema 5	Patologjitë e vezoreve	10 orë
Tema 6	Sëmundjet e gjendrës së gjirit.	10 orë
Tema 7	Patologjitë e lëkurës së gjirit dhe të thithave.	8 orë
Tema 8	Sëmundjet e kafshëve të porsalindura.	9 orë

• **Synimet e lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, Kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Riprodhimi i kafshëve” klasa 13, nxënësit duhet:

- Të përcaktojnë kohën më të përshtatëshme të futjes në riprodhim të gjedhit dhe të imtave.
- Të tregojnë karakteristikat sipas prejardhjes racore të damazëvë gjatë zgjedhjes për inseminim artificial.
- Të rendisin detyrat e teknikut të stacionit të inseminimit artificial në të imta.
- Të përcaktojnë planimetrinë e stacionit të inseminimit artificial në të imta.
- Të përcaktojnë instrumentet që nevojiten në stacionin e inseminimit artificial në të imta.
- Të përcaktojnë kimikatet që nevojiten në stacionin e inseminimit artificial në të imta.
- Të përshkruajnë treguesit e jashtëm dhe mikroskopik të spermës.
- Të përshkruajnë mënyrën e inokulimit të spermës në delet e ardhura në afsh.
- Të përcaktojnë planimetrinë e stacionit të inseminimit artificial në lopë.
- Të rendisin instrumentet që nevojiten në stacionin e inseminimit artificial në lopë.
- Të tregojnë rregullat e marrjes, transportimit, ruajtjes dhe vlerësimit të spermës së holluar në stacionin e inseminimit artificial në lopë.
- Të përshkruajnë shenjat më të rëndësishme të afshit në lopë.
- Të përshkruajnë metodën rektocervikale të inseminimit artificial në lopë.
- Të tregojnë përparësitë e metodës rektocervikale të inseminimit artificial në lopë.
- Të përcaktojnë dokumentacionin e teknikut të inseminimit artificial te lopët.
- Të tregojnë përparësitë e inseminimit artificial në dosa, pela dhe shpendë.
- Të përcaktojnë veçoritë kryesore të aparatit gjinor te shpendët.
- Të përshkruajnë metodën e marrjes, filtrimit, vlerësimit dhe hollimit të spermës së harçave, hamshorëve dhe gjelave.
- Të rendisin mjetet dhe instrumentet që nevojiten në stacionin e inseminimit artificial në derra, njëthundrakë dhe shpendë.
- Të përshkruajnë mënyrën e inokulimit të spermës në dosa, pela dhe shpendë.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, Kl. 13 – 32 orë**

Tema 1	Inseminimi artificial	7 orë
Tema 2	Inseminimi artificial në dhen e dhi	9 orë
Tema 3	Inseminimi artificial i lopëve	9 orë
Tema 4	Inseminimi artificial në derra	3 orë
Tema 5	Inseminimi artificial në njëthundrakë	2 orë
Tema 6	Inseminimi artificial në shpendë	2 orë

12. Lënda “Farmakologji” (L-19-221-11) Kl. 12 - 36 orë

• Synimet e lëndës “Farmakologji”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Farmakologji” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë objektin e studimit të farmakologjisë.
- Të klasifikojnë e përshkruajnë veprimet e barit në organizëm.
- Të tregojnë mënyrat e futjes së barnave në organizëm.
- Të përshkruajnë dukuritë që ndodhin gjatë veprimit të përsëritur të barnave në organizëm.
- Të përkufizojnë recetën e të rendisë pjesët e recetës.
- Të përpilojnë receta të ndryshme.
- Të tregojnë njesitë matëse të farmacisë.
- Të përshkruajnë trajtat e ndryshme farmaceutike (ngurta, buta, lëngta).
- Të përshkruajnë veprimin e substancave që veprojnë në mbulesa mukoze dhe lëkure
- Të klasifikojnë substancat që veprojnë në mbulesa mukoze dhe lëkure (rrudhëse, djegëse, zbutëse, oreksndjellëse, purgative, vjellëse etj).
- Të përshkruajnë veprimin dhe të klasifikojnë substancat që veprojnë në sistemin nervor.
- Të përshkruajnë veprimin e klasifikojnë substancat që veprojnë në disa organe e metabolizëm.
- Të përshkruajnë veprimin e të rendisin disa nga substancat antimikrobike më të përdorshme në praktikën veterinare.
- Të përshkruajnë veprimin e të rendisin disa nga preparatet vitaminike e hormonale.

■ Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Farmakologji”, kl. 12 – 36 orë

Tema 1	Rëndësia dhe objekti i farmakologjisë	1 orë
Tema 2	Bashkëveprimi midis barit dhe organizmit	3 orë
Tema 3	Receptura	5 orë
Tema 4	Substancat që veprojnë në mbulesa mukoze e lëkurë	10 orë
Tema 5	Substancat që veprojnë në sistemin nervor	5 orë
Tema 6	Substancat që veprojnë disa organe e metabolizëm	3 orë
Tema 7	Substancat antimikrobike	7 orë
Tema 8	Preparatet e vitaminave dhe hormoneve	2 orë

13. Lënda “Parazitologji” (L-19-222-16) Kl. 12 - 36 orë, Kl. 13 - 64 orë

• Synimet e lëndës “Parazitologji”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Parazitologji” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë dhe objektin e studimit të Parazitologjisë veterinare.
- Të përshkruajnë trajtat e lidhjeve parazit-përbujtës, rrugët e infektimit të kafshëve me parazit dhe veçoritë e parazitozave.
- Të përshkruajnë karakteristikat e sëmundjeve parazitare.
- Të përshkruajnë metodat e diagnotsikimit e sëmundjeve parazitare në kafshët e gjalla dhe të ngordhura.
- Të përkufizojnë sëmundjet parazitare që prekin kafshët dhe shpendët të shkaktuara nga tremadodët dhe cestodet.

- Të përshkruajë morfologjinë dhe zhvillimin biologjik të parazitit, shkaktar të sëmundjes.
- Të përcaktojnë shkallën e prekshmërisë për kategori të ndryshme kafshësh.
- Të përshkruajnë dhe dallojnë shenjat klinike të sëmundjes parazitare.
- Të përshkruajnë ndryshimet anatomo-patologjike të organeve të infestuara.
- Të përcaktojnë saktë diagnozën.
- Të përcaktojnë saktë masat që merren për mjekimin e duhur dhe për parandalimin e sëmundjeve parazitare.

■ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Parazitologji”, kl. 12 – 36 orë**

Tema 1	Rëndësia dhe objekti i studimit të Parazitologjisë	2 orë
Tema 2	Njohuri të përgjithshme mbi Parazitologjinë	4 orë
Tema 3	Helmitologjia	8 orë
Tema 4	Trematodologjia	6 orë
Tema 5	Njohuri për cestodozat	2 orë
Tema 6	Cestodozat e shkaktuara nga trajtat e rritura	8 orë
Tema 7	Cestodozat e shkaktuara nga format larvore	6 orë

● **Synimet e lëndës “Parazitologji”, kl. 13 – 64 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Parazitologji” klasa 13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë sëmundjet parazitare që prekin kafshët dhe shpendët të shkaktuara nga nematodët.
- Të përshkruajnë sëmundjet parazitare që prekin kafshët dhe shpendët të shkaktuara nga artropodët.
- Të përshkruajnë sëmundjet parazitare që prekin kafshët dhe shpendët të shkaktuara nga araknidet dhe protozoarët.
- Të përshkruajë morfologjinë dhe zhvillimin biologjik të parazitit, shkaktarit të sëmundjes.
- Të përcaktojnë shkallën e prekshmërisë për kategori të ndryshme kafshësh.
- Të përshkruajnë dhe dallojnë shenjat klinike të sëmundjes parazitare.
- Të përshkruajnë ndryshimet anatomo-patologjike të organeve të infestuara.
- Të përcaktojnë diagnozën dhe masat që merren për mjekimin e duhur dhe për parandalimin e sëmundjeve parazitare.

■ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Parazitologji”, kl. 13 – 64 orë**

Tema 1	Njohuri mbi nematodët	2 orë
Tema 2	Askaridiazat dhe oksiuozat	7 orë
Tema 3	Strongilatozat	8 orë
Tema 4	Spiruratozat dhe trikocefalatozat	3 orë
Tema 5	Njohuri mbi sëmundjet araknide	2 orë
Tema 6	Zgjedbet e kafshëve	8 orë
Tema 7	Sëmundjet e shkaktuara nga rriqnat	4 orë
Tema 8	Entomologjia	12 orë
Tema 9	Protozoologjia	8 orë
Tema 10	Koksidiozat	6 orë
Tema 11	Sëmundjet që shkaktohen nga kamxhikorët	4 orë

14. Lënda “Kontroll blegtoral” (L-19-223-16), Kl. 13 - 32 orë

• Synimet e lëndës “Kontroll blegtoral”, kl. 13

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kontroll blegtoral” klasa 13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e kësaj lënde dhe të tregojnë mënyrat e transportimit të kafshëve përpara therjes.
- Të klasifikojnë kafshët sipas majmërisë.
- Të rendisin kërkesat që duhet të plotësojnë thertoret si dhe të përshkruajnë mënyrat e therjes së kafshëve.
- Të theksojnë rëndësinë e kontrollit veterinar të mishit dhe të përshkruajnë si realizohet ai për sëmundje infektive dhe parazitare.
- Të tregojnë se çfarë quhet mish dhe të rendisin elementet përbërës të tij si dhe faktorët që ndikojnë në përbërjen e tij.
- Të shpjegojnë rrezën e mishit si përcaktohet ajo si dhe të përshkruajnë cilësitë e klasifikimit të mishit në kafshë.
- Të përshkruajnë mënyrat e konservimit të mishit dhe produkteve të tij, të dallojnë defektet e konservimit apo defektet e sallameve dhe të përcaktojnë shkaqet e formimit të tyre.
- Të tregojnë përbërjen e qumështit, rëndësinë e kontrollit të tij e të përshkruajnë marrjen e mostrave të qumështit si dhe të rendisin karakteristikat organoleptike që kontrollohen.
- Të tregojnë rëndësinë e kontrollit të peshkut dhe të rendisin karakteristikat organoleptike që kontrollohen.
- Të përshkruajnë mënyrat e kontrollit të vezëve dhe të dallojnë shkallën e freskisë së vezëve.
- Të njihen me ligjin e shërbimit veterinar për kontrollin e mishit.

■ Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kontroll blegtoral”, kl. 13 – 32 orë

Tema 1	Rëndësia e kontrollit të prodhimeve blegtorale.	1 orë
Tema 2	Transporti e kontrolli i kafshëve para therjes.	4 orë
Tema 3	Therja e kafshëve.	8 orë
Tema 4	Përbërja dhe vlerësimi i mishit.	3 orë
Tema 5	Ekspertiza e mishit dhe produkteve të tij.	10 orë
Tema 6	Ekspertiza e qumështit, peshkut dhe vezëve.	6 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Të ushqyerit e kafshëve bujqësorë”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	TË USHQYERIT E KAFSHËVE BUJQËSORË	M-19-228-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të përgatitur ushqimet, për të ushqyer kafshët në regjim stallor, si dhe në kullotje të lirë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përzgjedh ushqimet për të ushqyer kafshët në regjim stallor. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë ushqimet e gjelbërta.– të përzgjedhë saktë bimët rrënjorë që përdorën si ushqim për kafshët.– të përzgjedhë saktë ushqimet e ashpra: bar i thatë, kashtë, silazh, bërsi të ndryshme, etj.– të përzgjedhë saktë ushqimet e koncentruara. drithra të bluara dhe të pabluara, si misër, grurë, elb, thekër, tërshërë, soja, luledielli, etj.– të përzgjedhë saktë ushqimet me prejardhje shtazorë, si miell peshku, miell mishi, miell kockash, qumësht, vezë, etj.– të zbatojë me kujdes rregullat e ruajtjes së mjedisit gjatë përzgjedhjes së ushqimeve për kafshët bujqësorë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje-përgjigje me gojë. <p>RM 2 Nxënësi ushqen kafshët në regjim stallor. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë veglat e nevojshme të punës për të ushqyer kafshët bujqësorë;– të përzgjedhë llojin e ushqimit sipas llojit dhe nevojës së kafshës me regjim stallor;– të bëjë pastrimin e grazhdit përpara hedhjes së ushqimit;	

- të bëjë përpunimin paraprak të ushqimeve: copëtimin, lagjen etj, për kafshët bujqësorë, në varësi të llojit të ushqimit;
- të kontrollojë cilësisë e ushqimeve të magazinuara me anë të prekjës, nuhatjes dhe dallimit të ngjyrës së ushqimeve;
- të transportojë ushqimet nga magazina në stallë me krah ose mjete të tjera të thjeshta sipas llojit të ushqimit;
- të bëjë ndarjen racionale të ushqimit për krerë bazuar në mos dhe drejtimin e mbarështimit të tyre;
- të realizojë vendosjen e ushqimeve në vendin e caktuar për ngrënie (grazhd);
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të kafshëve bujqësorë në fermë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen kullotjen e lirë të kafshëve bujqësorë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përcaktojë territorin e duhur për kullotjen e kafshëve bujqësorë;
- Të përgatitë mjedisin për kullotjen e kafshëve shtëpiake;
- Të përgatitë kafshët për daljen në kullotë;
- Të ushqejë kafshët me kalime, sipas një praktike pozitive fermere;
- Të realizojë kullotjen e lirë të kafshëve;
- Të përdorë gardhet elektrike dhe pengesave të tjera në kullotë, kur është e nevojshme;
- Të ndalojë kafshët në vendin më të përshtatshëm për kullotje;
- Të kujdeset për kafshët në fushë të hapur;
- Të kthejë shëndosh e mirë kafshët në fermë;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të kafshëve në kullotë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në territorin e fermës së shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme për kullotje pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizohen edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë blegtorinë me regjim stallor.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të të ushqyerit të kafshëve.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me vlerat ushqyese të ushqimeve të fermës dhe përshtatshmërinë e tyre për lloje të ndryshme kafshësh.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përzgjedhjen e ushqimeve, transportimin e tyre në stallë, si dhe

për realizimin e të ushqyerit të kafshëve me regjim stallor apo kullotje të lirë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të ushqyerit të kafshëve me regjim stallor ose kullotje të lirë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë për rritjen e kafshëve.
 - Tokë kullosorë.
 - Punishte ushqimi.
 - Magazinë ushqimi.
 - Depo silazhi.
 - Tabela analitike të ushqimeve.
 - Tabela për nevojat ushqimorë të kafshëve.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Manuale praktike për të ushqyerin e kafshëve.
 - Katalogje ushqimesh etj.
-

2. Moduli “Kujdesi për higjienën e kafshëve”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUJDESI PËR HIGJENËN E KAFSHËVE	M-19-229-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer procese pune për pastrimin e lëkurës, gjirit, thundrave të kafshëve, si dhe për kryerjen e shërbimeve higjienike dhe klimatike në stalla blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi pastron lëkurën e trupit të kafshës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të zgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet që përdoren për pastrimin e trupit të kafshës nga dëmtuesit dhe parazitët e lëkurës së kafshëve;– të veshë uniformën për të kryer pastrimin e lëkurës së kafshës nga parazitët dhe dëmtuesit e saj;– të kryejë pastrimin e lëkurës së kokës së kafshës sipas teknikës përkatëse.– të kryejë pastrimin e lëkurës së gjymtyrëve të përparme të kafshës sipas teknikës përkatëse.– të kryejë pastrimin e lëkurës së gjymtyrëve të pasme të kafshës sipas teknikës përkatëse.– të kryejë pastrimin e lëkurës së pjesës kryesore të kafshës sipas teknikës përkatëse.– të lajë dhe dezinfektojë duart pas pastrimit të lëkurës së kafshëve.– të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbajtjes së higjienës së lëkurës së trupit të kafshës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi kujdeset për higjienën e thundrave të kafshëve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të zbatojë rregullat për higjienën e thundrave të kafshës.– Të kontrollojë gjendjen e veglave të punës për pastrimin e	

thundrave.

- Të përcaktojë saktë radhën e punës gjatë procesit të pastrimit të thundrave.
- Të përzgjedhë mjetet dhe veglat për pastrimin e thundrave.
- Të zbatojë saktë radhën e punës për pastrimin e thundrave.
- Të realizojë siç duhet pastrimin e thundrave të kafshës.
- Të vendosë me kujdes pajisjet, veglat e punës dhe instrumentet prerës në vendin e duhur pas prerjes së thundrave.
- Të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik gjatë pastrimit të thundrave.
- Të mbajë pastër vendin e punës dhe mjedisin nga mbeturinat që përftohen gjatë procesit të pastrimit të thundrave të kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen pastrimin e gjirit të kafshës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë sipas radhës së punës proceset për pastrimin dhe larjen e gjirit.
- të përzgjedhë saktë mjetet që nevojiten për pastrimin, larjen dhe masazhimin e gjirit.
- të përgatisë siç duhet mjetet që nevojiten për pastrimin, larjen dhe masazhimin e gjirit.
- të bëjë pastrimin e lehtë mekanik për të hequr papastërtitë e ndryshme në gjirin e kafshës.
- të bëjë larjen e gjirit me pece dhe ujë të ngrohtë.
- të bëjë masazhimin e gjirit me pece dhe ujë të ngrohtë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të gjirit
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
- të zbatojë drejt masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për pastrimin dhe larjen e gjirit.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen shërbime higjienike dhe klimatike në stallë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë veglat dhe mjetet për largimin e plehut organik nga stalla.
- të largojë në kohën e duhur plehun nga stalla.
- të pastrojë vendin e hedhjes së plehut për ruajtjen e mjedisit.
- të dezinfektojë vendin e hedhjes së plehut për ruajtjen e mjedisit.

- të transportojë në kohë dhe me mjetet e duhura plehun organik për në plehërishte.
- të grumbullojë urinën në depozita të posaçme.
- të trajtojë urinën e grumbulluar në çisternë.
- të hapë dritaret për ajrimin e stallës;
- të mirëmbajë e veglat dhe pajisjet për heqjen e mbeturinave organike.
- të bëjë regjistrim të saktë të operacioneve të kryera.
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik në punë gjatë largimit të mbeturinave në stallë.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës, në stallë ose të organizohen vizita mësimorë në ferma blegtorale pranë rajonit ku ndodhet shkolla.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për higjienën e trupit të kafshëve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ato përfshijnë: pastrimin e lëkurës, të gjirit të kafshës, pastrimin e thundrave, si dhe higjienizimin dhe klinatizimin e ambjenteve.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për mënyrat e mbajtjes së higjienës së kafshëve.
- Nxënësit duhet të përfshihen në punë konkrete për përdorimin sa më të mirë të veglave të punës dhe pajisjeve të cilat përdoren për ruajtjen e higjienës së kafshëve dhe ambjenteve përreth.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e tyre.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Per realizimin si duhet te modulit eshte e domosdoshme te sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e meposhtme:
- Fermë blegtorale.
 - Plehërishtë dhe depozitë të urinës.
 - Makineri, pajisje dhe vegla të punës për largimin e plehut.
 - Komplete instrumentash për pastrimin e thundrave (thikë thundrash, limë, pinca etj).
 - Maket gjiri, peshqire, pece, kova uji.
 - Krehër druri, furça, sfungjerë, thika te drunjta.
-

3. Moduli “Dezinfektimi i stallave dhe i territoreve jashtë saj”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DEZINFEKTIMI I STALLAVE DHE I TERRITOREVE JASHTË SAJ	M-19-230-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të dezinfektuar stallat dhe territorët jashtë saj, për zhdukjen e sëmundjeve të shfaqura dhe për të ndaluar shfaqjen e sëmundjeve infektive në fermat bujqësorë e blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit stallën dhe territorin për dezinfektim. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të veshë patjetër uniformën e punës;– Të përcaktojë radhën e punës për pastrimin e stallës dhe territorit;– Të largojë kafshët nga stalla dhe territori;– Të ajrosë stallat duke hapur dyert dhe dritaret;– Të përzgjedhë veglat për pastrimin e stallës;– Të kryejë pastrimin e stallës nga plehu organik;– Të largojë nga grazhdet ushqimet dhe mbeturinat e tij;– Të kryejë pastrimin padokëve rreth stallës;– Të transportojë plehun dhe mbeturinat e ushqimit në plehërishte. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi përgatit mjetet dhe materialet e punës për dezinfektimin e stallës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përdorë patjetër veshjet mbrojtëse gjatë punës.– të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës për dezinfektim.– të përzgjedhë saktë llojet e dezinfektantëve sipas udhëzimeve të dhëna.– të kryejë me shumë kujdes transportimin e materialeve, veglave të punës dhe dezinfektantëve në vendin e duhur.	

- të dezinfektojë me shumë kujdes pajisjet si: pompat (spërkatëse e pluhurosëse), lopatat, flakëhedhësen, etj.
- të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së mjeteve të punës për dezinfektimin e stallave dhe territoreve të fermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi përgatit tretësirën për dizinfektimin kimik të stallave dhe territoreve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë sipërfaqen e ambientit dhe të territorit që do të dezinfektojë sipas kriterëve.
- të sigurojë llojin e dezinfektantit sipas rekomandimit;
- të sigurojë sasisë e dezinfektantit që do të përdorët sipas rekomandimit të specialistit;
- të sigurojë sasinë ujit për tretjen e dezinfektantit sipas rekomandimit;
- të llogarisë saktë sasinë e ujit për tretje të dezinfektantit.
- të përgatisë me shumë kujdes tretësirën e dezinfektantit sipas rekomandimeve;
- të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tretësirës për dezinfektimin e stallave dhe territoreve të fermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen dezinfektimin kimik dhe termik të stallave dhe territoreve të fermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë pluhur gëlqere në dyshemenë e stallës.
- të mbushë në nivelin e duhur pompën spërkatëse ose pluhurosëse me dezinfektantë kimik.
- të spërkasë ose të pluhurosë me kujdes stallën dhe territorin përreth.
- të zhysë në tretësirë dezinfektuese materialet, si kova, vegla pastrimi të kafshëve, zinxhirët, etj.
- të lajë me fërkim me tretësirë lokalet, dyshemetë, dyertë, grazhdet, koritat e ujit, etj.
- të përdorë flakëhedhësen në dezinfektimin me djegie në sipërfaqe të kufizuara të stallës.
- të dezinfektojë me djegie vendin e ngordhjes së kafshëve me sëmundje ngjitëse.
- të dezinfektojë me djegie objekte dhe materiale që nuk digjen.
- të largojë mbeturinat dhe pastrojë mjedisin sipas parametrave të kërkuara higjienike.

- të shtrohet, pas dezinfektimit në stallat me çimento, shtresa e re për kafshët me tallash dhe kashtë.
- të pastrojë si veglat dhe pajisjet pas punës.
- të kryejë pastrimin vetjak pas punës.
- të marrë masat për sigurimin e territorit pas dezinfektimit.
- të bëjë një regjistrim të saktë të operacioneve të kryera.
- të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të metodave të ndryshme për dezinfektimin e stallave dhe territoreve të fermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale, në stallat dhe territorët pranë shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimit të veglave dhe pajisjeve për dezinfektimin e stallave.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të përdorur veglat dhe pajisjet e pastrimit dhe dezinfektimit të stallave dhe territoreve fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për pastrimin dhe dezinfektimin e stallave dhe territoreve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për pastrimin dhe dezinfektimin e stallave dhe territoreve të fermës blegtorale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriteve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë për rritjen e kafshëve.
- Pompa spërkatëse, pluhurosese, flakëdhënëse.
- Lopata, cfurqe, gërryese, furça, karrocë dorë, etj.
- Komplete veshje pune për dezinfektim.
- Peshqire, pece, kova uji.
- Dezinfektant kimik (kreolinë, sodë kaustike, klor, etj).
- Gëlqere.

4. Moduli “ Higjiena e prodhimeve blegtorale ”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	HIGJIENA E PRODHIMEVE BLEGTORALE	M-19-1800-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për rregullat higjienike që zbatohen për qumështin, vezët dhe leshin.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar.	

Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi kryen procese higjienike për qumështin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë.
- të veshë rroba të pastra për punë.
- të lajë duart me ujë të ngrohtë e sapun për të siguruar higjenën personale.
- të pastrojë enët para dhe pas mjeljes
- të lajë bidonat, kovat dhe gotat mjelëse fillimisht me ujë të ftohtë.
- të përgatisë solucionet larës të përshtatshëm
- të lajë enët me furçë, me ujë të ngrohtë dhe pluhur larës\ solucionet.
- të shpëlajë me ujë të rrjedhshëm bidonat dhe gotat mjelëse
- të vendosë në rafte enët që të kullojnë mirë
- të kullojë me sita qumështin e mjelë me dorë, në bidon ose cisterna.
- të kryejë mbylljen e bidonëve ose cisternave me kapak hermetik
- të largojë menjëherë pas mjeljes qumështin nga stalla
- të kryejë transportin e qumështit për procesin e ftohjes
- të kryejë ruajtjen e qumështit në tankun ftohës në temp. 4 °C
- të zbatojë me rigozitet rregullat e sigurimit teknik, në ruajtjen dhe transportin e qumështit për në fabrikat e përpunimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen procese higjienike për vezët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë pajisjet, mjetet dhe materialet për higjienën e vezëve në furriqet e kotecit/lokalit të pulave;
- të përcaktojë radhën e punës për proceset higjienike;
- të kontrollojë shtresën e kotecit që të jetë sa më higjienike;
- të kontrollojë furriqet e pjelljes së pulave për kashtë të pastër dhe të thatë;
- të kontrollojë higjienën e baterive të lokaleve të pulave;
- të grumbullojë vezët në kotecët dhe bateritë e pulave disa herë në ditë;
- të vendosë vezët e grumbulluara në arka të shtruara me kashtë/në formate të posaçme;
- të shënojë sasinë e vezëve të grumbulluara.
- të realizojë ruajtjen e vezëve në kushte optimale të temperaturës dhe lagështisë;
- të realizojë ruajtjen e vezëve në frigorifer në temperaturë 0 – 2 °C dhe lagështirë 85 – 88 %;
- të realizojë ruajtjen e vezëve në vende të freskëta me lagështirë 80 – 85 %;
- të kontrollojë vezët për defekte, si plasaritja e lëvozhgës, papastërtia dhe jashtëqitjet;
- të lajë duart pas mbarimit të procesit të punës për higjienën e vezëve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë grumbullimit, ambalazhimit dhe ruajtjes së vezëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen procese për higjienën e leshit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë leshin e dhenve sipas kriterëve higjienike.
- të bëjë pastrimin e leshit nga papastërtitë dhe rrodhet para qethjes.
- të kryejë pas qethjes heqjen e bashkës pa e dëmtuar atë
- të mbledhë bashkën në formë ruli me pjesët e qethura nga jashtë;
- të kryejë paketimin dhe lidhjen e bashkës;
- të vendosë me kujdes bashkën në thasë të mëdhenj, sipas hollësisë së leshit
- të kontrollojë parametrat higjienike dhe teknike të depove;
- të dorëzojë leshin e ambalazhuar në thasë, në depo të posaçme/pikat e grumbullimit
- të respektojë rregullat e higjienës për ruajtjen e leshit nga myku, krimba dhe parazitë të tjerë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për higjienizimin e leshit

te dhentë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë në stallën pranë shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për higjienizimin e prodhimeve blegtorale (të qumështit, vezëve dhe leshit).
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për higjienizimin e prodhimeve blegtorale, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me mjeljen me dorë dhe mekanike.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të higjienizimit të prodhimeve blegtorale (qumësht, vezë dhe lesh).
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veshjes personale.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për higjienizimin e prodhimeve blegtorale.
 - Manuale ose katalogje për higjienizimin e prodhimeve blegtorale.
 - Fotografi me pamje të punëve të ndryshme gjatë higjienizimit të prodhimeve blegtorale.
 - Pamje filmike të proceseve të punës gjatë higjienizimit të prodhimeve blegtorale.
-

5. Moduli “Përcaktimi i organeve të brendshme te kafshët”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRCAKTIMI I ORGANEVE TË BRENDSHME TE KAFSHËT	M-19-232-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer procese pune për përcaktimin e organeve të aparatit tretës, të aparatit të frymëmarrjes, të aparatit të qarkullimit të gjakut dhe të sistemit uro-gjinor te kafshët bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përcakton organet e aparatit tretës te kafsha. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të veshë kompletin e punës, përparësen, kapuçin, dorashkat e llastikut.– të pregatisë siç duhet tryezën dhe tavat e punës.– të sistemojë orënditë, kovat, ujë, thikë, bisturi, gërshtë, pinca anatomike, kirurgjikale, pambuk ting-jodi etj.– të vendosë kufomën e kafshës mbi tryezë në pozicionin e duhur.– të hapë kufomën e kafshës duke e prerë sipas radhës nga koka deri te bishti, përgjatë vijës së bardhë.– të përcaktojë rajonet e traktit të tretjes: pjesën fillestare, të përparme, të mesit dhe pjesën e fundit.– të përcaktojë organet e pjesës fillestare: zgavrës së gojës-dhëmbët, gjuhën, qiellzën, gjëndrave të pështymës dhe fytit.– të përcaktojë organet e pjesës së përparme: kapërcellit, stomakut dhe pjesës fillestare të dymbëdhjetë gishtorës, ku derdhen gjëndrat e tëmthit dhe pankreasit.– të përcaktojë organet e pjesës së mesit: zorrëve të holladymbëdhjetë gishtorës, zorrës së zbrazët dhe zorrës capokorë.– të përcaktojë organet e pjesës së fundit: zorrëve të trashazorra qorre, coloni i madh, koloni i vogël dhe rectum.– të përcaktojë mëlçinë, tëmthin dhe pankreasin.– të përcaktojë shtresat e brëndëshme te organeve të aparatit	

tretës.

- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për përcaktimin e organeve të aparatit tretës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 2 Nxënësi përcakton organet e aparatit të frymëmarrjes të kafsha.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletin e punës, përparëse, kapuç, dorashka llastiku.
- të përgatisë tryezën dhe tavat e punës.
- të sistemojë orënditë, kovë, ujë, thikë, bisturi, gërshërë, pinca anatomike, kirurgjikale, pambuk ting, jodi etj.
- të vendosë kufomën e kafshës mbi tryezë në pozicionin e duhur.
- të nxjerrë pa i dëmtuar organet e aparatit të frymëmarrjes.
- të përcaktojë zgavrren e hundës: konkat, korridorët.
- të përcaktojë fythin.
- të përcaktojë laringun.
- të përcaktojë trakenë dhe bronket.
- të përcaktojë mushkëritë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për përcaktimin e organeve të aparatit të frymëmarrjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 3 Nxënësi përcakton organet e sistemit (aparatit) të qarkullimit të gjakut të kafsha.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletin e punës, përparëse, kapuç, dorashka llastiku.
- të përgatisë tryezën dhe tavat e punës.
- të sistemojë orënditë, kovë, ujë, thikë, bisturi, gërshërë, pinca anatomike, pinca kirurgjikale, pambuk ting, jodi etj.
- të vendosë kufomën e kafshës mbi tryezë në pozicionin e duhur.
- të nxjerrë organet e sistemit të qarkullimit të gjakut: zemrën, arteriet dhe venat.
- të përcaktojë dhomat e zemrës: veshët (atriumet), barkushet (ventrikulat), kllapat (ostiumet).
- të përcaktojë arterjet.
- të dallojë aortën.

- të përcaktojë venat.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për përcaktimin e organeve të sistemit të qarkullimit të gjakut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 4 Nxënësi përcakton organet e sistemit uro-gjinor te kafsha.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletin e punës, përparëse, kapuc, dorashka llastiku.
- të pregatisë tryezën dhe tavat e punës.
- të sistemojë orënditë, kovë, ujë, thikë, bisturi, gërshërë, pinca anatomike, kirurgjikale, pambuk tingjodi etj.
- të vendosë kufomën e kafshës mbi tryezë në pozicionin e duhur.
- të nxjerrë organet e sistemit urinar: veshkat, tubat përciellës të urinës dhe fshikzën e urinës.
- të përcaktojë veshkat, tubat përciellës dhe fshikzën e urinës.
- të krahasojë veshkat (e majtë e djathtë).
- të nxjerrë organet e sistemit gjinor femëror.
- të përcaktojë vezorët, oviduktet, mitrën, brirët dhe qafën e mitrës, vaginën dhe vestibulin e vaginës etj.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për përcaktimin e organeve të sistemit uro-gjinor.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës, në stallë ose në thertorë pranë rajonit ku ndodhet shkolla.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për përcaktimin dhe përshkrimin e organeve të brëndshme të kafshëve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për mënyrat e mbajtjes së higjienës së organeve të nxjerra për kontroll.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për përdorimin sa më të mirë të veglave të punës, instrumentave dhe pajisjeve në një fermë blegtorale, stallë ose thertorë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi në kontrollin e demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Per realizimin si duhet te modulit eshte e domosdoshme te sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e meposhtme:

- Thertorë, stallë fermë për rritjen e kafshëve.
 - Kafshë e therur dhe organe të brëndshme.
 - Tryeza pune me material të pa përshkrueshëm nga uji.
 - Komplete instrumentash për hapjen e organeve.
 - Komplete veshjeje, peshqir, kove, ujë.
 - Atlas anatomie.
-

6. Moduli “Fiksimi i kafshëve të kategorive të ndryshme”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	FIKSIMI I KAFSHËVE TË KATEGORIVËE TË NDRYSHME	M-19-233-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të fiksuar kafshët e kategorive të ndryshme në pozicionin në këmbë dhe në kurriz.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi fikson kalin në pozicionin në këmbë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën (bluzë e kapuç).– të përzgjedhë saktë mjetet që duhen për fiksimin e kalit në këmbë: javasha, litar etj.– të vendosë mjetet në tavolinë për lehtësimin e veprimeve pranë kafshës.– të afrohet te kafsha me shumë kujdes, sipas rregullave.– të bëjë fiksimin e kokës me javasha, sipas udhëzimeve.– të bëjë fiksimin e këmbës së parë si në rastin e mbathjes.– të bëjë fiksimin e këmbës së parë me litar.– të bëjë fiksimin e këmbës së pasme si në mbathje.– të bëjë fiksimin e dy këmbëve të pasme me litar.– të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për fiksimin e kalit në pozicionin në këmbë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi fikson gjedhin në pozicionin në këmbë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën.– të përzgjedhë mjetet e duhura për fiksimin e gjedhit në pozicionin në këmbë: javasha, unazat e hundës, litar etj.– të vendosë mjetet pranë vendit ku do fiksohet kafsha.– të bëjë fiksimin e gjedhit nga brirët me duar	

- të bëjë fiksimin e gjedhit nga hundët me duar, javasha, unazë metalike.
- të bëjë fiksimin e kokës duke lidhur brirët me litar të fortë pas një peme, shtylle a trangu.
- të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për fiksimin e gjedhit në pozicionin në këmbë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi fikson delen.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën: bluzë e kapuç.
- të përcaktojë mjetet e duhura për fiksimin e deles, litar etj.
- të afrojë me kujdes mejetet pranë vendit të fiksimit të deles.
- të fiksojë delen duke e rrëzuar në shpinë dhe lidhur gjymtyrët 2 nga 2 me litarë.
- të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për fiksimin e deles.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi fikson derrin në këmbë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën bluzë e kapuç.
- të përcaktojë mjetet e fiksimit (litar).
- të afrojë litarin pranë vendit të fiksimit.
- të kalojë lakun në nofullën e sipërme.
- të tërheqë litarin duke shtrënguar lakun.
- të lidhë skajin e lirë të litarit në ndonjë shtyllë a pemë
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë fiksimit të derrit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM5 Nxënësi fikson kafshët e shoqërimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë kompletin e veshjes
- të kontrollojë kafshën për sëmundjen e tërbimit
- të përcaktojë mënyrën e fiksimit të qenit dhe të maces.
- të realizojë fiksimin e qenit sipas metodës së përcaktuar.
- të realizojë fiksimin e maces sipas metodës së përcaktuar.

- të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik gjatë fiksimit të derrit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e fermës blegtorale në shkollë e jashtë saj, por rekomandohet të organizohen edhe vizita mësimorë në klinika veterinare.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të fiksimit të kafshëve. Ato përfshijnë: fiksimin e kalit, gjedhit, deles dhe të kafshëve të shoqërimit në këmbë dhe në kurriz.
- Mësuesi/instruktori duhet të nxisë diskutimet e nxënësve për përcaktimin e teknikës më të përshtashme për fiksimin e kafshëve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer fiksimin e kalit, gjedhit, deles dhe të kafshëve të shoqërimit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kryerjen e fiksimit të kafshëve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë me kafshë të llojeve të ndryshme.
 - Orëndi, pajisje dhe vegla të punës për fiksimit.
 - Dezinfektantë.
 - Barna të ndryshme.
 - Peshqire, sapun, kova uji.
 - Mjete për fiksimin e kafshës (litarë, javasha, etj.).
-

7. Moduli “Përdorimi i veglave të thjeshta kirurgjikale”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I VEGLAVE TË THJESHTA KIRURGJIKALE	M-19-234-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të përdorur veglat e thjeshta për ndërhyrje kirurgjikale të thjeshta si: për prerjen e indeve, ndalimin e hemoragjisë dhe qepjen e indeve të dëmtuar te kafshët.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përdor mjete të thjeshta për prerjen e indeve.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të veshë patjetër uniformën e duhur.– të përcaktojë teknikën e duhur sipas vendit ku do të ndërhyhet te kafsha.– të përzgjedhë saktë mjetet e duhur dhe veglat e tjera ndihmëse sipas llojit të ndërhyrjes: gërshërë, tampona, bende, pinca hemostatike etj.– të vendosë veglat dhe mjetet mbi tryezën e punës.– të kontrollojë gjendjen e kafshës para ndërhyrjes kirurgjikale (temperaturën, pulsën, frymemarrjen).– të kryejë fiksimin e kafshës me metodën më të favorshme– të përgatise fushën e operacionit duke kryer qethjen, rruarjen dhe dezinfektimin.– të pastrojë dhe dezinfektojë duart për ndërhyrje: larjen, dezenfektimin dhe veshjen e dorëzave kirurgjikale;– të aplikojë anestezinë lokale për ç’dhembjen e indeve ku do të ndërhyhet.– të kryejë prerjen e indeve të buta sipas teknikës së duhur.– të respektojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të bisturive dhe mjeteve ndihmëse për ndërhyrje të thjeshta kirurgjikale. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Nxënësi përdor mjetet për ndalimin e hemoragjisë te kafshët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë patjetër uniformën e duhur.
- të përcaktojë saktë enën e dëmtuar.
- të përzgjedhë saktë veglat dhe mjetet ndihmëse për ndalimin e hemoragjisë te kafsha.
- të kryejë fiksimin e kafshës sipas metodës më të përshtatshme që lejon ndërhyrjen.
- të vlerësojë sasinë e hemoragjisë së shkaktuar sipas enës së dëmtuar te kafsha.
- të përdorë tamponimin për gjakrrjedhje të ndryshme.
- të përdorë pincat e duhura hemostatike sipas enës gjakorë të dëmtuar.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të veglave për ndalimin e hemoragjisë te kafsha.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi përdor veglat për qepjen e indeve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë patjetër uniformën e duhur.
- të përcaktojë saktë indin e dëmtuar.
- të përcaktojë teknikën e qepjes sipas shkallës së dëmtimit.
- të përzgjedhë saktë veglat dhe mjetet ndihmëse për qepjen e indeve te kafsha: gjilpërat, perin e qepjes, gërshërët, dezenfektantët etj.
- të vendosë në vendin e duhur veglat dhe mjetet ndihmëse për qepjen e indeve.
- të kryejë fiksimin e kafshës sipas metodës më të përshtatshme që lejon ndërhyrjen.
- të pastrojë dhe dezinfektojë duart para dhe pas qepjes së indeve te kafshët.
- të kryejë qepjen me menyrën e zgjedhur sipas indit të dëmtuar.
- të dezinfektojë plagën pas qepjes.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të veglave për qepjen e indeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale në shkollë, në ferma blegtorale.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimit të veglave të thjeshta kirurgjikale për prerjen e indeve, ndalimin e

hemoragjisë dhe për qepjen e indeve.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të përdorur veglat e thjeshta kirurgjikale fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për përdorimin e veglave të thjeshta kirurgjikale.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përdorimin e veglave të thjeshta kirurgjikale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriteve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kafshë të ndryshme
 - Dezinfektantë
 - Bisturi
 - Gjilpëra
 - Pe për qepje
 - Gërshërë
 - Tampona
 - Bende
 - Pinca hemostatike etj.
 - Stativ për prerjete thundrave.
 - Pinca për prerjen dhe shkurtimin e thundrave
-

8. Moduli “Kryerja e injeksioneve te kafshët”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KRYERJA E INJEKSIONEVE TE KAFSHËT	M-19-235-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të zbatuar metoda të ndryshme të injeksioneve në kafshët bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit kafshën për kryerjen e injeksioneve. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të kontrollojë gjëndjen fizike të kafshës para injeksionit për plagë, enjtje, etj.– të kryejë fiksimin e kafshës me metoda të ndryshme për injeksion.– të përgatisë nëpërmjet qethjes dhe rruajtjes fushën dhe vendin për kryerjen e injeksionit.– të pastrojë dhe dezinfektojë me t-jodi vendin e injektimit.– të pastrojë e dezinfektojë duart pas përfundimit të punës.– të mbajë pastër vendin e punës dhe mjedisin nga mbeturinat që përftohen gjate procesit të përgatitjes së kafshës për injeksion. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi përgatit mjetet dhe veglat e punës për kryerjen e injeksioneve te kafshët bujqësore. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë orënditë dhe veglat e punës për injeksion.– të përgatisë tavolinën e punës dhe mjetet e tjera ndihmëse si ujë, sapun, kova, etj.– të kontrollojë gjëndjen e veglave të punës para injeksionit.– të pastrojë me kujdes orënditë dhe veglat e punës.– të dezinfektojë siç duhet orëndotë dhe veglat e punës të përgatisë injektorin me solucionin që futet në organizëm për injeksion te kafsha.– të mirëmbajë me kujdes orënditë dhe veglat e punës.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryhen injeksionin me metodën subkutane te kafsha.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë e të veshë patjetër uniformën.
- të fiksojë kafshën me metodën me të përshtatshme.
- të përcaktojë vendin e injektimit s/c, te kafsha.
- të kontrollojë shiringën dhe agen për llojin e injeksionit që do të kryejë.
- të mbushë shiringën me solucionin përkatës, sipas rregullit.
- të kontrollojë dozën e barit (solucionit) para përdorimit.
- të largojë ajrin nga shiringa duke e mbajtur atë në pozicionin vertikal me age lart.
- të kontrollojë me dorë vendin e kryerjes së injeksionit për të mos prekur enët e gjakut.
- të realizojë injektimin e barit sipas metodës subkutane, te kafsha.
- të heqë me kujdes shiringën sëbashku me gjilpërën.
- të masazhojë siç duhet vendin e injektimit.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për veprimet e kryera.
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së injeksioneve subkutane te kafshët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryhen injeksionin me metodën intramuskulare te kafsha.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë e të veshë patjetër uniformën.
- të fiksojë kafshën me metodën me të përshtatshme.
- të përcaktojë vendin për injektimin intramuskular, te kafsha.
- të kontrollojë shiringën dhe agen për llojin e injeksionit që do të kryejë.
- të mbushë shiringën me solucionin përkatës, sipas rregullit.
- të kontrollojë dozën e barit (solucionit) para përdorimit.
- të largojë ajrin nga shiringa duke e mbajtur atë në pozicionin vertikal me age lart.
- të kontrollojë me dorë vendin e kryerjes së injeksionit për të mos prekur enët e gjakut.
- të realizojë injektimin e barit sipas metodës intramuskulare te kafsha.
- të heqë me kujdes shiringën sëbashku me gjilpërën.
- të masazhojë siç duhet vendin e injektimit.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për veprimet e kryera.
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së injeksioneve intramuskulare te

kafshët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi kryhen injksionin me metodën intravenoze te kafsha.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë e të veshë patjetër uniformën.
- të për zgjedhë saktë agen më të përshtatshme për injektim.
- të fiksojë kafshën me metodën me të përshtatshme.
- të përcaktojë vendin për injektimin intramuskular, te kafsha
- të përgatitë fushën për injektin: qethje, rruarje, dezinfektim.
- të realizojë gjetjen e venës sipas udhëzimeve të dhëna.
- të kryejë injektimin intravenoz sipas rregullave të përcaktuara
- të kontrollojë vendin e kryerjes së injksionit nëse kemi apo gjakrrjedhje.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për veprimet e kryera.
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së injksioneve intravenoze te kafshë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e fermës blegtorale në shkollë e jashtë saj, por rekomandohet të organizohen edhe vizita mësimorë klinika veterinare.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të ndryshme të injektimit të kafshëve. Ato përfshijnë: përgatitjen e kafshës dhe të orëndive e mjeteve për kryerjen e injksioneve, si dhe zbatimin e metodave subkutane, intramuskulare dhe intravenoze të injektimit.
- Mësuesi/instruktori duhet të nxisë diskutimet e nxënësve për përcaktimin e metodës më të përshtatshme për injektim.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer injksione subkutane, intramuskulare dhe intravenoze te kafshët, si dhe për pastrimin, dezinfektimin dhe mirëmbajtjen e orëndive dhe veglave të punës, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kryerjen e injksioneve të kafshëve me metodën subkutane, intramuskulare dhe intravenoze.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

**për realizimin e
modulit**

- Fermë me kafshë të llojeve të ndryshme.
 - Orëndi, pajisje dhe vegla të punës për injektim.
 - Shiringa dhe age të madhësive të ndryshme.
 - Dezinfektantë.
 - Barna të ndryshme.
 - Peshqire, sapun, kova uji.
 - Mjete për fiksimin e kafshës (litarë, javasha etj.).
-

9. Moduli: “Diagnostikimi i sëmundjeve me metoda të ndryshme”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DIAGNOSTIKIMI I SËMUNDJEVE ME METODA TË NDRYSHME	M-19-236-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer diagnostimin e sëmundjeve të kafshëve me anë të: shikimit, palpimit, perkutimit dhe të askultimit.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kontrollon kafshën me anë të shikimit. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën.– të përzgjedhë sipas rregullit kafshën për ta diagnostifikuar me anë të shikimit.– të përzgjedhë saktë mjetet dhe veglat ndihmëse sipas llojit të kafshës.– të vendosë kafshën në kushte optimale kontrolli, mundësisht në dritë optimale.– të fiksojë kafshën sipas rregullave përkatëse.– të vlerësojë qëndrimin e kafshës, ndryshimet në të, ndryshimet e trajtës dhe madhësisë së barkut, urinimit, jashtëqitjen, etj.– të kontrollojë ngjyrën, sekrecionet, enjtjet, temperaturën etj., të mukozave.– të kontrollojë temperaturën, ngjyrën, elasticitetin, lagështinë, praninë e enjtjeve të lëkurës.– të mbajë saktë shënimet për vrojtimit e bëra.– të zbatojë rregullat e zbatimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të kafshës me anë të shikimit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgimi me listë kontrolli dhe pyetje-përgjigje.	
	<p>RM 2 Nxënësi kontrollon kafshën me anë të palpimit. <i>Kriteret e realizimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën.	

- të përzgjedhë sipas rregullit kafshën për ta diagnostifikuar me anë të palpimit.
- të përzgjedhë saktë mjetet dhe veglat ndihmëse sipas llojit të kafshës.
- të fiksojë kafshën sipas rregullave përkatëse.
- të kontrollojë konsistencën, temperaturën, ndjeshmërinë e zonës së sëmurë.
- të mbajë saktë shënimet për vrojtimet e bëra.
- të zbatojë rregullat e zbatimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të kafshës me anë të palpimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kontrollon kafshën me anë të perkutimit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën.
- të përzgjedhë sipas rregullit kafshën për ta diagnostifikuar me anë të perkutimit
- të përzgjedhë saktë mjetet dhe veglat ndihmëse sipas llojit të kafshës.
- të fiksojë kafshën sipas rregullave përkatëse.
- të përgatisë siç duhet veglat për perkutim çekiç dhe plesimetër.
- të kryejë saktë perkutimin.
- të mbajë shënime duke vlerësuar tingujt: i shurdhër, i qartë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të kafshës me anë të perkutimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kontrollon kafshën me anë të askultimit (dëgjimit).

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën.
- të përzgjedhë sipas rregullit kafshën për ta diagnostifikuar me anë të askultimit.
- të përcaktojë saktë metodën e askultimit: me vesh apo fonendoskop.
- të përzgjedhë saktë mjetet dhe veglat ndihmëse sipas llojit metodës së askultimit.
- të fiksojë kafshën sipas rregullave përkatëse.
- të përgatisë siç duhet veglat për askultim: fonendoskop.
- të vendosë si duhet fonendoskopin për të askultuar saktë organet e kafshës.
- të dëgjojë me qetësi tinjujt dhe zhurmat e organeve të kafshës.
- të vlerësojë saktë tingujt që dëgjojnë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit

gjatë kontrollit të kafshës me anë të askultimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e fermës blegtorale në shkollë e jashtë saj, por rekomandohet të organizohen edhe vizita mësimorë në klinika veterinare.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të ndryshme të diagnostikimit të kafshëve. Ato përfshijnë diagnostikimin me anë të shikimit, palpimit, perkutimit dhe askultimit.
- Mësuesi/instruktori duhet të nxisë diskutimet e nxënësve për përcaktimin e metodës më të përshtashme për diagnostikim.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer diagnostikimin me anë të shikimit, palpimit, perkutimit dhe askultimit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kryer diagnostikimin e kafshëve me anë të shikimit, palpimit, perkutimit dhe askultimit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë me kafshë të llojeve të ndryshme (kuaj, lopë, dele)
 - Pajisje dhe vegla të punës për diagnostikim të kafshës me anë të shikimit.
 - Pajisje dhe vegla të punës për diagnostikim të kafshës me anë të palpimit.
 - Pajisje dhe vegla të punës për diagnostikim të kafshës me anë të perkutimit.
 - Pajisje dhe vegla të punës për diagnostikim të kafshës me anë të askultimit.
 - Peshqirë, sapun e kova uji.
 - Mjete për fiksimin e kafshës (litarë, javasha etj.).
-

10. Moduli: “Mjekimi i plagëve të ndryshme të kafshët”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MJEKIMI I PLAGËVE TË NDRYSHME TE KAFSHËT	M-19-237-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer mjekimin e plagëve të thjeshta, të infektuara, si dhe plagëve të thundrave të kafshët.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi mjekon plagë të thjeshta të rastit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën.– të përzgjedhë veglat kirurgjikale e mjetet ndihmëse: pinca gërshërë, pambuk, garza, dezinfektantë, ujë, sapun etj.– të fiksojë kafshën sipas rregullave përkatëse.– të kryejë kontrollin e përgjithshëm të kafshës: temperaturën, pulsën dhe frymëmarrjen.– të vlerësojë plagën: hapësirën e plagës, largësinë mes buzëve e faqeve– fundin e plagës etj.– të sterilizojë veglat sipas rregullave.– të vendos veglat e mjetet në tryezën e punës.– të zbatojë siç duhet rregullat e asepsisë.– të kryejë tualetin e plagës duke larguar indet e copëtuara e të ndotura, larja e plagës etj.– të pastrojë e dezinfektojë siç duhet duart.– të veshë patjetër dorëzat.– të dezinfektojë plagën me dezinfektantin e duhur.– të pudrosë plagën me antibiotikë.– të fashojë plagën nëse është e nevojshme.– të pastrojë duart e veglat pas ndërhyrjes.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mjekimit të një plage të rastit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Nxënësi mjekon plagë të infektuara te kafsha.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën.
- të përzgjedhë veglat kirurgjikale e mjetet ndihmëse: pinca gërshërë, pambuk, garza, dezinfektantë, ujë, sapun etj.
- të fiksojë kafshën sipas rregullave përkatëse.
- të kryejë kontrollin e përgjithshëm të kafshës: temperaturën, pulsën dhe frymëmarrjen.
- të vlerësojë plagën: kur absesi është i vogël apo e kundërta.
- të sterilizojë veglat sipas rregullave.
- të vendosë veglat e mjetet në tryezën e punës sipas rradhës së duhur.
- të zbatojë siç duhet rregullat e asepsisë.
- të hapë me kujdes plagën e qelbëzuar
- të dezinfektojë plagën pas heqjes së qelbit me tretësira antiseptikësh.
- të fusë në plagë tretësira antiseptikësh.
- të pastrojë e dezinfektojë siç duhet duart.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mjekimit të të plagëve të infektuara.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kontrollon dhe mjekon thundrat e kafshëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë uniformën për kontrollin dhe mjekimin e thundrave të kafshëve.
- të zbatojë rregullat për higjienën e thundrave të kafshës.
- të pastrojë, të lajë dhe të thajë me pece thundrën
- të kontrollojë me sy të lirë thundrën për sëmundje
- të kontrollojë te gjedhi qëndrimin e gishtave
- të kontrollojë parametrat klinik te gjedhi (temperatura, pulsi, frymëmarrja)
- të vendosë kafshën në lëvizje, për përcaktimin e procesit patologjik gjatë çalimeve
- të përcaktojë me palpim, dhembjen e gishtave dhe të kurorës së thundrave
- të kontrollojë thundrën për trupa të huaj
- të pastrojë thundrën nga papastërtitë/ trupa të huaj
- të kontrollojë pulvinet për simetrinë dhe ulçera në to
- të kontrollojë tabanin e thundrave, nëse është i sheshtë/i lugët
- të trajtojë thundrën e sëmurë
- të vendosë kafshën në fiksuesen e thundrave
- të lajë me ujë të vakët e sapun thundrën

- të presë me thikë dhe darën e thundrave indet e nekrotizuara
- të dezinfektojë zgavrën e formuar me tretësirë 1% të permenganatit të kaliumit
- të lyejë me t-jodi dhe linimente plagën e thundrës
- të kryejë bandazhimin e thundrës
- të kryejë mjekimin me antibiotikë/sulfamide, sipas procesit pezmatues në thundër
- të kontrollojë thundrat e njëthundrakëve për zënie gozhde
- të zbathë dhe pastrojë me kujdes thundrën me zënie gozhde
- të dezinfektojë zgavrën e formuar me t-jodi dhe pudrosje me antiseptik
- të kryejë bandazhimin e thundrës
- të injektojë serumit antitetanik në kafshët me zënie gozhde
- të pastrojë vendin e punës dhe mjedisin nga mbeturinat gjatë mjekimit dhe trajtimit të thundrave të kafshës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për mjekimin dhe trajtimin e thundrave të kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e fermës blegtorale në shkollë e jashtë saj, por rekomandohet të organizohen edhe vizita mësimore në klinika veterinare.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të ndryshme të mjekimit të plagëve të thjeshta, të infektuara dhe plagëve të thundrave të kafshët. Ato përfshijnë mjekimin e plagëve të pa infektuara si dhe të plagëve të infektuara.
- Mësuesi/instruktori duhet të nxisë diskutimet e nxënësve për përcaktimin e mënyrës më të përshtashme për mjekim.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer mjekimin e plagëve të rastit, të infektuara apo jo, si dhe plagëve të thundrave, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kryer mjekimin e plagëve të rastit të kafshët.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kafshë të llojeve të ndryshme: kuaj, lope, dele, qen, mace etj.
-

modulit

- Orëndi, paisje e vegla të punës për mjekimin e plagëve të rastit.
 - Mjete për fiksimin e kafshës.
 - Peshqirë, sapun e kova uji.
 - Dezinfektant, T-jodi, pluhura antiseptikësh, antibiotik, sulfamide, garza, pambuk, etj
 - Kompleti kirurgjikal për mjekimin e thundrave.
-

11. Moduli: “Marrja e mostrave dhe përgatitja e strisheve”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MARRJA E MOSTRAVE DHE PËRGATITJA E STRISHEVE	M-19-1801-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer marrjen e mostrave nga materiale të ndryshme biologjike për analiza laboratorike dhe për të përgatitur strishe mikroskopike për diagnostikimin e sëmundjeve në kafshë dhe shpendë në fermat blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	<p>Nxënësi të kryejë marrjen e mostrave nga materiale të ndryshme biologjike për analiza laboratorike. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të përgatisë siç duhet veshjet për punë. – të përzgjedhë mjetet për marrjen e mostrave për analizë. – të kryejë marrjen e mostrave nga materialet patologjike në kafshët e gjallë, sipas rregullave. – të përdorë tamponin për marrjen e mostrave në kafshë – të kryejë marrjen e gjakut për analiza laboratorike. – të zbatojë teknikën e marrjes së gjakut në kafshë të ndryshme dhe shpendë . – të kryejë marrjen e urinës nga fshikëza e urinës me kateter \ gjatë aktit të urinimit në shishe sterile – të kryejë marrjen e fekaleve gjatë defekimit \ direkt nga zorra e drejtë në kuti \ plasmas sterile. – të marrë mostrat e qumështit në kafshë – të mbledhë kruste të lëkurës për vlerësim laboratorik – të kryejë marrjen e mostrave nga materialet patologjike në kafshët me therje të sforcuar \ të ngordhura, sipas rregullave. – të kryejë marrjen e mostrave nga organet e brendshme me procese patologjike, sipas rregullave. – të kryejë marrjen e mostrave me eksudat nga zgavrat e trupit, përmbajtje stomaku \ copë zorre me përmbajtje, të lidhur në dy skajet, sipas rregullave. – të kryejë marrjen, paketimin dhe dërgimin e materialeve patologjike në laborator, sipas rregullave

- të zbatojë kushtet e ruajtjes dhe të transportit të mostrave të marra për analizë në laborator.
- të zbatojë procedurat standarte të marrjes së mostrave për sëmundje infektive.
- të zbatojë rregullat e higjienës në laborator
- të kryejë pastrimin e mjeteve të punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes të mjedisit gjatë marrjes së mostrave për analizë në laborator.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi përgatit strishe nga organe të ndryshme të kafshëve dhe shpendëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë siç duhet veshjet për punë.
- të zgjedhë dhe të përgatisë organin që do të analizohet.
- të djegë organin nga do të përgatitet strishja sipas rregullave.
- të djegë sipërfaqen organit me spatul të nxehtë.
- të kryejë prerjen e organit me gërshërë të sterilizuar.
- të marrë materialin me buzën e lamës në vendin e prerë.
- të vendosë materialin në një lamë tjetër sipas rregullit.
- të kryejë hapjen e materialit mbi lamë sipas rregullit.
- të kryejë lëvizjen në drejtime të kundërta të lamave.
- të fiksojë strishon në lamë në flakën e llampës.
- të vendosë strishon në mikroskop për t'u analizuar.
- të zbatojë rregullat e higjienës në laborator për heqjen e organeve.
- të kryejë pastrimin e mjeteve të punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes të mjedisit gjatë përgatitjes së strisheve nga organe të ndryshme në kafshë dhe shpendë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi përgatit strisho nga bujoni (tokë kulturale e lëngët).

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë siç duhet veshjet për punë.
- të zgjedhë bujonin e duhur që do të analizohet.
- të nxehë anzën bakteriologjike në flakën e llampës para dhe pas marrjes së materialit.
- të hapë epruvetën pranë flakës së llampës me alkool.
- të kryejë marrjen e materialit nga epruveta me anzë bakteriologjike.
- të mbyllë epruvetën në flakën e llampës sipas rregullit.
- të vendosë materialin mbi lamë sipas rregullit.
- të kryejë hapjen e materialit mbi lamë sipas rregullit.

- të fiksojë strishon me metoda fizike dhe kimike.
- të zbatojë rregullat e higjienës në laborator për heqjen e organeve.
- të kryejë me kujdes pastrimin e mjeteve të punës.
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së strisheve nga bujoni.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi përgatit strisho nga agari (tokë kulturale e ngurtë).

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë veshjet për punë.
- të zgjedhë agarin që do të analizohet.
- të nxehë anzën bakteriologjike në flakën e llampës para dhe pas marrjes së materialit.
- të hapë kapakun e pjatës petri.
- të kryejë marrjen e materialit me anzë bakteriologjike në sipërfaqe të tokës kulturale të ngurtë.
- të shtrijë materialin mbi lamë.
- të kryejë hedhjen e pikës së ujit mbi material.
- të kryejë përzierjen e materialit dhe shtrirjen me anzë bakteriologjike.
- të thajë strishon në ambjentin e jashtëm.
- të fiksojë strishon me metoda fizike dhe kimike.
- të vendosë strishon në mikroskop për t’u analizuar.
- të zbatojë rregullat e higjienës në laborator për heqjen e organeve.
- të kryejë pastrimin e mjeteve të punës.
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së strisheve nga agari.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në laboratorin e shkollës, ose në ndonjë klinikë veterinare afër rajonit të shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita mësimore në klinika veterinare për të parë konkretisht se si përgatiten strishet.
- Nxënësit duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e përgatitjes së strisheve. Kjo duhet të përfshijë përgatitjen e strisheve nga kafshë të ndryshme dhe shpendëve, nga bujoni dhe nga agari.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet praktike për përgatitjen e strisheve me metoda të ndryshme. Ai duhet të nxisë fantazinë e nxënësve për ide racionale për përgatitjen e strisheve.
- Realizimi i pranuehëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqëshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë për rritjen e kafshëve.
 - Kafshë të gjalla, kufoma kafshësh
 - Laborator veterinar.
 - Mikroskop, lama, lamela, anzë bakteriologjike, epruveta, pjata petri, llampë alkoli, gërshërë, spatul, bisturi, etj.
 - Gjak, qumësht, urinë, fekale, enë qelqi, shishe sterile, thikë druri, qeska plastmasi, arka \ kuti amballazhi, mjete dezinfektimi
 - Bujon, agar, organe të ndryshme të kafshëve dhe shpendëve.
 - Veshje pune, bluza të bardha, dorëza gome, maskë, kapuç, etj.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Materiale studimorë.
 - Vidio me demonstrime të ndryshme.
-

12. Moduli “Kujdesi për kafshët gjatë dhe pas pjelljes”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUJDESI PËR KAFSHËT GJATË DHE PAS PJELLJES	M-19-239-20
------------------	--	-------------

Qëllimi i modulit Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të ndihmuar kafshën gjatë pjelljes dhe për tu kujdesur për kafshën gjatë dhe pas pjelljes.

Kohëzgjatja e modulit 36 orë mësimorë

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.

Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi përgatit vendin dhe kafshën për pjellje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë siç duhet dhe të veshë patjetër uniformën: bluzë, kapuç, dorëza.
- të sigurojë mjetet e nevojshme të punës si: kovë, ujë, sapun, litarë, dezinfektant, pambuk, peshqirë etj.
- të kontrollojë sipas rregullave temperaturën, frymëmarrjen dhe mukozat e kafshës para pjelljes.
- të përcaktojë ambjentin e pjelljes sipas kriterëve të duhura: vend i qetë, pa lëvizje, i pastër, i ajrosur, i ngrohtë.
- të përgatisë sipas parametrave të duhura vendin e pjelljes: pastrimi, dezenfektimi, vendosje e shtresës së bollëshme.
- të përgatisë siç duhet kafshën për pjellje: larje e pjesëve të pasme të trupit me ujë të ngrohtë e sapun, lyerje e organeve gjinorë të jashtme me dezinfektantë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes të mjedisit gjatë përgatitjes së vendit dhe të kafshës për pjellje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi ndihmon kafshën gjatë pjelljes dhe të porsalindurin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndjekë me vëmendje fazat e procesit të pjelljes: fazën përgatitorë dhe të nxjerrjes së frytit.
- të qëndrojë pranë specialistit për ta ndihmuar atë në

tërheqjen e frytit: gjymtyrët e para ose të pasme tërhiqen në momentin e shtërzimit.

- të ndihmojë specialistin veterinar në lidhjen e kërthizës 8-10 cm larg nga lëkura e barkut te i porsalinduri.
- të ndihmojë specialistin veterinar në këputjen/prerjen 2-3 cm larg vëndit të lidhjes te i porsalinduri.
- të ndihmojë specialistin veterinar në dezinfektimin e kërthizës te i porsalinduri.
- të kontrollojë nxjerrjen e placentës te kafsha pas pjelljes.
- të pastrojë mjedisin duke e pudrosur me pluhur gëlqereje dhe duke shtruar shtresë të thatë.
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pjelljes së kafshës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 3 Nxënësi kujdeset për kafshën pas pjelljes

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë pastrimin dhe dezinfektimin e vendqëndrimit të kafshës pas pjelljes.
- të japë ujë të ngrohtë menjëherë pas lëpirjes së të porsalindurit: ujë të ngrohtë 37-38 °c + kripë gjelle.
- të përcaktojë mënyrën e të ushqyerit sipas gjendjes shëndetësorë
- të vendosë në lëvizje 1-2 orë në ditë kafshën.
- të zbatojë rregullat e mjeljes së lopëve 4-5 herë në ditë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për kafshën gjatë pjelljes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje - përgjigje.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën blegtorale të shkollës, ose në ndonjë fermë blegtorale në rajon.
- Mësuesi instruktori mund të organizojë edhe vizita mësimorë komplekse blegtorale.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demostrimet konkrete të punës për përgatitjen e vendit dhe të kafshës për pjellje, ndihmën që i jepet kafshës gjatë pjelljes si dhe për kujdesin e kafshëve gjatë e pas pjelljes.
- Nxënësit duhet te angazhohen në punë konkrete për përgatitjen e vendit dhe të kafshës për pjellje, ndihmën që i jepet kafshës gjatë pjelljes si dhe për kujdesin e kafshëve gjatë e pas pjelljes, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceduarit e punës për kujdesin e kafshëve gjatë e pas pjelljes.

-
- Realizimi i pranuehëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqëshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë blegtorale
 - Kafshë në prag të pjelljes
 - Kafshë të sapo pjella
 - Shtresa të ndryshme të thata
 - Komplete veshjesh
 - Kova, ujë, sapun, litar
 - Dezinfektantë, pambuk, peshqirë
 - Dokumentacion për mbajtjen e shënimeve
-

13. Moduli: “Diagnostikimi i helmintozave në kafshët e gjalla dhe të therura”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DIAGNOSTIKIMI I HELMINTOZAVE NË KAFSHËT E GJALLA DHE TË THERURA	M-19-1233-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të diagnostikuar helmintozat në kafshët e gjalla dhe të therura.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.11 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen analiza për gjetjen e parazitëve në fekale nëpërmjet shpërlarjeve të njëpasnjëshme. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatitë e veshë uniformën e duhur për kryerjen e analizës së gjetjes së parazitëve në fekaleve me metodën e shpërlarjeve të njëpasnjëshme;– të sigurojë e përzgjedhë mjetet, pajisjet e materialet e nevojshme për kryerjen e analizës për gjetjen e parazitëve në fekale me metodën e shpërlarjes së njëpasnjëshme.– të përgatitë e e mjeteve, pajisjeve e materialeve për kryerjen e analizës për gjetjen e parazitëve në fekale e vendosja e tyre në vendin e duhur.– të veçojë me kujdes fekalet që do të analizohen;– të vendosë 5-10 gram fekale në enën prej qelqi;– të shtojë ujin në sasinë 5-10 herë më shumë se sasia e fekaleve. .– të përziejë mirë përmbajtjes e krijuar me gypi qelqi dhe ta vendosë enën në qetësi për 5-10 minuta.– të derdhë pjesën e sipërme të ujit në enë, pas një kohe qetësie 5-10 minutash– të shpërlajë në mënyrë të njëpasnjëshme, deri sa uji të dalë i pastër.– vendosë fundrrinat në një sfon të zi, pas derdhjes së ujit të fundit të pastër.– të veçojë me kujdes parazitët, me sy ose lupë.– të vendosë me kujdes parazitët mbi lamë për vrojtim në mikroskop.– të diagnostikojë parazitët, në bazë të karakteristikave	

përkatëse.

- të mbajë saktë shënimet e duhura.
- të pastrojë e dezinfektojë siç duhet enët e mjedisin ku kryhet analiza për gjetjen e parazitëve me metodën shpërlarjeve të njëpasnjëshme.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë me klientin.
- të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së ambjentit gjatë kryerjes së analizës për gjetjen e parazitëve në fekale nëpërmjet shpërlarjeve të njëpasnjëshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i saktësisë së shënimeve.

RM 2 Nxënësi kryen analiza për gjetjen e vezëve të parazitëve në fekale me metodën e Fylborn-it.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë e veshë uniformën e duhur për kryerjen e analizës për gjetjen e vezëve të parazitëve në fekale, me metodën e Fylborn-it.
- të sigurojë e përzgjedhë mjetet, pajisjet e materialet e duhura për kryerjen e analizës për gjetjen e vezëve të parazitëve në fekale.
- Përgatitja e vendosja për punë e mjeteve, pajisjeve e materialeve për kryerjen e analizës për gjetjen e vezëve të parazitëve në fekale.
- të veçojë me kujdes fekalet që do të analizohen.
- të vendosë 5-10 gram fekale në enën prej qelqi.
- të shtojë 50-100 ml tretësirë të kripës së gjellës mbi masën e fekale në enën e qelqit.
- të përziejë me kujdes përmbajtjen në enë me anën e gypit të qelqit
- të kullojë përzierjen, në një enë tjetër, duke e situr.
- të vendosë në qetësi lëngun e kulluar për 40-45 minuta.
- të marrë me kujdes disa pika nga sipërfaqja e lëngut, me anën e një anze.
- të vendosë me kujdes pikat e lëngut në lamë.
- të mbulojë me kujdes lamën me lamelë.
- të vrojttojë në mikroskop për gjetjen e vezëve të parazitëve
- të mbajë saktë shënimet përkatëse.
- të pastrojë e dezinfektojë siç duhet enët dhe mjedisin ku kryhet analiza për gjetjen e vezëve të parazitëve.
- të përgatitë siç duhet faturën e shërbimit.
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së analizave për gjetjen e vezëve të

parazitëve sipas metodës së Fylbornit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen analiza për gjetjen e larvave të parazitëve ne fekale me metodën e Berman-it.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë e veshë uniformën e duhur për kryerjen e analizës për gjetjen e larvave të parazitëve në fekale, me metodën e Berman-it.
- të sigurojë e përzgjedhë mjetet, pajisjet e materialet e duhura për kryerjen e analizës për gjetjen e larvave të parazitëve në fekale.
- të përgatitë për punë e mjeteve, pajisjeve e materialeve për kryerjen e analizës për gjetjen e larvave të parazitëve në fekale e t'i vendosë ato në vendin e duhur.
- të veçojë me kujdes sasinë e fekaleve për analizë.
- të vendosë siç duhet hinkën mbi stativ.
- të vendosë me kujdes sitën mbi nivelin e gjysmës së hinkës.
- të bashkojë siç duhet fundin e hinkës me grykën e një provze, nëpërmjet një gypi gome.
- të mbushë hinkën me ujë të ngrrohtë, deri në nivelin e mbi sitës.
- të vendosë 15-20 gram fekale të freskëta, mbi të (duhet të mbulohen nga uji)
- të vendosë në qetësi e hinkës në statik, për 1 orë.
- të heqë me kujdes provzën, si dhe të derdhë lëngun..
- të derdhë lëngun e hinkës me kujdes.
- të heqe provzën dhe te derdhë lëngun gjithashtu dhe lëngun e hinkës
- të vendosë me kujdes fundërresat mbi lamë.
- të mbulojë lamën me lamelë.
- të vrojtojë preparatin e përgatitur për gjetjen e larvave të gjalla të parazitëve.
- të diagnostikojë parazitët sipas karakteristikave të larvave të gjetura.
- të mbajë saktë shënimet e duhura.
- të pastrojë e dezinfektojë enët dhe mjedisin ku kryhet analiza për gjetjen e larvave të parazitëve.
- të përgatitë siç duhet faturës e shërbimin të kryer.
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së analizave për gjetjen e larvave të parazitëve sipas metodës së Bermanit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen autopsinë helmintologjike për gjetjen e parazitëve në organet e kafshëve të therura.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë e veshë uniformën e duhur për kryerjen e autopsisë helmintologjike për gjetjen e parazitëve në organet e kafshëve të therura/të ngordhura
- të sigurojë kafshë të therura/ngordhura për kryerjen e autopsisë helmintologjike
- të përzgjedhë mjetet, pajisjet, materialet për kryerjen e autopsisë helmintologjike, për gjetjen e parazitëve në organet e kafshëve të therura/të ngordhura
- të kryejë autopsinë helmintologjike të kufomës
- të kontrollojë organet e kufomës për helmintë
- të vërejë ndryshimet anatomopatologjike në organet me helmintoza
- të kontrollojë organet që dyshohet për helmintë (të aparatit tretës, mëlçinë dhe mushkëritë)
- të shpërlajë me ujë organin/organet me helmintoza
- të veçojë dhe grumbullojë helmintët nga organi/organet, me një majë gjilpëre/furçë të butë
- të numërojë helmintët e grumbulluar, për përcaktimin e shkallës së invazionit
- të vrojtojë me sy të lirë/lupë helmintët.
- të kontrollojë mëlçinë për gëlbasë
- të copëtojë në disa pjesë mëlçinë, të hapë kanalet dhe fshikëzën e tëmthit
- të futë në një enë me ujë përmbajtjen e përgatitur
- të shpërlajë disa herë përmbajtjen duke e shtrydhur atë
- të veçojë gëlbasat e dala
- të vrojtojë në mikroskop gëlbasat për cilësitë morfologjike
- të diagnostikojë helmintozat për aparatit tretës dhe të frymëmarrjes, në bazë të karakteristikave përkatëse
- të mbajë saktë shënimet përkatëse.
- të pastrojë e dezinfektojë siç duhet mjetet dhe mjedisin ku kryhet autopsia helmintologjike
- të përgatitë siç duhet faturën e shërbimit.
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së autopsisë helmintologjike për gjetjen e parazitëve në organet e kafshëve të therura/të ngordhura.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e parazitologjisë në shkollë ose në laborator veterinar.

dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për analizat koprologjike (metoda e shpëlarjes së njëpasnjëshme, metoda Fylborn dhe Berman) dhe autopsinë helmimnologjike.
- Instruktori apo mësuesi i praktikës mund të organizojë vizita mësimore në laborator veterinar ku nxënësi të njihet konkretisht me proceset e punës për kryerjen e analizave koprologjike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e analizave koprologjike për gjetjen e parazitëve, vezëve dhe larvave në fekale, si dhe diagnostikimin e helmintozave në kafshët e therura, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me diagnostikimin e helmintozave në kafshët e gjalla dhe të therura.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për diagnostikimin e helmintozave në kafshët e gjalla dhe të therura.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kabineti parazitologjisë ose laborator veterinar.
 - Kafshë të gjalla
 - Kafshë të therura ose të ngordhura
 - Mikroskop, lamë, lamelë.
 - Peshore analitike.
 - Fekale të freskëta nga kafshë të ndryshme.
 - Enë qelqi, epruveta, hinkë, sita, anzë, gyp gome.
 - Stativë, tretësirë e ngopur kripë gjelle.
 - Ujë, sapun, peshqirë.
 - Instrumente për autopsinë.
 - Organe të infestuara.
-

14. Moduli: “Ndërhyrjet kirurgjike profilaktike”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	NDERHYRJET KIRURGJIKALE PROFILAKTIKE	M-19-1802-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të bërë identifikimin, regjistrimin e kafshëve sipas dokumentacioneve përkatës, matrikullimin, kastrimin, prerjen dhe kauterizimin e brirëve në gjedh , prerjen e sqepit në shpendë, dhëmbëve kanine në gica, mjekimin e thundrave në gjedh, për marrjen e gjakut (salaso) në kafshë për qëllime diagnostikimi.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.11 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përdor mjete të thjeshta dhe elektroteknike, për prerjen e thundrave të kafshëve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– Të zbatojë grafikun për mirëmbajtjen e thundrave.– të zbatojë rregullat për higjienën dhe prerjen e thundrave të kafshës.– të kontrollojë gjëndjen e veglave të punës për pastrimin e thundrave.– të përcaktojë saktë radhën e punës gjatë procesit të pastrimit të thundrave.– të kryejë fiksimin e kafshës me metodën më të favorshme (fiksimi me litar ose stativ).– të për zgjedhë mjetet dhe veglat prerëse për thundrat.– të zbatojë saktë radhën e punës për prerjen e thundrave.– të realizojë siç duhet pastrimin e thundrave të kafshës.– të kryejë prerjen e thundrave të kafshës sipas teknikës më të përshtatshme për prerjen e tyre.– të vendosë me kujdes pajisjet, veglat e punës dhe instrumentet prerës në vendin e duhur pas prerjes së thundrave.– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.– të zbatojë me rigozitet rregullat e sigurimit teknik gjatë pastrimit dhe prerjes së thundrave.– të mbajë pastër vendin e punës dhe mjedisin nga mbeturinat që përftohen gjatë procesit të pastrimit dhe	

prerjes së thundrave të kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Nxënësi përdor mjete të thjeshta për prerjen e dhëmbëve kanine në gica.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë patjetër uniformën e duhur.
- të përcaktojë teknikën e duhur për prerjen dhëmbëve kanine në gica.
- të përzgjedhë saktë mjetet e duhur dhe veglat e tjera ndihmëse për e prerjen dhëmbëve kanine në gica : darë gërshërë, tampona, bende, pinca hemostatike etj.
- të vendosë veglat dhe mjetet mbi tryezën e punës.
- të kontrollojë moshën dhe gjëndjen shëndetësore të gicit para ndërhyrjes kirurgjikale (temperaturën, pulsën, frymemarrjen).
- të kryejë fiksimin e kafshës (gicit) me metodën më të favorshme
- të përgatise fushën e operacionit (dezinfektimin e dhembëve kanin) para ndërhyrjes.
- të pastrojë dhe dezinfektojë duart për ndërhyrje: larjen, dezenfektimin dhe veshjen e dorëzave kirurgjikale;
- të aplikojë anestezinë lokale për ç’dhembjen e indeve ku do të ndërhyhet.
- të kryejë prerjen e dhëmbëve sipas teknikës së duhur.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të respektojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të paisjeve dhe mjeteve ndihmëse për prerjen e dhëmbëve kanine.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi pret brirët në kafshë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë rregullat për higjienën dhe prerjen e brirëve në kafshë.
- të kontrollojë gjëndjen e veglave të punës për prerjen e brirëve.
- të përcaktojë saktë radhën e punës gjatë procesit të prerjes së brirëve.
- të përzgjedhë mjetet dhe veglat prerëse për brirët në gjedh dhe kafshë të tjera.
- të zbatojë saktë radhën e punës për prerjen e brirëve.
- të realizojë siç duhet prerjen e brirëve në kafshë.
- të kryejë prerjen e brirëve të kafshës sipas teknikës më të përshtatshme për prerjen e tyre.

- të vendosë me kujdes pajisjet, veglat e punës dhe instrumentet prerës në vendin e duhur pas prerjes së brirëve.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë me rigozitet rregullat e sigurimit teknik gjatë prerjes së brirëve.
- të mbajë pastër vendin e punës dhe mjedisin nga mbeturinat që përftohen gjatë procesit të prerjes së brirëve në kafshë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Nxënësi pret sqepin në shpendë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë rregullat për higjienën dhe prerjen sqepit në shpendë.
- të kontrollojë gjëndjen e veglave të punës për prerjen sqepit në shpendë.
- të përcaktojë saktë radhën e punës gjatë procesit të prerjes së sqepit në shpendë.
- të përzgjedhë mjetet dhe veglat për prerjen sqepit në shpendë.
- të zbatojë saktë radhën e punës për prerjen sqepit në shpendë .
- të realizojë siç duhet prerjen sqepit në shpendë.
- të kryejë prerjen e sqepit në shpendë sipas teknikës më të përshtatshme për prerjen e tyre.
- të vendosë me kujdes pajisjet, veglat e punës dhe instrumentet prerës në vendin e duhur pas prerjes së sqepit në shpendë.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë me rigozitet rregullat e sigurimit teknik gjatë prerjes së sqepit në shpendë
- të mbajë pastër vendin e punës dhe mjedisin nga mbeturinat që përftohen gjatë procesit të prerjes së sqepit në shpendë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi kryen kastrimin në kafshë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë rregullat për higjienën dhe kastrimin në kafshë.
- të kontrollojë gjëndjen e veglave të punës për kastrim.
- të përcaktojë saktë radhën e punës gjatë procesit të kastrimit.

- të përzgjedhë mjetet dhe veglat prerëse për kastrimin e hapure.
- të përzgjedhë mjetet dhe veglat për kastrimin e mbyllur.
- të zbatojë saktë radhën e punës për kastrimin e hapur.
- të zbatojë saktë radhën e punës për kastrimin e mbyllur.
- të kryejë fiksimin e kafshës me metodën më të favorshme
- të kryejë prerjen shtresë pas shtrese te skrotumit sipas teknikës më të përshtatshme për prerjen e tyre.
- të vendosë me kujdes pajisjet, veglat e punës dhe instrumentet prerës dhe jo prerëse në vendin e duhur pas kryerjes së kastrimit.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë me rigozitet rregullat e sigurimit teknik gjatë kastrimit.
- të mbajë pastër vendin e punës dhe mjedisin nga mbeturinat që përftohen gjate procesit të kastrimit në kafshë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional në shkollë, në ferma blegtorale.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimit të veglave për prerjen e thundrave, dhëmbëve kanin, sqepit në shpendë dhe për kastrimin në kafshë të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të përdorur veglat e thjeshta kirurgjikale fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për përdorimin e veglave dhe paisjeve të thjeshta kirurgjikale që përdoren për prerjen e thundrave, brirve, sqepit, dhëmbëve kanin dhe për kastrimin e kafshëve të ndryshme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përdorimin e veglave dhe të paisjeve të thjeshta kirurgjikale që përdoren për prerjen e thundrave, brirve, sqepit, dhëmbëve kanin dhe për kastrimin e kafshëve të ndryshme
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Kafshë të ndryshme
 - Dezinfektantë
 - Bisturi
-

-
- Darë
 - Gjilpëra
 - Pe për qepje
 - Gërshërë për prerjen e sqepit
 - Tampona
 - Bende
 - Pinca hemostatike etj.
 - Stativ për prerjene thundrave.
 - Pinca për prerjen dhe shkurtimin e thundrave
 - Çekiç druri për thundrat prej plastike të veçantë.
 - Thikë thundrash me teh të lakuar.
 - Limë thundrash për rrafshimin e murit të sipërm të tyre.
-

15. Moduli: “Përgatitja e formave të ndryshme farmaceutike”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	PËRGATITJA E FORMAVE TË NDRYSHME FARMACEUTIKE	M-19-618-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të përgatitur forma të thjeshta farmaceutike të ngurta, të lëngta dhe të buta.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.11 të drejtimit mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen punë përgatitore për përgatitjen e formave të ndryshme farmaceutike. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të sigurojë kushtet optimale të ambientit për përgatitjen e formave të ndryshme farmaceutike– të përzgjedhë mjetet e punës– të etiketojë substancat përbërëse të formave të ndryshme farmaceutike– të vendosë mjetet e punës në tryeze sipas radhës së përgatitjes.– të vendosë dhe të sistemojë substancat farmaceutike në raftet sipas trajtës (formës) farmaceutike dhe grupeve farmakologjike.– të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës përgatitore për përgatitjen e formave të ndryshme farmaceutike. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi përgatit forma të ngurta farmaceutike (pluhura dhe specie). Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatitë e veshë uniformën e duhur për përgatitjen e formave të ngurta (pluhur dhe specie).– të përpilojë saktë receta me substanca të formave të ngurta.– të peshojë saktë substancat bazë dhe përbërëse sipas recetës.	

- të coptojë në grimca dhe të sitë pjesë të bimëve
- të hedhë me kujdes substancat në havan.
- të përziejë substancat në mënyrë të njëtrajtshme deri sa të merret një masë e vetme.
- të ndajë pluhurat në pjesë të barabarta sipas numrit të shënuar në recetë.
- të paketojë pluhurat sipas standardit të kërkuar.
- të pastrojë e dezinfektojë enët e mjedisin pas përgatitjes së pluhrave farmaceutike, sipas kërkesave higjienike të duhura.
- të përgatitë siç duhet faturën e shërbimit të kryer.
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës për përgatitjen e formave të ngurta farmaceutike (pluhura).

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi përgatit forma të buta farmaceutike (pomada).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë dhe veshë uniformën e duhur për përgatitjen e formave të buta farmaceutike.
- të përpilojë saktë recetën, sipas rregullit të duhur.
- të peshojë substancat bazë dhe përbërësit e tjerë, sipas recetës (vazeline, lanoline etj).
- të hedhë me kujdes në fillim substancat e ngurta në havan.
- të përziejë me kujdes substancat e ngurta.
- të shtojë përbërësit e pomadës, sipas recetës: vazelinë, lanolinë, vajra bimorë (vaje kajsie, vaj ulliri etj).
- të përziejë me kujdes të gjithë përbërësit deri sa të merret një masë homogjene.
- të ambalazhojë me kujdes pomadën e prodhuar, në enë qelqi ose plastike.
- të etiketojë produktin sipas standardit të kërkuar.
- të pastrojë e dezinfektojë enët dhe mjedisin pas përgatitjes së formave të buta, sipas standardit higjienik të kërkuar.
- të përgatitë siç duhet faturën shërbimit të kryer.
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së ambjentit gjatë përgatitjes së formave të buta farmaceutike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi përgatit forma të lëngta farmaceutike (infuzet dhe dekoktet).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë dhe veshë uniformën e duhur për përgatitjen e

- formave të lëngta farmaceutike (infuzi).
- të përpilojë saktë recetën sipas standardit.
- të peshojë saktë substancat bazë sipas recetës (lule, gjethe, barishte, rrënje etj).
- të coptojë materialin e thatë bimor dhe t’i sitë në sita me nr.5 ose 6.
- të vendosë me kujdes materialin bimorë në gotat e infuzit
- të shtojë me kujdes ujë të distiluar më tepër se sa sasia që shënohet në recetë.
- të valohet për 15 min dhe të lihet të ftohet për 40 minuta.
- të filtrohet me napë, deri në fund që të nxirret sasia e ujit që gjendet në materialin bimor.
- të përgatitë materialet e duhura për përgatitjen e formave të lëngta farmaceutike (dekoktet).
- të peshojë saktë substancat bazë sipas recetës (fara, rrenjë, frutet, lëkura rrallë nga lulet dhe gjethet).
- të coptojë materialet bimorë.
- të shtojë ujë në tenxhere dhe të valohen për 30 min.
- të kullojë materialin dhe t’i përdore pasi të ftohen.
- të ambalazhojë produktin në shishe qelqi.
- të etiketojë produktin e ambalazhuar sipas standardit të kërkuar.
- të pastrojë e dezinfektojë enët dhe mjedisin pas përgatitjes së formave të lëngta farmaceutike, sipas kushteve higjienike.
- të përgatitësiç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë përgatitjes së formave të lëngta farmaceutike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e farmakologjisë ose në farmaci veterinare.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për përgatitjen e formave të ngurta, të buta e të lëngta farmaceutike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e formave të ngurta, lëngta e të buta farmaceutike fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me përgatitjen e pluhurave, specieve, pomadave dhe infuzit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përgatitjen e formave të ndryshme farmaceutike si : pluhura, podamada, tretësira.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kabinet farmakologjie ose farmaci veterinare
- Pershore farmacie
- Spatula, havan të ndryshme
- Enë cilinrike të shkallëzuara, llampë me alkool ose gaz, letër, etiketa, ambalazh qelqi ose plastike.
- Substanca antibiotike, sulfamide, vazelinë, alkool, ujë i distiluar
- Ujë i zakonshëm, garza, sapun, dezenfektant, pambuk etj.

16. Moduli “Vaksinimi i kafshëve dhe shpendëve për sëmundjet infektive”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	VAKSINIMI I KAFSHËVE DHE SHPENDËVE PËR SËMUNDJET INFEKTIVE	M-19-619-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer vaksinimin e dhenve e gjedhit për plasje, për vaksinimin e kafshëve të shoqërimin, të derrave për murtajë dhe të shpendëve për variolë.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.11 të drejtimit mësimor “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi vaksinon dhentë për plasje. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe të veshë uniformën e duhur për vaksinimin e kafshëve.– të përcaktojë saktë radhën e kryerjes së veprimeve.– të sigurojë ambjentin e përshtatshëm ku do kryhet vaksinimi.– të për zgjedhë dhentë që do të vaksinohen.– të për zgjedhë mjetet e materialet e nevojshme për vaksinim (vaksina, shiringa, dezinfektant).– të kryejë kontrollin e dhenve para vaksinimit.– të kontrollojë skadenca e vaksinës, para injektimit në kafshë.– të fiksohet siç duhet kafsha sipas rregullave.– të kryejë tundjen e vaksinës para përdorimit.– të bëhet, sipas rregullave, marrja e dozës së vaksinës me shiringë.– të injektohet, sipas rregullave s/c në lëkurën e bishtit vaksina.– të mbahen saktë shënimet përkatëse për çdo vaksinim.– të përgatitë siç duhet faturën e shërbimit të kryer.– të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.– të zbatohen rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit gjatë vaksinimit të dhenve për plasje. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Pyetje-përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Nxënësi vaksinon gjedhet për plasje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë dhe të veshë uniformën.
- të përcaktojë rradhën e veprimeve.
- të sigurojë ambjentin ku do kryhet vaksinimi.
- të përzgjedhë mjetet (vaksina, shiringa, dezinfektant, pambuk) dhe gjedhët që do vaksinohet.
- të kryejë kontrollin klinik para vaksinimit.
- të kryejë kontrollin e skadencës së vaksinës dhe ta tundë para përdorimit.
- të kryejë fiksimin e kafshës për vaksinim sipas rregullave.
- të bëhet sipas rregullave marrja e dozës së vaksinës me shiringë.
- të injektohet sipas rregullave s/c në lëkurën e qafës vaksina.
- të mbahen shënimet përkatëse për çdo vaksinim.
- të përgatitë siç duhet faturën e shërbimit të kryer.
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.
- të zbatohen rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit gjatë vaksinimit të gjedhëve për plasje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi vaksinon kafshët e shoqërimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë e veshë uniformën e duhur për vaksinimin e kafshëve të shoqërimit.
- të përcaktojë saktë radhën e kryerjes së veprimeve.
- të përcaktojë ambjentin e përshtatshëm për vaksinimin e kafshëve të shoqërimit.
- të përzgjedhë saktë mjetet dhe matetrialet e nevojshme për vaksinim: vaksina, shiringa, dezinfektant, pambuk etj., si dhe kafshët që do të vaksinohen, qen ose mace.
- të informohet mbi moshën e kafshës.
- të përcaktojë vaksinën sipas kalendarit të vaksinës.
- të kryejë kontrollin klinik para vaksinimit.
- të kryejë kontrollin e skadencës së vaksinës para kryerjes së injektimit.
- të kryejë fiksimin e kafshës për vaksinim sipas rregullave.
- të marrë me shiringë dozën e vaksinës sipas rregullave.
- të injektohet vaksina sipas rregullave.
- të mbahen saktë shënimet përkatëse për çdo vaksinim.
- të përgatitë siç duhet faturën shërbimit të kryer.
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.
- të zbatohen rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së

mjedisit gjatë vaksinimit të kafshëve të shoqërimin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 4 Nxënësi vaksinon derrat për murtajë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë e veshë uniformën e duhur për vaksinimin e derrave për murtajë.
- të përcaktojë radhën e kryerjes së veprimeve për vaksinimin e derrave.
- të përcaktojë ambientin e përshtatshëm ku do vaksinohen derrat.
- të përzgjedhë saktë mjetet dhe materialet: vakcina, shiringa, dezinfektant, pambuk, si dhe derrat që do vaksinohen.
- të kryejë kontrollin klinik para vaksinimit.
- të peshojë derrat para vaksinimit.
- të përcaktojë dozën e vaksinës, sipas peshës së derrave.
- të kryejë kontrollin e skadencës së vaksinës.
- të bëhet marrja e dozës së vaksinës me shiringë sipas rregullave.
- të injektohet vakcina në kafshë, sipas rregullave.
- të mbahen saktë shënimet përkatëse për çdo vaksinim.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit dhe të higjienës gjatë vaksinimit të derrave për murtajë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 5 Nxënësi vaksinon shpendët për variolë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë e veshë uniformën e duhur për vaksinimin shpendëve për variolë.
- të përcaktojë saktë radhën e kryerjes së veprimeve.
- të përcaktojë ambientin e përshtatshëm për kryerjen e vaksinimit të shpendëve.
- të përzgjedhë mjetet e materialet: vakcina, shiringa, dezinfektant, pambuk, si dhe të shpendëve që do vaksinohen.
- të kryejë kontrollin klinik para vaksinimit.
- të kryejë kontrollin e skadencës së vaksinës.
- të bëhet siç duhet fiksimi i shpendëve për vaksinim.

- të bëhet marrja e dozës së vaksinës sipas rregullave.
- të injektohet vaksina sipas rregullave.
- të mbahen shënimet përkatëse për çdo vaksinim.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes, të higjienës e të ruajtjes së mjedisit gjatë vaksinimit të shpendëve për variolë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në ferma blegtorale që rrisin dhen, gjedh, shpend, derra etj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të vaksinimit të kafshëve e shpendëve për sëmundje infektive.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me sëmundjet infektivë të kafshëve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e vaksinave të ndryshme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës gjatë vaksinimit të kafshëve e shpendëve për sëmundje infektive.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë blegtorale.
 - Dhen, gjedh, derra, shpend, qen, mace.
 - Vaksinat përkatëse për plasjen, murtajën e derrave, variolën e shpendëve etj.
 - Shiringa, dezinfektant, pambuk, sapun, ujë etj.
-

17. Moduli “Mjekimi i mastiteve në kafshë ”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	MJEKIMI I MASTITEVE NË KAFSHË	M-19-620-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik ka për qëllim të aftësojë nxënësit për të përvetësuar aftësitë profesionale të kërkuara në parandalimin dhe mjekimin e mastiteve klinike e subklinike në kafshë, në kushtet e mbareshtimit të kafshëve në fermat blegtorale	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.11 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kontrollon lopët me mastite klinike. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për punë.– të vendosë siç duhet lopën në fiksuese.– të kryejë saktë marrjen e të dhënave (anamnezën) për lopën nga mjelësja.– të kontrollojë saktë parametrat e gjendjes së përgjithshme të lopës: temperaturën, pulsën, frymëmarrjen.– të kryejë siç duhet kontrollin lokal të gjendrës së gjirit.– të kryejë matjen e temperaturës së kafshës.– të kryejë siç duhet kontrollin e cipave mukoze dhe të vërejë ndryshimet në to.– të kryejë siç duhet kontrollin e çerekut të gjirit të pezmatuar të lopës.– të përcaktojë ndryshimet në çerekun e gjirit të pezmatuar.– të kryejë mjeljen e çerekut të gjirit të pezmatuar në enë të veçantë.– të përcaktojë ndryshimet sasiore dhe cilësore të qumështit të mjelë (analiza organoleptike): si ngryrën, konsistencën, si dhe përzierjet (gjak, qelb etj.).– të vërejë ndryshimet që ndodhin në qumështin e çerekut të gjirit të pezmatuar me anë të zierjes.– të kryejë ose të dërgojë për analizë në laborator mostrën e qumështit për mastite.– të kryejë larjen, pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve të punës.– të zbatojë siç duhet rregullat e higjienës personale gjatë	

kontrollit të lopëve për mastike klinike.

- të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, të higjienës personale dhe të ruajtjes së ambjentit, gjatë kontrollit të lopëve me mastike klinike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kontrollon lopët me mastike subklinike (të fshehta).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për punë.
- të vendosë me kujdes lopën në fiksuese.
- të kryejë saktë marrjen e të dhënave për lopën (anamnezën) nga mjelësja..
- të kontrollojë siç duhet gjendjen e përgjithshme të lopës: temperaturën, pulsën, frymëmarrjen.
- të kryejë me kujdes kontrollin lokal të gjendrës së gjirit.
- të dallojë mungesën e shenjave të dukshme klinike në çerekun e gjirit të pezmatuar.
- të vërejë uljen e sasisë së qumështit në çerekun e prekur.
- të zbulojë me kujdes mastitet e fshehta në lopë.
- të përgatitë siç duhet shishet sterile për analizën e qumështit.
- të kryejë siç duhet marrjen e mostrave të qumështit nga çdo çerek i gjirit.
- të bëjë etiketimin e çdo shisheje sterile me numrin e matrikullit të lopës për çdo çerek të gjirit.
- të kryejë analizat kimike të qumështit për çdo çerek të gjirit .
- të kryejë hedhjen me pikatore në pjatën e analizave (për 4 çerekët) të disa pikave qumështi.
- të hedhë me pikatore mbi qumësht disa pika të tretësirës kimike naoh 4%
- të kryejë me kujdes përzierjen e përmbajtjes me shufër qelqi.
- të kontrollojë rezultatin e analizës së qumështit.
- të vërejë përzierjen, për të dalluar format e mastiteve të fshehta: pozitiv, i dyshimtë, negativ.
- të zbatojë siç duhet rregullat e higjienës personale gjatë kontrollit të lopëve me mastite të fshehta.
- të kryejë larjen, pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve të punës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer.

- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës e të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të lopëve me mastike subklinike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi mjekon lopët me mastite.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë dhe veshë uniformën e duhur për punë.
- të kryejë me kujdes larjen dhe pastrimin i gjirit.
- të përgatisë e vendosë kompresa të ftohta në gjirin e pezmatuar.
- të kryejë mjelje të shpeshta të gjirit të kafshës me mastite.
- të kryejë boshatisje të çerekut /çerekëve të sëmurë.
- të kryejë mjekimin lokal të gjirit.
- të dërgojë për analizë në laborator qumësht nga çereku i prekur i gjirit.
- të dërgojë për analizë në laborator qumësht, për antibiogramën në mjekimin e mastiteve.
- të përzgjedhë antibiotikun, sipas antibiogramës në mjekimin e mastiteve.
- të përdorë tretësira ujore/vajore të antibiotikëve për mjekimin e mastiteve.
- të kryejë në fillim, futjen e barit në vrimën e thithave të çerekëve të shëndoshë.
- të kryejë në fund, futjen e barit në vrimën e thithave të çerekut/ çerekëve të sëmurë.
- të mos kryejë mjeljen e gjirit të mjekuar për disa orë.
- të kryejë mjekimin e përgjithshëm të kafshës me mastite klinike (antibiotikë, sulfamide,etj).
- të zbatojë rregullat e higjienës personale gjatë mjekimit të lopëve me mastite.
- të kryej larjen, pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve e mjedisit pas punës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së ambientit gjatë mjekimit të lopëve me mastite.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi zbaton masat profilaktike për parandalimin e mastiteve në kafshë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatitë dhe veshë uniformën e duhur për punë.

- Të zbatojë siç duhet masat higjienike në stallë.
- Të kryejë nxjerrjen e kafshëve në kullotë.
- Të përgatisë tretësirën kimike për dezinfektimin e stallave, sipas satndardit.
- Të kryejë me kujdes dezinfektimin e shtresës në vendqëndrimet e kafshës.
- Të kryejë me kujdes dezinfektimin e dyshemesë në stallë.
- Të kryejë shpëlarjen e dyshemesë me ujë të bollshëm pas dezinfektimit kimik.
- Të mjelë lopën duke zbatuar teknikën e mjeljes me grusht.
- Të zbatojë masat higjienike në mjete si: kova, peshqirë, etj., për larjen dhe masazhimin e gjirit.
- Të kryejë larjen dhe masazhin e gjirit në lopë .
- Të kryejë prerjen e thonjve si dhe larjen e duarve para dhe pas mjeljes.
- Të zbatojë orarin e mjeljes në kafshë.
- Të kryejë dezinfektimin e thithave para dhe pas mjeljes me tretësira me bazë klori.
- Të kryejë boshatisjen e plotë e gjirit.
- Të respektojë radhën e mjeljes në lopë: mëshqerrat, lopët e reja, të vjetrat, në fund ato me mastite.
- Të kryejë gjurmimin për mastite të fshehta në lopë, dy herë në vit.
- Të kryejë larjen, pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve e të mjedisit të punës.
- Të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjienës personale dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë kryerjes së punëve për parandalimin e mastiteve ne lopë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në ferma të tjera blegtorale pranë saj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për parandalimin dhe mjekimin e lopëve me mastite.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kontrollin e lopëve me mastike klinike dhe subklinike, si dhe mjekimi i tyre, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me parandalimin dhe mjekimin e lopëve me mastite.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të parandalimit dhe mjekimit të mastiteve..
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për

çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë për rritjen e kafshëve.
 - Laborator veterinar
 - Lopë me mastite, qumësht, fiksuese (stativ) për lopët
 - Veshje pune, bluza të bardha, doreza, maskë, kapuç, etj.
 - Tretësira dezinfektuese, termometër, stetoskop, shiringa, age, barna (antibiotikë, sulfamide, etj).
 - Pjata petri, shishe sterile, pikatore, etj.
 - Ujë, sapun, peshqira, pece, kova, etj.
 - Mjete të tjera vizuale, materiale studimore, video me demonstrime të ndryshme.
-

18 . Moduli “Mjekimi i sëmundjeve të aparatit tretës”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	MJEKIMI I SËMUNDJEVE TË APARATIT TRETËS	M-19-621-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer kontrollin, parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve të aparatit tretës në kafshë, në kushtet e mbarështimit të kafshëve në fermat blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.12 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kontrollon e mjekon kafshët ripërtypëse me timpani akute. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë e veshë uniformën e duhur për kontrollin e mjekimin e kafshëve ripërtypëse me timpani akute.– të marrë saktë të dhënat (anamnezën), për lopën nga mjelësja.– të kryejë siç duhet kontrolli klinik të kafshës.– të kontrollojë nëpërmjet palpimit, gropën e urisë në anën e majtë.– të vërejë me kujdes konsistencën elastike (nga gazrat) gjatë fryrjes në gropën e urisë– të kryejë siç duhet kontrollin e gjendjes së përgjithshme të kafshës.– të kryejë me kujdes futjen e dorës në gojë.– të bëjë tërheqjen e gjuhës me kujdes për daljen e gazrave.– të vendosë siç duhet kafshën në vend të pjerrët.– të kryejë aktivizimin e lëvizjeve peristaltike të rumenit në rajonin e kryqeve.– të kryejë masazhe në gropën e urisë me anë të grushtit të dorës.– të kryejë hedhjen e ujit të ftohtë në gropën e urisë për aktivizimin e rumenit dhe daljen e gazeve . I. të kryejë largimin e gazeve me sondë ezofagale. <ul style="list-style-type: none">– të kryejë sipas rregullit futjen e sondës në kapërçell.– të shtyjë me kujdes, sondën, në thellësi në rumen për daljen e gazrave.	

- të kryejë lëvizjen e lehtë të sondës për nxjerrjen e gazeve.
- të vendosë gishtin në grykën e sondës për mos daljen e menjëhershme të gazrave.
- të kryejë futjen e tretësirës së iktiolit me sondë në rumen.

II. të kryejë largimin e gazeve me anë të funksionit të rumenit.

- të kryejë funksionin e rumenit duke përdorur troakarin (kanula).
- të kryejë qethjen e dezinfektimin e fushës së operacionit.
- të bëjë me kujdes tërheqjen e lëkurës pak prapa.
- të vendosë e troakarin në pikën më të lartë të fryrjes.
- të kryejë sipas rregullit shpimin në gropën e urisë.
- të kryejë heqjen me kujdes të stiletit nga kanula për daljen graduale të gazrave.
- të lerë kanulën për disa orë në vendin e shpimit për nxjerrjen e plotë të gazrave.
- të kryejë me kujdes heqjen e kanulës.
- të kryejë mjekimin e plagës me tinkturë jodi.

III. të përdorë medikamente për largimin e gazeve.

- të përgatisë tretësira me barna të ndryshme sipas rregullit.
- të kryejë dhënien e tretësirave të përgatitura, nga goja.
- të kryejë larjen, pastrimin e dezinfektimin e mjeteve e të vendit të punës pas kontrollit e mjekimit të kafshëve ripërtëritëse mem timpani akute.
- të mbajë shënimet përkatëse të kontrollit e mjekimit të kafshëve ripërtëritëse mem timpani akute në fletoret e punës.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit makroskopik të mishit të gjedhit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 2 Nxënësi kontrollon e mjekon lopët me atoni të parastomaqeve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë e veshë uniformën e duhur për kontrollin e mjekimin e lopëve me atoni të parastomaqeve.
- të vendosë siç duhet lopën në fiksues.
- të marrë saktë të dhënat (anamnezën), për lopën nga mjelësja.
- të kryejë siç duhet kontrollin e gjendjes së përgjithshme të lopës.

- të kryejë siç duhet kontrollin klinik të kafshës.
- të kryejë siç duhet kontrollin lokal të rumenit.
- të kryejë kontrollin e lëvizjeve peristaltike të rumenit me fenendoskop/stetoskop.
- të kryejë kontrollin e fekaleve në sasi, ngjyrë, e konsistencë.
- të kontrollojë me kujdes procesin e ripërthypjes së kafshës..
- të kryejë kontrollin e vlerësimit të ushqimeve që kafsha ka ngrënë.
- të largojë me kujdes ushqimet nga grazhdi.
- të vendosë kafshën në dietë urie sipas rekomandimit.
- të kryejë dhënien e ujit pa kufizim e me pak kripë.
- të kryejë dhënien ushqimeve cilësore – njomishte në sasinë e rekomanduar.
- të kryejë mjekimin medikamentoz me ruminator.
- të përgatisë sipas rregullit tretësirat purgative.
- të kryejë dhënien e tretësirave nga goja për të rregulluar funksionin motorrik në parastomaqe.
- të kryejë futjen e barnave në organizëm me injeksione i/m, i/v ose s/c.
- të kryejë larjen, pastrimin e dezinfektimin e mjeteve e vendit të punës pas kontrollit të mjekimit të lopëve me atoni të parastomaqeve.
- të mbajë saktë të gjitha shënimet përkatëse e kontrollit të mjekimit të lopëve me atoni të parastomaqeve në fletoret e punës.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjesisit gjatë kontrollit të mjekimit të kafshëve me atoni të parastomaqeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 3 Nxënësi kontrollon e mjekon kafshët e reja me gastroenterit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për kontrollin e mjekimit të kafshëve të reja me gastroenterit.
- të marrë saktë të dhënat (anamneza) e kafshëve nga rritësja.
- të kontrollojë siç duhet gjendjen e përgjithshme të kafshës.
- të vërejë me kujdes ndryshimet e treguesve të gjendjes së përgjithshme të kafshës si: temperaturë e larte, pulsi i shpejtuar, frymëmarrja sipërfaqësore.
- të kryejë siç duhet kontrollin klinik të kafshës.
- të vërejë me kujdes ndryshimet në traktin digjestiv

- (stomak-zorrë).
- të kryejë kontrollin e jashtëqitjeve të lëngshme, me erë të keqe, përmbajtje gjaku, etj.,
 - të kryejë izolimin e kafshëve të sëmura sipas rregullit të këkuar.
 - të vendosë siç duhet kafshët në dietë urie.
 - të përdorë barna për thithjen e helmeve, për mjekimin e kafshëve
 - të kryejë dhënien e kriprave sulfate nga goja për zbrazjen e aparatit tretës.
 - të kryejë dhënien e antibiotikëve dhe sulfamideve për zhdukjen e veprimtarisë së mikrobeve.
 - të kryejë dhënien e ujit të pijshëm pa kufizim.
 - të zbatojë siç duhet masat parandaluese.
 - të kryejë kontrollin e ushqimeve sipas rregullit.
 - të largojë ushqimet e papërshtatshme nga grazhdi (të mykura, të kalbura, etj).
 - të kryejë larjen, pastrimin e dezinfektimin e mjeteve e vendit të punës pas kontrollit e mjekimit të kafshëve me gastroenterit.
 - të mbajë shënimet përkatëse të kontrollit e mjekimit të kafshëve të reja me gastroenterit në fletoret e punës
 - të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit e mjekimit të kafshëve të reja me gastroenterit.
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli.
 - Pyetje- përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës, në ferma të tjera blegtorale si dhe në familje që mbarështojnë kafshë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të mënyrave të kontrollit e mjekimit të kafshëve të ndryshme me patologji në aparatit tretës.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur materiale mbështetëse dhe manuale që kanë të bëjnë me kontrollin e mjekimit e patologjive në aparatit tretës në kafshë të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kontrollin e mjekimit e kafshëve me patologji në aparatit tretës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës gjatë kontrollit e mjekimit të patologjive në aparatit tretës në kafshë të ndryshme
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për

çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë për rritjen e kafshëve.
 - Klinikë veterinare.
 - Fiksuese (stativ) për lopët
 - Veshje pune, bluza të bardha, doreza, maskë, kapuç etj.
 - Tretësira dezinfektuese.
 - Sondë ezofagale, roakar.
 - Termometër, stetoskop, shiringa, age, barna (antibiotikë, sulfamide, purgativë, sol.glukosi, kofeinë etj.).
 - Ujë, sapun, peshqira, pece, kova, etj.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
-

19. Moduli “Kontrolli i cilësisë së produkteve ushqimore me prejardhje shtazore”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KONTROLLI I CILËSISË SË PRODUKTEVE USHQIMORE ME PREJARDHJE SHTAZORE	M-19-622-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer kontrollin makroskopik të mishit të gjedhit, kontrollin e mishit të shpendëve, ekspertizën e llojeve të ndryshme të sallameve, si dhe për të kryer vlerësimin organoleptik të qumështit, peshkut dhe vezëve.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.12 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen kontrollin makroskopik të mishit të gjedhëve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë dhe të veshë uniformën e duhur për kryerjen e kontrollit mikroskopik të mishit të gjedhit.- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për kontrollin e mishit të gjedhit.- të sigurojë e kushtet optimale për kontrollin e mishit.- të kryejë kontrollin e përgjithshëm të mishit të gjedhit, me anë të shikimit.- të kryejë kontrollin e veçantë të mishit e gjëndrave limfatike me anë të shikimit, palpimit e prerjes.- të bëjë sipas rregullave marrja e materialit për analiza laboratorike për patollogjitë e hasura.- të mbajë shënimet përkatëse për çdo patollogji të hasur.- të vlerësojë përfundimisht mishin e gjedhit sipas rregullores në bazë të rezultateve të kontrollit.- të plotësojë të dhënat e vlerësimit në dokumentacionin përkatës teknik.- të komunikojë me eetikë e profesionalizëm me klientin.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës e të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit makroskopik të mishit të gjedhit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Pyetje-përgjigje me gojë.	

RM 2 Nxënësi kontrollon cilësinë e mishit të shpendëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe të veshë uniformën e duhur për kontrollin e mishit të shpendëve.
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për kontrollin e mishit të shpendëve.
- të sigurojë ambientin me kushte optimale për kontrollin e mishit të shpendëve.
- të kontrollojë shpendët para therjes: gjendjen shëndetësore, qëndrimin, ndotjen e pendëve afër kloakës, ngjyrën e lafshës etj.
- të kontrollojë shpendët pas therjes.
- të kontrollojë mishin e shpendëve për sëmundjet infektive: kolerë, tbc, pseudopest, difteri, leukozë.
- të kontrollojë mishin e shpendëve për toksinfeksionet ushqimore (salmonelozë, botulizmi, etj).
- të marrë materiale për analiza laboratorike kur konstatohen procese patologjike.
- të mbajë shënime për çdo patollogji të hasur.
- të vlerësojë përfundimisht mishin e shpendëve sipas rregullores në bazë të rezultateve të kontrollit.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të mishit të shpendëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 3 Nxënësi kryen kontrollin e llojeve të ndryshme të sallameve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për kontrollin e sallameve të ndryshme.
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për kontrollin e sallameve të ndryshme.
- të përzgjedhë llojet e sallameve që do kontrollohen.
- të kryejë kontrollin e jashtëm i sallamit me anë të shikimit: tipi i sallamit, tipi i mbështjellëses, ndryshimet e ngjyrës, prania e myqeve e parazitëve, me anë të palpimit (gjendja e mbështjellëses, konsistenca) dhe me anë të nuhatjes: era normale nga erërat e tjera therëse, myku, tymi, hidhërimi.
- të kryejë kontrollin e sipërfaqes së brendshme së mbështjelljes: grumbullim uji, xhelatinë, dhjami.
- të kryejë kontrollin e përmbajtjes me anë të prerjes ose këputjes sipas rregullave.
- të kontrollojë shijen: për hidhërimin e dhjemit.

- të mbajë saktë shënimet përkatëse për çdo lloj sallami të kontrolluar.
- të vlerësojë sallamin për konsum në bazë të rezultateve të kontrollit.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të llojeve të ndryshme të sallameve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje- përgjigje me gojë.

RM 4 Nxënësi kryen vlerësimin organoleptik të qumështit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për kontrollin organoleptik të qumështit.
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për kontrollin organoleptik të qumështit.
- të sigurojë ambjentin me kushte të përshtatshme për kontrollin organoleptik të qumështit.
- të marrë mostrat e qumështit për kontroll, sipas rregullave.
- të kryejë kontrollin e cilësisë së qumështit duke filluar qe nga ambalazhi.
- të kontrollojë shijen dhe ngjyrën e qumështit, sipas standardit të kërkuar
- të kontrollojë konsistencën e qumështit, sipas standardit.
- të përcaktojë ndotjen mekanike të qumështit nëpërmjet kullimit të tij.
- të matë dendësinë e qumështit sipas rregullave me laktodensimetër.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të kontrollit organoleptik të qumështit.
- të bëjë vlerësimin e qumështit për konsum në bazë të rezultateve të kontrollit.
- të plotësojë siç duhet dokumentacionin teknik pç duhet dokumentacionin teknik përkatës.
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës e të mjedisit gjatë kontrollit organoleptik të qumështit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje- përgjigje me gojë.

RM 5 Nxënësi kryen kontrollin organoleptik të peshkut.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për kontrollin organoleptik të peshkut.

- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për kontrollin organoleptik të peshkut.
- të sigurojë ambjentin me kushte të përshtatshme për kontrollin organoleptik të peshkut.
- të përzgjedhë peshkun për kontroll.
- të kontrollojë pamjen e përgjithshme të peshkut, sipas kritereve të caktuara.
- të kontrollojë ngrirjen e peshkut sipas rregullit.
- të kontrollojë erën e peshkut me anë të nuhatjes, sipas rregullit.
- të kontrollojë konsistencën e peshkut me anë të nuhatjes sipas rregullit.
- të kontrollojë velëzat e peshkut (ngjyrën) dhe luspat nëse janë të ngjitura mirë pas trupit.
- të kontrollojë syrin nëse është i tejdukshëm.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të kontrollit organoleptik të peshkut..
- të bëjë vlerësimin e peshkut për konsum në bazë të rezultateve të kontrollit.
- të plotësojë saktë dokumentacionin teknik përkatës.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisi gjatë kontrollit organoleptik të peshkut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje- përgjigje me gojë.

RM 6 Nxënësi kryen kontrollin e vezëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për kontrollin e vezëve.
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për kontrollin e vezëve.
- të sigurojë ambjentin me kushte të përshtatshme për kontrollin e vezëve.
- të sigurojë sasinë e mjaftueshme të vezëve për kontroll.
- të kryejë kontrollin e jashtëm të vezëve: plasaritjet e lëvozhgës, gjendjen e pastërtisë, praninë e mykut etj.
- të kryejë kontrollin me anë të ovoskopit të: gjendjes së të verdhës, lartësinë dhe gjatësinë e dhomës së ajrit, praninë e mykut dhe gjakrrjedhjeve.
- të kryejë kontrollin e përmbajtjes me anë të thyerjes së vezës.
- të kryejë kontrollin e vezës me anë të zierjes.
- të kryejë kontrollin e vezëve për freski me anë të vendosjes në një enë me ujë.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të kontrollit të vezëve.
- të bëjë vlerësimin e vezëve për konsum në bazë të rezultateve të kontrollit.

- të plotësojë saktë dokumentacionin teknik përkatës.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatohen rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisi gjatë kontrollit të vezëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje- përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në thertore, dyqane mishi, dyqane peshku, ferma blegtorale.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të mënyrave të kontrollit të mishit, produkteve të tjera ushqimore me origjinë shtazore.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me ekspertizën e produkteve ushqimore me preardhje shtazore në mënyrë që nxënësi të ketë mundësi që të japë një gjykim të drejtë për vlerësimin e këtyre produkteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për ekspertizën e produkteve ushqimore me origjinë shtazore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës gjatë kontrollit të mishit, peshkut, sallamit, vezëve e qumështit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë blegtorale.
 - Dyqane mishi, thertore.
 - Dyqane peshku.
 - Vezë, sallame të ndryshme, qumësht.
 - Thika të ndryshme për kontroll.
 - Ovoskop.
 - Laktodensimetër.
 - Enë me ujë.
 - Dezinfektant për duart.
 - Llampë me alkool.
 - Garzë për kullimin e qumështit,
 - Sapun, ujë etj.
-

20. Moduli: “Dehelmentizimi i kafshëve me sëmundje parazitare”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DEHELMENTIZIMI I KAFSHËVE ME SËMUNDEJE PARAZITARE	M-19-623-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të dehelmentizuar gjedhin dhe të imtat me gëlbasë, qengjat e kecat me diktiokauzolë e monjeziozë, si dhe derrat, qentë dhe macet me nematodozë.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.12 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen punë përgatitore për dehelmentizimin e kafshëve me sëmundje parazitare. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur.– të kontrollojë siç duhet kafshët klinikisht.– të veçojë kafshët që do të dehelmentizohen nga kafshët e tjera.– të vendosë siç duhet mbi tryezë mjetet e punës– të bëjë përzgjedhjen e preparateve me të cilët do të bëhet dehelmentizimi siç janë : leklosani, albendazoli, levamisoli, sedinas, piperipra, etj– të mbajë saktë shënimet përkatëse.– të respektojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës përgatitore për dehelmitizimin e kafshëve me sëmundje parazitare. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi bën dehelmentizimin e gjedhit me gëlbasë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për dehelmentizimin e gjedhit me gëlbasë.– të vlerësojë saktë peshën e kafshës.– të ërzgjedhë preparatin e duhur për dehelmitizimin e gjedhit me gëlbasë.– të përlllogarisë dozën e preparatit leclosan sipas peshës së kafshës.	

- të fiksojë siç duhet kafshën.
- të përgatisë siç duhet preparatin dehelmentizues.
- të japë preparatin kafshës sipas instruksionit përkatës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të dehelmitizimit të gjedhit me gëlbasë.
- të pastrojë mjetet dhe vendin pas kryerjes së dehelmitizimit të kafshës.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë dehelmentizimit të gjedhit me gëlbasë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi bën dehelmentizimin e të imtave me gëlbasë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për dehelmentizimin e të imtave me gëlbasë.
- të vlerësojë saktë peshën e kafshës.
- të përzgjedhë mjetet dhe preparatin e duhur për dehelmentizimin e të imtave me gëlbasë.
- të përlllogarisë dozën e preparatit albendazol sipas peshës së kafshës.
- të fiksojë siç duhet kafshën.
- të japë preparatin e përgatitur kafshë sipas instruksionit përkatës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të dehelmitizimit të të imtave me gëlbasë.
- të pastrojë mjetet dhe vendin pas kryerjes së dehelmitizimit të kafshës.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë dehelmentizimit të të imtave me gëlbasë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi bën dehelmentizimin e qengjave dhe kecape me diktiokaulozë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për dehelmentizimin e qengjave dhe kecape me diktiokaulozë.
- të vlerësojë saktë peshën e kafshës.
- të përzgjedhë mjetet dhe preparatin e duhur për dehelmentizimin e qengjave dhe kecape me diktiokaulozë.
- të përlllogarisë dozën e preparatit levamisol sipas peshës së

kafshës

- të fiksojë si duhet kafshën përpara dhënies së preparatit.
- të përgatisë preparatin e përcaktuar sipas rregullit të duhur.
- të japë preparatin e përgatitur kafshës, sipas instruksionit përkatës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të dehelmentizimit të qengjave e kecave me diktiokaulozë.
- të pastrojë mjetet dhe vendin pas kryerjes së dehelmitizimit të kafshës.
- të përgatitë si duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë dehelmentizimit të qengjave dhe kecave me diktiokaulozë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi bën dehelmentizimin e qengjave dhe kecave me monjeziozë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën për dehelmentizimin e qengjave e kecave me monjeziozë.
- të përzgjedhë mjetet dhe preparatin e duhur për dehelmentizimin e qengjave e kecave me monjeziozë.
- të kontrollojë tabletat e preparatit sedinas
- të fiksojë siç duhet kafshën.
- të përgatisë preparatin siç duhet.
- të japë preparatin sipas instruksionit përkatës
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të dehelmentizimit të qengjave e kecave me monjeziozë.
- të pastrojë mjetet dhe vendin pas kryerjes së dehelmitizimit.
- të ërgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë dehelmentizimit të qengjave dhe kecave me monjeziozë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Nxënësi bën dehelmentizimin e derrave me nematodozë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për dehelmentizimin e derrave me nematodozë.
- të vlerësojë saktë peshën e kafshës.
- të përzgjedhë mjetet dhe preparatin e duhur për dehelmentizimin e derrave me nematodozë.
- të përlogarisë dozën e preparatit piperipra sipas

instruksionit.

- të përgatisë preparatin sipas instruksionit.
- të japë preparatin sipas instruksionit përkatës
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të dehelmintizimit të derrave me nemtodozë.
- të pastrojë mjetet dhe vendin pas kryerjes së dehelmintizimit.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të mjedisit gjatë dehelmintizimit të derrave me nematodozë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 7 Nxënësi bën dehelmintizimin e qenve dhe maceve me nematodozë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për dehelmintizimin e qeneve dhe maceve me nematodozë.
- të vlerësojë saktë peshën e kafshës.
- të përzgjedhë mjetet dhe preparatin e duhur për dehelmintizimin e qeneve dhe maceve me nematodozë.
- të përlogarisë dozën e preparatit pralovet sipas instruksionit.
- të përgatisë preparatin e kafshës sipas instruksionit.
- të japë preparatin kafshës sipas instruksionit përkatës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të dehelmintizimit të qeneve dhe maceve me nematodozë.
- të pastrojë mjetet dhe vendin pas kryerjes së dehelmintizimit.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë dehelmintizimit të qenve dhe maceve me nematodozë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në familje fermere me kafshë të ndryshme.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për dehelmintizimin e gjedhit dhe të imtave me gëlbasë, e qengjave e kecape me diktiokaulozë e monjeziozë, si dhe të derrave, qenve e maceve me nematodozë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për dehelmintizimin e dehelmintizimin e gjedhit dhe të imtave me gëlbasë, e qengjave e kecape me diktiokaulozë e monjeziozë, si dhe të derrave, qenve e maceve me nematodozë.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me dehelmintizimin e dehelmintizimin e gjedhit dhe të imtave me gëlbasë, e qengjave

-
- e kecape me diktiokaulozë e monjeziozë, si dhe të derrave, qenve e maceve me nematodozë me preparate antiparazitare.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për dehelmentizimin e dehelmentizimin e gjedhit dhe të imtave me gëlbasë, e qengjave e kecape me diktiokaulozë e monjeziozë, si dhe të derrave, qenve e maceve me nematodozë..
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.pavarur.
 - Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceduarit e punës për dehelmentizimin e dehelmentizimin e gjedhit dhe të imtave me gëlbasë, e qengjave e kecape me diktiokaulozë e monjeziozë, si dhe të derrave, qenve e maceve me nematodozë.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë blegtorale
 - Kafshë të ndryshme: lopë, derra, qen, mace, qengja, keca, të imta.
 - Preparate antiparazitare si: leklosan, albendazol, levamisol, sedinas, piperipra, pralovet etj.
 - Shiringa, pambuk, dezenfektant.
 - Enë qelqi, ujë, sapun, peshqirë, peshore etj.
 - Dokumentacion për mbajtjen e shënimeve.
-

21. Moduli: “Vlerësimi i materialit biologjik të kafshës”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VLERËSIMI I MATERIALIT BIOLOGJIK TË KAFSHËS	M-19-624-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për përgatitjen e kimikateve, sterilizimin e instrumenteve dhe në vlerësimin e materialit biologjik (spermës), për inseminimin artificial të kafshëve, në kushtet e mbarështimit të kafshëve në fermat blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.12 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit kimikatet dhe instrumentet për inseminimin artificial të kafshëve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për përgatitjen e kimikateve e instrumenteve për inseminimin artificial të kafshëve.– të përgatitë si duhet, tavolinën, mjetet dhe vendin e përshtatshëm për përgatitjen e kimikateve e instrumenteve të inseminimit artificial.– të vendososë me kujdes kimikatet në tavolinë.– të përgatitë si duhet kimikatet kryesore.– të përgatitë alkoolin 65 gradë.– të përgatitë ujit fiziologjik 1%.– të përgatitë hidrogjenobikarbonatit na 2-3% me ujë të ngrohtë.– të vendosë si duhet instrumentet në tavolinën punës.– të kryejë pastrimin mekanik të instrumenteve.– të lajë instrumentet me tretësirën e sodës së bukës dhe t’i shpërlajë ato me ujë të rrjedhshëm.– të kryejë sterilizimin me zierje të instrumenteve prej qelqi (duke i mbështjellë me garzë) në sterilizator.– të kryejë larjen e vaginoskopit, mikroshiringës, pipetave, etj. me tretësirën e sodës së bukës.– të kryejë sterilizimin e vaginoskopit me zierje, në flakën e llampës me alkool për 1-2 minuta.– të kryejë dezinfektimin e mikroshiringës me alkool 65	

-
- gradë, brenda dhe jashtë saj.
- të kryejë shpëlarjen e mikroshiringës disa herë me ujë fiziologjik (në shishet 1, 2, 3).
 - të sistemojë me kujdes instrumentet dhe kimikatet e përgatitura në tavolinën e punës.
 - të kryejë pastrimin e dezinfektimin e mjeteve dhe mjedisit pas përgatitjes së kimmikateve dhe instrumenteve për insimin artificial të kafshëve.
 - të përgatitë si duhet faturën për shërbimin e kryer
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit, gjatë përgatitjes së kimikateve dhe instrumenteve për inseminimin e kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen vlerësimin e jashtëm të spermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për vlerësimin e jashtëm të spermës.
- të përgatisë si duhet tavolinën dhe mjetet e nevojshme të punës për vlerësimin e jashtëm të spermës.
- të kryejë marrjen e spermës për vlerësim të jashtëm.
- të kryejë vlerësimin me sy të spermës në një ejakulat.
- të matë vëllimin e spermës me pipeta të shkallëzuara.
- të vlerësojë ngjyrën normale të spermës.
- të përcaktojë erën karakteristike të spermës tek deshtë.
- të përcaktojë dendësinë e spermës nga pamja e jashtme.
- të pastrojë mjetet e mjedisin pas vlerësimit të jashtëm të spermës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse në fletoret e punës.
- të përgatitë si duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe ruajtjes së ambjentit, gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm të spermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi bën vlerësimin mikroskopik të spermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për vlerësimin mikroskopik të spermës.
- të përgatisë siç duhet tavolinën dhe mjetet e nevojshme të punës për vlerësimin mikroskopik të spermës.
- të përgatisë siç duhet mikroskopin për punë.
- të rregullojë zmadhimin, ndriçimin dhe temperaturën në

mikroskop.

i. të nxjerrë nga termusi ampulën me spermë të lëngët.

- të mbajë ampulën për disa minuta në temperaturën e dhomës.
- të kryejë thyerjen e ampulës me sharrë qelqi.me shumë kujdes.
- të hedhë, me pipetë, një pikë spermë mbi lamë.
- të mbulojë me kujdes materialin me lamelë.
- të vendosë strishon në tryezën e mikroskopit.
- të vrojtojë me vëmendje spermatozoidët në mikroskop.
- të vlerësojë lëvizshmërinë e spermatozoidëve.
- të vlerësojë dendësisë e spermatozoidëve, 5-10 spermatozoidë në fushë.

ii. të kryejë marrjen nga kontenjeri të spermës së ngrirë në azot të lëngët.

- të hapë me kujdes kapakun e kontenjerit.
- të nxjerrë me kujdes gotën me spermiotubëza në grykën e kontenjerit.
- të marrë me pincë spermiotubëzën.
- të fusë spermiotubëzën në ujë të ngrohtë për ta shkrirë.
- të nxjerrë spermiotubëzën nga uji i ngrohtë pas disa minutash.
- të presë me gërshërë spermiotubëzës.
- të hedhë me kujdes një pikë sperme mbi lamë.
- të mbulojë siç duhet materialin me lamelë.
- të vendosë me kujdes strishon në tryezën mikroskopit.
- të qartësojë pamjen mikroskopike të strishos.
- të vlerësojë lëvizshmërinë e spermatozoidëve në fushën e mikroskopit.
- të vlerësojë dendësinë e spermatozoidëve (d-m)
- të lajë, pastrojë e dezinfektojë mjetet dhe vendin e punës pas vlerësimit mikroskopik të spermës.
- të mbajë shënimet përkatëse në fletoret e punës.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe ruajtjes së ambjentit, gjatë vlerësimit mikroskopik të spermës në laborator.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në laboratorin e shkollës ose në stacione të inseminimit artificial të kafshëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për përgatitjen e kimikateve e instrumenteve të inseminimit artificial, si dhe të vlerësimit të

jashtëm dhe mikroskopik të spermës.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e kimikateve e instrumenteve të inseminimit artificial, si dhe të vlerësimit të jashtëm dhe mikroskopik të spermës.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me inseminimin artificial të kafshëve të ndryshme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përgatitjen e kimikateve e instrumenteve të inseminimit artificial, si dhe të vlerësimit të jashtëm dhe mikroskopik të spermës.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceduarit e punës për përgatitjen e kimikateve e instrumenteve të inseminimit artificial, si dhe të vlerësimit të jashtëm dhe mikroskopik të spermës.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit të pavarur.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë blegtorale.
 - Stacion të inseminimit artificial të kafshëve
 - Material biologjik (spermë)
 - Kontenjer me azot të lëngët, termus.
 - Veshje pune, bluza të bardha, doreza, maskë, kapuç, etj.
 - Tretësira dezinfektuese.
 - Mikroskop, termometer uji, pipeta të shkallëzuara, alkoolometër, lama, lamela, alkool, kimikate, llambë alkooli etj.
 - Vaginoskop për lopë dhe të imta.
 - Instrumente për inseminim të kafshëve.
 - Ujë, sapun, peshqira, pece, sfungjer, kova, etj.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Përgatitja me krahë e barit të thatë”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRGATITJA ME KRAHË E BARIT TË THATË	M-19-240-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit për të kryer procese pune të përgatitjes me krahë të barit të thatë si ushqim për blegtorinë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi pret/korr me krahë, bar të njomë dhe jonxhë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatitë siç duhet kompletin e veshjes së përshtatshme për prerjen/korrjen e barit të njomë/jonxhës.– të përgatitë siç duhet veglat për prerjen e barit dhe të jonxhës: drapër, kosë e të tjera materiale ndihmëse.– të përcaktojë fushën/zonën ku do të kryhet prerja/korrja, sipas kriterëve të dhura.– të përcaktojë saktë kohën e korrjes së jonxhës për bar të thatë – para lulëzimit.– të transportojë me shumë kujdes veglat në vendin e përcaktuar.– të bëjë me shumë kujdes pastrimin e fushës nga objekte të forta apo mbeturina të tjera.– të largojë me kujdes mbeturinat nga fusha e caktuar për korrje.– të kryejë prerjen e barit të njomë dhe të jonxhës me drapër ose me kosë.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë transportit të veglave dhe prerjes së barit të njomë dhe jonxhës. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Nxënësi kryen operacione pune për tharjen e barit dhe jonxhës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpërndajë siç duhet barin dhe jonxhën e korrur duke përdorur vegla krahu si cfurk etj.
- të kthejë sipas rregullit barin dhe jonxhën.
- të mbledhë barin dhe jonxhën në grumbuj sipas rregullit dhe në kohën e duhur.
- të rishpërndajë barin dhe jonxhën sipas rregullit dhe në kohën e duhur.
- të rikthejë barin dhe jonxhën për tharje sipas rregullit.
- të kryejë vazhdimisht kontrollin organoleptik të cilësisë së barit dhe jonxhës gjatë tharjes.
- të ngarkojë me shumë kujdes barin e thatë në mjetet e transportit.
- të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së operacioneve të punës për tharjen e barit dhe të jonxhës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në parcela të mbjella me bar të njomë e jonxhë pranë shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë demonstrimet konkrete për prerjen/korrjen dhe tharjen e barit të njomë dhe jonxhës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për prerjen/korrjen, tharjen e barit të njomë dhe jonxhës, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me operacionet e punës që kryhen për tharjen
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e tharjes së barit dhe të jonxhës.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen fermë bujqësorë, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Sipërfaqe e mbjellë me jonxhë.
 - Kosë, drapër.
 - Komplet i veshjes.
 - Manuale ose katalogje për operacionet e punës për tharjen e barit.
 - Pamje filmike të proceseve të punës gjatë korrjes, kthimit, grumbullimit, si dhe të transportit të barit të thatë dhe të jonxhës.
-

2. Moduli “Dezinsektimi dhe deratizimi i mjediseve”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DEZINSEKTIMI DHE DERATIZIMI I MJEDISEVE	M-19-241-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit për kryer procese pune dezinfektimit dhe deratizimit të stallave dhe mjedisit, për zhdukjen e insekteve dhe brejtësve në fermën blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen procese përgatitorë pune për dezinfektimin dhe deratizimin e mjediseve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë si duhet kompletin e veshjes.– të përgatisë mjetet e punës sipas rregullit përkatës.– të përgatisë stallën dhe ambientet për dezinfektim dhe deratizim sipas kriterëve përkatëse.– të largojë me krah ushqimet nga grazhdet dhe nga stalla.– të kryejë si duhet pastrimin mekanik të trupit të kafshëve.– të kryejë si duhet pastrimin e padokëve dhe të ambienteve rreth stallës.– të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së proceseve të punës për dezinfektim dhe deratizim të stallave dhe të ambienteve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi kryen dezinfektimin e stallave dhe të mjediseve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë saktë llojet e insekteve që do të luftohen.– të përcaktojë mënyrën e duhur të dezinfektimit.– të zgjedhë saktë llojin e dezinfektantit që do të përdorët.– të përzgjedhë saktë pajisjet dhe mjetet e punës për dezinfektim.– të përcaktojë saktë veshjet mbrojtëse që do të përdorë gjatë punës.	

- të kryejë me shumë kujdes transportimin e materialeve, veglave të punës dhe desinsektantëve në vendin e punës.
- të përgatitë pajisjet për dezinfektim, si pompa spërkatëse, pluhurosëse, lopata, etj sipas rregullave teknike.
- të përcaktojë dozën dhe sasinë dezinfektantit sipas llojit të insektit dhe shkallës së përhapjes së tij.
- të përgatisë tretësirën dezinfektuese sipas procedurës përkatëse.
- të kryejë, me shumë kujdes, trajtimin kimik (spërkatje ose pluhurosje) në mjediset e brendshme dhe të jashtme.
- të përdorë insekticidet në formën e tretësirës së gatshme sipas rregullit.
- të përdorë insekticidet tërheqëse (joshëse) në mjediset e mbyllura (baxho, magazina, etj), në sasinë e duhur.
- të përdorë insekticidet në trupin e kafshëve sipas kriterëve të përcaktuara.
- të kryejë si duhet pastrimin e veglave, pajisjeve dhe të trupit të tij pas punës.
- të zbatojë masat e sigurimit teknik gjatë punës dhe të sigurimit të territorit pas
- të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së dezinfektimit me vendosjen e tabelave njoftuese, etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen deratizimin e stallave dhe të mjedisëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë saktë llojet e brejtësve që do të luftohen.
- të përcaktojë mënyrën më të përshtatshme të deratizimit.
- të zgjedhë saktë llojin e deratizantit që do të përdorët.
- të përzgjedhë si duhet pajisjet dhe mjetet e punës për deratizim.
- të përcaktojë saktë veshjet mbrojtëse që do të përdorë gjatë punës.
- të kryejë me shumë kujdes transportimin e materialeve, veglave të punës dhe deratizantëve në vendin e punës.
- të përgatisë pajisjet për deratizim, si pompa spërkatëse, pluhurosëse, lopata, etj sipas rregullave përkatëse.
- të përcaktojë saktë dozën dhe sasinë e deratizantit.
- të përgatisë sipas procedurës teknike tretësirën deratizuese.
- të kryejë sipas rregullit trajtimin kimik (spërkatje ose pluhurosje) në mjediset e brendshme dhe të jashtme.
- të përdorë siç duhet preparatet tërheqëse (joshëse, kurthe) në ambientet e mbyllura (baxho, magazina, etj).
- të përdorë mjetet mekanike për luftimin e bretësve (çarqe, etj.)

- të kryejë pastrimin e veglave, pajisjeve dhe të trupit të tij pas punës.
- të zbatojë me rreptësi masat e sigurimit teknik gjatë punës dhe të sigurimit të territorit pas kryerjes së deratizimit me vendosjen e tabelave njoftuese, etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikantët profesionalë shkollës dhe në stalla pranë shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për dezinfektimin dhe deratizimin e stallave dhe të mjediseve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për dezinfektimin dhe deratizimin e stallave dhe të mjediseve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me mënyrat e dezinfektimit dhe të deratizimit
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për dezinfektimin dhe deratizimin e stallave dhe të mjediseve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen stalla, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë dhe ambiente për rritjen e kafshëve.
 - Pompa spërkatëse, pluhurose, lopata, etj.,
 - Insekticide të gatshme.
 - Preparate dhe insekticide tërheqëse.
 - Çarqe minjsh.
 - Lopata, cfurqe, gërryese, furça, karrocë dorë, etj.
 - Komplete veshje pune për dezinfektim dhe deratizim.
 - Peshqirë, pece, kova uji.
 - Dezinfektantë dhe deratizantë kimik
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Vidio me demonstrime të ndryshme.
-

3. Moduli: “Asgjësimi i kafshëve të ngordhura”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ASGJESIMI I KAFSHËVE TË NGORDHURA	M-19-242-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer autopsi në kafshë të ndryshme, si dhe për të asgjësuar kafshë të ngordhura me djegje dhe me groposje.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10 në drejtimin mësimor “Veterinari”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen punë përgatitore për kryerjen e autopsisë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të marrë anamnezën nga shoqëruesi i kafshës për kohën e ngordhjes dhe shenjat e sëmundjes para ngordhjes.– të caktojë kohën e duhur për hapjen e kufomës.– të veshë kompletin e punës: kominoshe, përparëse, bezeje, përparëse plasmasi, kapuç, dorashka llastiku, çizme.– të zgjedhë vendin për autopsi me ndricim maksimal dhe larg qëndrave të banimit.– të përdorë tryeza të pa përshkrueshme nga uji.– të sistemojë orënditë, kovë, ujë, thika dhe gërshërë të madhësive të ndryshme, bisturi, sharrë, dalta, çekic me dorëzë metalike, darë kockash, cengela, metër, enë të graduara, vazo, qeska plastike, plasmë, pinca anatomike, kirurgjikale, pambuk ting-jodi etj.– të transportojë kufomën pa ndotur ambientin.– të përcaktojë gjëndjen e lëkurës, të mukozave, të rrjedhjeve nga vrimat natyrorë (nëse ka), shkallën e ftohjes, ngrirjes, shpërbërjes dhe njollat e kufomës.– të mbajë shënime në fletorën e punës.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për autopsinë e kafshës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RM 2 Nxënësi kryen autopsinë.	

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletin e punës: kominoshe, përparëse, bezeje, përparëse plasmasi, kapuc, dorashka llastiku, çizme.
- të pregantisë vendin e punës: tryezë me shtresë të pa përshkrueshme, llamarinë ose plasmas.
- të sistemojë orënditë dhe mjetet e punës: kovë, ujë, thika dhe gërshërë të madhësive të ndryshme, bisturi, sharrë, dalta, çekiç me dorëzë metalike, darë kockash, çengela, metër, enë të graduara, vazo, qeska, plasmas, pinca anatomike, kirurgjikale, pambuk ting-jodi etj.
- të fiksojë kufomën e kafshëve të vogla në pozicionin në kurriz dhe anash për kafshët e mëdha.
- të hapë kufomën duke filluar me prerjen e lëkurës (midis dy nofullave, mes qafës, midis dy gjymtyrëve të perparme të gjoksi, përgjatë vijës së bardhë të barku, në të dyja anet e organeve gjinorë mashkullorë ose gjirit duke përfunduar tek bishti. prerja vazhdon në të katërt gjymtyrët) dhe duke e nxjerr atë nga koka.
- të pres muskulaturën mespërmes trupit.
- të nxjerr organet në grup ose veç e veç.
- të përshkruaj gjëndjen e muskulaturës, gjëndjen e organeve të brëndshme (formën, madhësinë, gjyrën, fortësinë, përmbajtjen).
- të marrë material për laborator, organe të sëmura dhe gjak.
- të mbajë shënime për ndryshimet në organe.
- të plotësojë protokollin e autopsisë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për kryerjen e autopsisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi asgjëson kufomën e kafshës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletin e punës, kominoshe, çizme, kazëm, lopatë, karro dorë, tezgja, plasmas, formalinë, pambuk tink.jodi.
- të caktojë vendin e posacëm për asgjesim, larg dhe më poshtë se vendet e banuara (shtëpi, stalla ose burime)
- të asgjesojë kufomën me djegje kimike ose termike
- të hap gropën në përmasat e duhura.
- të hedh brënda kufomën së bashku me amballazhin e saj dhe një shtresë të tokës ku ka punuar për asgjesim.
- të mbulojë gropën dhe dezinfektojë vendin mbi të.
- të dezinfektojë mjetet me të cilat punojë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për asgjesimin e kufomës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 4 Nxënësi asgjëson kafshë të ngrordhura me djegje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë dhe përgatitë siç duhet, veglat, materialet, si dhe uniformën të domosdoshme për kryerjen e asgjesimit të kafshës me djegje.
- të përcaktojë vendin për asgjesimin e kufomës me djegje, sipas kritere të duhura.
- të hapë gropën për djegijen e kufomës sipas rregullit të caktuar.
- të vendosë siç duhet, kufomën në gropë.
- të kryejë lyerjen e trupit të kafshës së ngordhur me lëndë djegëse, me shumë kujdes.
- të realizojë djegjen e kufomës sipas rregullit të caktuar.
- të bëjë siç duhet, mbulimin e kufomës më dhë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për asgjesimin e kafshëve të ngordhura me djegje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi asgjëson kafshë të ngordhura me groposje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë dhe përgatitë siç duhet, veglat, materialet, si dhe uniformën të domosdoshme për kryerjen e asgjesimit të kafshës me groposje.
- të përcaktojë vendin për asgjesimin e kufomës me groposje, sipas kritere të duhura.
- të hapë gropën për asgjesimin e kufomës sipas rregullit të caktuar.
- të vendosë siç duhet, kufomën në gropë.
- të bëjë siç duhet, mbulimin e kufomës më dhë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për asgjesimin e kafshëve të ngordhura me groposje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul mund të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës ose në territorët jashtë saj.
- Mësuesi instruktori mund të organizojë edhe vizita mësimore në thertorë ku mund të shohin praktikisht se si bëhet autopsia e kafshëve të ndryshme.
- Nxënësit duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e kryerjes së

autopsisë së kafshëve. Kjo duhet të përfshijë përgatitjen e mjeteve dhe uniformës, kryerjen e autopsisë si dhe për asgjësimin e kafshëve.

- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet praktike për përgatitjen e mjeteve dhe uniformës, kryerjen e autopsisë, si dhe groposjen e trupit të kafshëve.
- Realizimi i pranuehëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqëshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kafshë të ndryshme.
 - Lëndë djegëse
 - Vegla të thjeshta për hapjen e gropës.
 - Mjete të thjeshta për fiksimin e kafshëve.
 - Mjete të thjeshta kirurgjikale për hapjen e kafshëve.
 - Dezinfektantë për duar dhe për territorin
-

4. Moduli "Përcaktimi i shenjave të afshit të kafshët"

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRCAKTIMI I SHENJAVE TË AFSHIT TË KAFSHËT	M-19-243-20
------------------	--	-------------

Qëllimi i modulit Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të zbuluar shenjat e afshit në kafshë të ndryshme me metodën e vrojtimit.

Kohëzgjatja e modulit 72 orë mësimorë

Niveli i parapëlqyer për praninë Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10 në drejtimin mësimor "Veterinari", Niveli IV i KSHK.

Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi vrojton shenjat e afshit në lopë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë siç duhet planin e punës për zbulimin e shenjave të afshit të lopët.
- të përzgjedhë kafshët në afsh (lopët) për vrojtim.
- të mbajë saktë shënimet.
- të identifikojë lopët me shënja afshi (ulje oreksi, pëllitje të shpeshta, lëvizje të shumta, shikim të përqendruar, ënjtje dhe skuqje e vulvës, rrjedhje mukusi, ngrijte bishti, kërcime mbi lopët e tjera.)
- të mbahen saktë shënimet për çdo vrojtim.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kontrollit të lopëve në afsh.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi vrojton shënjat e afshit në dele.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë saktë planin e punës për vrojtimitin e shenjave të afshit të delet.
- të përzgjedhë kafshët (delet) për vrojtim.
- të mbajë saktë shënimet.
- të identifikojë delet me shënja afshi nëpërmjet deshëve të provës.
- të mbahen saktë shënimet për çdo vrojtim
- të zbatohen rregullat e sigurimit teknik gjatë kontrollit të deleve në afsh.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje përgjigje.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional pranë shkollës ose në ferma blegtorale me lopë, dele apo derra.
- Instruktori mund të organizojë vizita mësimore në komplekse blegtorale duke iu dhënë mundësi nxënësve për të vrojtur konkretisht disa nga shenjat e afshit në kafshë të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për të kryer vrojtme për zbulimin dhe përcaktimin e shenjave të afshit te kafshët, vetëm në mbikqyrje të instruktorit apo specialistit veterinar.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me shenjat e afshit te kafshët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e përcaktimit të shenjave të afshit në kafshë të ndryshme.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë blegtorale
 - Kafshë në afsh
 - Dëshë të provës
 - Harça të provës
 - Dokumentacion për mbajtjen e shënimeve.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Vidio me demonstrime të ndryshme.
-

5. Moduli “Zbatimi i profilaksisë kundër sëmundjeve infektive”

Drejtimi: Veterinari
 Niveli: IV i KSHK
 Klasa: 12

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ZBATIMI I PROFILAKSISË KUNDËR SËMUNDJEVE INFEKTIVE	M-19-625-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer anketën epizotologjike në një fermë blegtorale, si dhe për të hartuar dhe vënë në zbatim planin profilaktik për një sëmundje infektive që dyshohet e më pas diagnostikohet .	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11 në drejtimin mësimor “Veterinari”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen anketën epizotologjike në një fermë blegtorale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë dhe të veshë uniformën. - të përshkruajë kafshët e ekonomisë sipas llojit, racës, grupmoshave e seksit. - të vrojtojë me kujdes dhe të përpiqet të gjejë shkakun e sëmundjes. - të organizojë pyetsorë tip ose të përpiluar aty për aty. - të kryejë vizita dhe të vëzhgojë me kujdes stallat. - të kontrollojë kushtet zoohigjenike të stallave. - të diagnostikojë me kujdes kafshët e sëmura. - të nxjerrë përqindjen e sëmundshmërisë e ngordhshmërisë, nëpërmjet regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave. - të përcaktojë saktë diagnozën në bazë të shenjave klinike, analizave laboratorike dhe anamnezës (pyetsorit). - të zbatohen rregullat e komunikimit dhe të etikës profesionale, gjatë kryerjes së anketës epizotologjike. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. - Pyetje-përgjigje me gojë. <p>RM 2 Nxënësi zbaton planin profilaktik kundër sëmundjes infektive të diagnostikuar. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të hartojë planin profilaktik sipas shkallës së përhapjes së 	

sëmundjes.

- të vendosë karantinën duke zbatuar rregullat për vendosjen e saj nëse është e nevojshme.
- të kryejë siç duhet depistimin.
- të veçojë kafshët e sëmura: t'i mjekojë ose eliminojë ato, sipas rastit.
- të asgjësojë kafshët e ngordhura, sipas rastit dhe rregullave.
- të dezinfektojë mjedisin sipas rregullave.
- të sigurojë kushte të mira zoohigjenike në stallë duke eliminuar faktorët që predispozojnë shfaqjen e sëmundjes.
- të njoftojë menjëherë shërbimin veterinar mbi gjendjen.
- të zbatohen rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të planit profilaktik kundër sëmundjes infektive.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në ferma të tjera blegtorale.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e anketës epizotologjike si dhe për hartimin dhe zbatimin e planit profilaktik ndaj sëmundjeve infektive.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me profilaksinë e sëmundjeve infektive.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për profilaksinë e sëmundjeve infektive.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës gjatë anketës epizotologjike dhe hartimit e zbatimit të planit profilaktik ndaj sëmundjes së diagnostikuar.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë blegtorale.
 - Ilaçe, vegla për groposjen e kafshëve të ngordhura.
 - Mjetet për pastrimin e stallave: lopata, cfurqe, karroca dore etj.
 - Dezinfektant dhe komplete veshje për dezinfektim.
 - Pompa spërkatëse dhe pluhurosëse.
 - Peshqir, kova uji, sapun.
-

6. Moduli: “Mjekimi i organeve gjinore te lopët”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	MJEKIMI I ORGANEVE GJINORE TE LOPËT	M-19-626-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që ka për qëllim të aftësojë nxënësit për të kryer mjekimin e lopëve me mbetje shtrati, prolaps të mitrës dhe pezmatim të mitrës (metrite), në kushtet e mbarështimit të kafshëve në fermat blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.11 të drejtimit “Veterinari”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi mjekon lopët me mbetje shtrati. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për mjekimin e lopëve me mbetja shtrati.– të vendosë siç duhet lopën në fiksuese.– të kryejë saktë marrjen e të dhënave (anamnezën) për lopën nga mjelësja.– të ndërhyjë pas pjelljes me barna që shtojnë tkurrjet e mitrës. <p><u>i. të kryejë heqjen e shtratit me dorë.</u></p> <ul style="list-style-type: none">– të kryejë larjen dhe dezinfektimin e organit gjinor të jashtëm me tretësirë permanganati.– të kryejë me dorën e majtë, tërheqjen lehtë të shtratit që varet.– të ndërhyjë me dorën e djathtë në mitrën e lopës.– të kryejë çkopsitjen e kotiledoneve nga karunkulat.– të kryejë me kujdes nxjerrjen e shtratit.– të ndërhyjë me substanca antiseptike dhe baktericide në mitër.– të kryejë mjekimin e përgjithshëm të lopës me antibiotikë dhe sulfamide me rrugë i/v ose i/m. <p><u>ii. të ndërhyjë me barna për heqjen e shtratit.</u></p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë siç duhet tretësirën për mjekim.– të kryejë larjen dhe dezinfektim e organeve gjinore të jashtme me tretësirë permanganati.– të kryejë me kujdes tërheqjen e shtratit që varet.– të kryejë këputjen, me gërshërë, të shtratit në kufirn e	

buzëve të vulvës.

- të kryejë mjekimin me suposte të gatshme/tretësira të përgatitura.
- të kryejë hapjen e vaginës me vaginoskop.
- të kryejë futjen me pincë të gjatë ose me dorë të suposteve.
- të kryejë futjen e tretësirës në mitër me kateter.
- të kryejë futjen e barit midis mukozës së mitrës dhe placentës.
- të kryejë mjekimin e përgjithshëm i lopës.
- të kryejë pastrimin e mjeteve të punës e të mjedisit pas mjekimit të lopëve.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse në fletoret e punës.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe ruajtjes së mjedisit gjatë mjekimit të lopëve me mbetje shtrati.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi mjekon lopët me prolaps të mitrës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për mjekimin e lopëve me proleps të mitrës.
- të vendosë me kujdes lopën në fiksuese.
- të kryejë saktë marrjen e të dhënave për lopën (anamnezën) nga mjelësja.
- të kryejë saktë kontrollin e gjendjes së përgjithshme të lopës.
- të kryejë vendosjen e lopës në stativ në vend të pjerrët.
- të kryejë me kujdes ndërhyrjen lokale në prolapsin e mitrës.
- të kryejë siç duhet fiksimin e bishtit të lopës.
- të lajë me ujë të vakët dhe sapun të mitrën e lopës.
- të heqë me kujdes papastërtitë nga mitra.
- të bëjë shpëlarjen e mitrës me tretësirë dezinfektuese.
- të lyejë plagët në mitër me pomada antibiotike, sulfamidë, etj.
- të kryejë mbështjelljen e mitrës me peshqir të lagur me dezinfektantë.
- të bëjë ngritjen e mitrës në pozicion horizontal.
- të kryejë shtytjen e mitrës në dy anët e vulvës.
- të kryejë vendosjen e mitrës në pozicionin normal.
- të kryejë qepjen e vulvës me ligatura/me pllakë sholle mbi vulvë me rripa fiksues.
- të lërë një hapsirë të pambyllur për urinim.

- të vendosë kafshën në gjendje qetësie për disa ditë.
- të kryejë injeksionin me serum profilaktik në lopë për parandalimin e infeksionit.
- të kryejë larjen, pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve e mjedisit të punës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, të higjienës dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ndërhyrjes dhe mjekimit të lopëve me prolaps të mitrës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi mjekon lopët me pezmatin të mitrës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë dhe veshë uniformën e duhur për mjekimin e lopëve me metrite.
- të marrë saktë të dhënat (anamnezës) nga mjelësja.
- të kryejë matjen e temperaturës, të pulsit dhe të frymëmarrjes në lopën me metrite.
- të kryejë me kujdes vendosjen e lopës në stativ.
- të kryejë me kujdes kontrollin e mukozave.
- të kryejë larjen e organeve gjinore të jashtme.
- të kryejë dezinfektimin e organeve gjinore të jashtme me tretësira dezinfektuese.
- të kryejë kontrollin vaginal të lopës me vaginoskop.
- të kryejë kontrollin e gjendjes së qafës së mitrës.
- të kryejë kontrollin e rrjedhjeve nga vulva.
- të kryejë marrjen e rrjedhjeve nga vulva për analizë.
- të dërgojë për analizë në laborator eksudat që del nga mitra, me flakon steril.
- të kryejë në laborator antibiogramën e mikroflorës nga rrjedhjet mitrës, për mjekimin e metriteve.
- të kryejë futjen e dorës në rektum.
- të kryejë kontrollin e brirëve të mitrës dhe vezoreve.
- të dallojë brirët e mitrës të fryrë, të brumtë dhe në vezore praninë e trupit të verdhë të pathithur.
- të kryejë mjekimin lokal të mitrës.
- të kryejë përgatitjen e tretësirës vajore me antibiotikë dhe sulfamide.
- të kryejë me kujdes ndërhyrjen në mitër .
- të kryejë fiksimin e qafës së mitrës.
- të kryejë futjen e tretësirës antiseptike në mitër me kateter uterin.
- të kryejë mjekimin e metriteve në lopë me specialiteteve të gatëshme

- të kryejë mjekimin e përgjithshëm të kafshës me metrite, me antibiotikë dhe sulfamide me rrugë i/m ose i/v .
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ndërhyrjes dhe mjekimit të lopëve me metrite.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse në fletoret e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës personale gjatë mjekimit të lopëve me mastite.
- të kryej larjen, pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve e mjedisit pas punës.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së ambientit gjatë mjekimit të lopëve me metrite.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në ferma të tjera blegtorale pranë saj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për ndërhyrjen dhe mjekimin e lopëve me mbetje shtrati, prolaps të mitrës dhe pezmatim të mitrës (metrite).
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kontrollin e lopëve me mbetje shtrati, proleps he metrite, si dhe mjekimi i tyre, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me parandalimin dhe mjekimin e organeve gjinore të lopëve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të ndërhyrjes dhe mjekimit të organeve gjinore të lopëve..
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë për rritjen e kafshëve.
 - Laborator veterinar
 - Lopë me patollogji të organeve gjinore.
 - Fiksuese (stativ) për lopët
 - Veshje pune, bluza të bardha, doreza, maskë, kapuç, etj.
 - Tretësira dezinfektuese.
 - Termometër, stetoskop, shiringa, age, barna (antibiotikë,sulfamide,etj).
-

-
- Vaginoskop, kateter uterin, mikroshiringë, pipeta, shishe sterile
 - Ujë, sapun, peshqira, pece, kova, etj.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
-

7. Moduli: “Mjekimi i kafshëve dhe shpendëve me ektoparazitë”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MJEKIMI I KAFSHËVE DHE SHPENDËVE ME EKTOPARAZITË	M-19-627-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të mjekuar kafshët dhe shpendët nëpërmjet tretësirave antiectoparazitare, si dhe me preparate në rrugë parenterale.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.12 në drejtimin mësimor “Veterinari”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi bën punë përgatitore për mjekimin e kafshëve me ektoparazitë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë dhe veshë uniformën për mjekimin e kafshëve me ektoparazitë..– të përzgjedhë mjedisin e duhur për mjekimin e kafshëve me ektoparazitë larg burimeve të ujit të pishëm dhe vendbanimeve.– të konstatojë kafshët e sëmura me ektoparazitë sipas shenjave të tyre dalluese.– të veçojë e numërojë saktë kafshët e sëmura me ektoparazitë.– të përzgjedhë saktë, mjetet e materialet e duhura për mjekimin e kafshëve me ektoparazitë, në varësi të llojit të kafshës.– të përlloraritë sasinë e mjeteve e materialeve të duhura për mjekimin e kafshëve, në varësi të numrit të kafshëve.– të sigurojë sasinë e përlloraritë të mjeteve e materialeve për mjekimin e kafshëve me ektoparazitë.– të përzgjedhë llojin e preparatit për mjekimin e kafshës me ektoparazitë, sipas rregullit të caktuar.– të përlloraritë sasisë e preparateve për mjekimin e kafshëve me ektoparazitë sipas numrit të kafshëve.– të vendosë, me kujdes të gjitha mjetet e materialet e nevojshme për mjekimin e kafshëve, mbi tryezë e punës.– të kryejë kontrollin klinik të kafshëve me ektoparazitë.– të mbajë saktë të gjitha shënimet përkatëse në fletorën e	

punës.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës përgatitore për mjekim e kafshëve me ektoparazitë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi mjekon kafshët me tretësira antiectoparazitare.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për mjekimin e kafshëve me antiectoparazitë.
- të vlerësojë saktë madhësinë e kafshës.
- të përlllogarisë dozën e preparatit hexiprametrinë sipas instruksionit.
- të përgatisë tretësirrën për larje sipas instruksionit përkatës.
- të fiksojë siç duhet kafshën për mjekim me tretësira antiectoparazitare.
- të lajë trupin e kafshës me tretësirën e përgatitur, sipas instruksioneve të caktuara.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të mjekimit të kafshëve me antiectoparazitë.
- të pastrojë e dezinfektojë mjetet dhe vendin e punës, pas mbarimit të mjekimit të kafshës me antiectoparazitë.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë gjatë larjes së kafshës me tretësirë antiectoparazitare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi mjekon kafshët në rrugë parenterale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për mjekimin e kafshën në rrugë parenterale.
- të përzgjedhë mjetet dhe preparatin e duhur për mjekimin e kafshës në rrugë parenterale.
- të vlerësojë saktë peshën e kafshës për mjekim në rrugë parenterale.
- të përlllogarisë saktë dozën e preparatit ivomec sipas instruksionit.
- të fiksojë siç duhet kafshën për mjekim në rrugë parenterale.
- të përgatisë preparatit për mjekimin e kafshës sipas instruksionit përkatës.
- të injektojë preparatin në kafshë, sipas instruksionit

- të mbajë saktë shënimet përkatëse të mjekimit të kafshës në rrugë parenterale kundër ekto parazitëve.
- të pastrojë e dezinfektojë mjetet dhe vendin e punës pas mjekimit parenteral të kafshës.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mjekimit të kafshëve me rrugë parenterale kundër ekto parazitëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi mjekon shpendët me tretësirë anti ekto parazitare.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për mjekimin e shpezëve kundër ekto parazitëve.
- të përzgjedhë mjetet dhe preparatet e duhura për mjekimin e shpezëve kundër ekto parazitëve.
- të përloagrisë sasinë e dozën e preparatit sipas numrit të shpezëve.
- të përgatisë tretësirën anti ekto parazitare për mjekimin e shpezëve sipas instruksionit .
- të fiksojë shpendët për mjekim me tretësira anti ekto parazitare sipas rregullave.
- të spërkasë shpendët nën krahë dhe trup sipas rregullit.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse të mjekimit të shpendëve me tretësira anti ekto parazitare.
- të pastrojë e dezinfektojë mjetet dhe vendin e punës pas mjekimit të shpendëve kundër ekto parazitëve.
- të përgatitë siç duhet faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientin.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mjekimit të shpendve me tretësirë anti ekto parazitare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën blegtorale të shkollës, ferma të tjera blegtorale pranë zsjaj ose në familje fermere që mbarështojnë kafshë e shpendë të ndryshme.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për mjekimin e kafshëve dhe shpendve me ekto parazit
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për mjekimin e kafshëve dhe shpenve me ekto parazitë
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje mënyrën e mjekimit të kafshëve dhe shpezëve me ekto parazitë
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i

shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për mjekimin e kafshëve dhe shpenve me ekto parazitë

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.pavarur.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë blegtorale
 - Kafshë e shpendë të ndryshëm me ekto parazitë
 - Preparate anti ekto parazitare si : hexiprametrinë, hexiprasolucion,diazinon,ivomec etj
 - Shiringa , pambuk, dezenfektant
 - Enë qelqi, ujë , sapun, shishe, sphy,peshqirë etj
 - Dokumentacion për mbajtjen e shënimeve.
-

8. Moduli: “Inseminimi artificial i lopëve me metodën rektocervikale”

Drejtimi: Veterinari
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	INSEMINIMI ARTIFICIAL I LOPËVE ME METODËN REKTOCERVIKALE	M-19-628-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për përgatitjen e lopës për inseminim artificial, duke kryer kontroll rektal për fiksimin e qafës së mitrës, inokulimin e spermës me metodën rektocervikale, si dhe llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me to, në kushtet e mbarështimit të kafshëve në fermat blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.12 në drejtimin mësimor “Veterinari”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen kontrollin rektal në lopë për fiksimin e qafës së mitrës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë e veshë uniformën e duhur për kryerjen e kontrollit rektal në lopë për fiksimin e qafës së mitrës.– të marrë saktë të gjitha të dhënat e duhura për lopën.– të kryejë si duhet fiksimin e lopës në stativ për kryerjen e kontrollit rektal.– të përgatitë dorën e majtë për kontroll rektal.– të veshë dorezën plastike.– të pastrojë me kujdes rektumin nga fekalet.– të kapë me kujdes qafën e mitrës nga rektumi.– të fiksojë e shtrëngojë qafën e mitrës nga rektumi me shumë kujdes.– të shtyjë me kujdes dorën me qafën e mitrës në zgavrën e barkut.– të kryejë siç duhet drejtimin e pozicionit të vaginës.– të largojë me kujdes palat në mukozën e vaginës.– të përgatisë vaginën e lopës për inokulimin e spermës.– të mbajë saktë shënimet përkatëse të kontrollit rektal të lopës në fletoret e punës.– të zbatojë rregullat e higjienës e ruajtjes së mjedisit në stallë gjatë kontrollit rektal për fiksimin e qafës së mitrës. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Nxënësi përgatit mikroshiringën për inokulimin e spermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë e veshë uniformën e duhur për përgatitjen e mikroshiringës për inokulimin e spermës.
- të marrë saktë të gjitha të dhënat për lopët në afsh.
- të sigurojë për inseminim në lopë, spermën e ngrirë në azot të lëngët.
- të hapë me kujdes kapakun e kontenjerit.
- të nxjerrë gotën me spermiotubëza në grykën e kontenjerit.
- të marrë me pincë spermiotubëzën.
- të fusë spermiotubëzën në ujë të ngrohtë për ta shkrirë.
- të nxjerrë spermiotubëzën nga uji i ngrohtë pas disa minutash.
- të përgatisë mikroshiringën e këllëfët plastik për marrjen e spermës.
- të tërheqë me kujdes pistonin e injektorit.
- të fusë me kujdes spermiotubëzën në injektor.
- të presë me gërrshërë majën e spermiotubëzës.
- të vendosë këllëfin plastik në mikroshiringë
- të përgatisë mikroshiringën për inokulimin e spermës.
- të mbajë saktë të gjitha shënimet përkatëse të përgatitjes së mikroshiringës për inokulim të spermës në fletoret e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe ruajtjes së ambjentit në stallë, gjatë përgatitjes së mikroshiringës për inokulim të spermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen inokulimin e spermës në lopë me metodën rektocervikale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën e duhur për inokulimin e spermës në lopë.
- të marrë saktë të gjitha të dhënat për lopët në afsh.
- të kryejë si duhet fiksimin e lopës në stativ për inokulimin e spermës.
- të mbushë mikroshiringën me spermë në sainë e duhur.
- të përgatisë si duhet dorën e majtë për kontroll rektal.
- të veshë me kujdes dorezës plastike.
- të pastrojë me kujdes rektumin nga fekalet.
- të kapë me kujdes qafën e mitrës nga rektumi.
- të fiksojë e shtrëngojë me kujdes qafën e mitrës
- të lajë e dezinfektojë si duhet vulvën.
- të hapë me kujdes buzët e vulvës.

- të kryejë futjen e majës së mikroshiringës në vaginë me dorën e djathtë.
- të shtyjë majën e injektorit para dhe pak lart në vaginë.
- të kryejë futjen e injektorit disa centimetra në qafën e mitrës.
- të kontrollojë, nëpërmjet dorës nga rektumi, vendosjen e injektorit në kanalën e qafës së mitrës.
- të kryejë shtypjen e pistonit të mikroshiringës.
- të kryejë hedhjen e spermës në mitër e në qafën e mitrës.
- të kryejë masazhimin e lehtë të mitrës dhe të qafës së mitrës pas inokulimit të spermës.
- të kryejë larjen, pastrimin dhe dezinfektimin e duarve, mjeteve e vendit të punës pas kryerjes së inokulimit të spermës në lopë.
- të mbajë saktë të gjitha shënimet përkatëse të inokulimit të spermës në lopë, në fletoret e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së ambientit në stallë, gjatë inokulimit të spermës në lopë me metodën rektocervikale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të inseminimit artificial të lopëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në inseminimin artificiale të lopëve, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për inseminimin artificial të lopëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën blegtorale të shkollës, ferma blegtorale pranë shkollës ose edhe në familje fermere që mbarështojnë lopë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kontrollin rektal të lopës për fiksimin e qafës së mitrës, përgatitjen e mikroshiringës për inokulim të spermës, si dhe për inokulimin e spermës me metodën rektocervikale.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për

kontrollin rektal të lopës për fiksimin e qafës së mitrës, përgatitjen e mikroshiringës për inokulim të spermës, si dhe për inokulimin e spermës me metodën rektocervikale.

- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje mënyrën e kontrollin rektal të lopës për fiksimin e qafës së mitrës, përgatitjen e mikroshiringës për inokulim të spermës, si dhe për inokulimin e spermës me metodën rektocervikale.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për kontrollin rektal të lopës për fiksimin e qafës së mitrës, përgatitjen e mikroshiringës për inokulim të spermës, si dhe për inokulimin e spermës me metodën rektocervikale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.pavarur.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë blegtorale që mbarështojnë lopë.
 - Lopë në afsh.
 - Stacion të inseminimit artificial të kafshëve
 - Material biologjik (spermë)
 - Kontenjer me azot të lëngët, termus.
 - Veshje pune, bluza të bardha, doreza, maskë, kapuç, etj.
 - Tretësira dezinfektuese.
 - Vaginoskop për lopë,
 - Instrumente për inseminim të kafshëve.
 - Ujë, sapun, peshqira, pece, sfungjer, kova, doreza plastike, etj.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
-